

THE
SIGRID
RAUSING
TRUST



RAPORT STUDIMOR

PËR PROCESIN E VETTING-UT TË GJYQITARËVE DHE PROKURORËVE DHE ECURISË SË PROCEDIMEVE PENALE NDAJ TYRE



Dhjetor
2024

Ky raport u përgatit nga Komitetit Shqiptar i Helsinkit (KShH) në kuadër të mbështetjes institucionale të ofruar nga Fondacioni Sigrid Rausing Trust. Përmbajtja e këtij materiali është përgjegjësi e vetme e KShH-së dhe ekspertëve që kanë kontribuar në hartimin e tij.

Përpunuan informacionin statistikor dhe cilësor:

Znj. Ardita Kolmarku, Juriste/Menaxhere Projektesh, KShH
Znj. Rabie Zika, Paraligjore/Asistente Projekti, KShH

Ekspertët vëzhgues të seancave gjyqësore publike të vettingut (sipas rendit alfabetik):

Znj. Amilda Haxhiu, Eksperte e Jashtme e KShH
Z. Armand Sokoli, Ekspert i Jashtëm i KShH
Znj. Eriselda Ndreca, praktikante pranë KShH
Z. Nikolin Muçaj, praktikant pranë KShH
Znj. Rabie Zika, Paraligjore/Asistente Projekti, staf KShH

Ekspertët që analizuan vendimet e organeve të vettingut (sipas rendit alfabetik):

Znj. Amilda Haxhiu, Eksperte e Jashtme e KShH
Z. Armand Sokoli, Ekspert i Jashtëm i KShH
Znj. Baisa Sefa, Eksperte e Jashtme e KShH
Z. Emidio Tedeschini, Ekspert i Jashtëm i KShH
Znj. Migena Kondo, Eksperte e Jashtme e KShH

Eksperte për analizën e procedimeve penale ndaj subjekteve të rivlerësimit:

Znj. Erida Skëndaj, Drejtore Ekzekutive, KShH

Rishikim cilësor:

Znj. Erida Skëndaj, Drejtore Ekzekutive, KShH
Z. Niazi Jaho, Këshilltar Ligjor, KShH

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara për subjektin autor. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet pa lejen dhe citimin e tij.

Autor: ©Komiteti Shqiptar i Helsinkit

**Rr. Brigada e VIII-të, Pallati “Tekno Projekt”
Shk. 2 Ap. 10, Tirana-Albania
Kutia Postare nr.1752
Mob: 0694075732 Web site www.ahc.org.al**

**THE
SIGRID
RAUSING
TRUST**

TABELA E PËRMBAJTJES

Lista e Shkurtimeve.....	7
HYRJE.....	8
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....	10
METODOLOGJIA.....	16
PJESA I	21
MONITORIMI I SEANCave DËGJIMORE.....	21
1. Monitorimi i seancave në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit dhe në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit	22
2. Seanca dëgjimore	23
2.1. Seancat dëgjimore të zhvilluara në KPK: Vlerësime të përgjithshme dhe solemniteti	23
2.2 Seancat dëgjimore në KPA: Vlerësime të përgjithshme dhe respektimi i solemnitetit.....	24
3. Të dhëna mbi vendimmarrjen, dinamikën, transparencën e procesit të “Vetting”	26
3.1. Publikimi i vendimeve nga KPK dhe KPA	26
3.2. Publiciteti seancës dëgjimore	27
3.3. Njoftimi i seancave dëgjimore në KPK.....	28
3.4 Respektimi i etikës gjatë seancave dëgjimore	28
4. Kushtet e sallës.....	29
4.1. Kushtet e sallës për seancat e zhvilluara në KPK	29
4.2. Kushtet e sallës për seancat e zhvilluara në KPA	29
5. Proces i rregullt ligjor	30
5.1. Pavarësia dhe paanshmëria.....	31
5.2 Kërkesa paraprake	32
5.3 Përfaqësimi.....	32
5.4 Ndërhyrja e trupit gjykues.....	33
5.5 Standartet e afatit të arsyeshëm (duke marrë si referencë shortimin e çështjeve)	34
6. Kriteret e Vlerësimit	34
6.1. Kriteri i pasurisë	35
6.2 Kontrolli i figurës	36
6.3 Kriteri i Aftësive Profesionale	36
7. Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit	37
8. Përfshirja e publikut - Denoncimet e Publikut	37
PJESA II	39
STUDIMI I VENDIMMARRJES SË ORGANEVE TË VETTINGUT	39
1. Vendimet e KPK-së dhe KPA-së për ndërprerjen/pushimin e vetting-ut	40

1.1 Subjektet e dorëhequra/dala në pension të parakohshëm	40
1.2 Afati i dorëheqjes dhe depozitimi i dorëheqjes pranë organit përgjegjës.....	43
1.3 Analiza e përmbajtjes së vendimeve të ndërprerjes së procesit të vetting-ut dhe atij të pezullimit nga detyra	44
2. Analiza e detajuar e Vendimmarrjeve të KPK dhe KPA	45
2.1 Garantimi i parimit të transparencës nëpërmjet publikimit të vendimeve në faqet zyrtare të internetit të Institucioneve të Vetting-ut.....	45
2.2 Respektimi i parimeve të barazisë së armëve juridike dhe atij të kontradiktoritetit	46
2.4 Impakti i denoncimeve të publikut në vendimmarrjen e organeve të vetting-ut	47
2.5 Roli proaktiv i ONM-së dhe trajtimi i denoncimeve të përcjella prej përfaqësuesve të tyre.....	49
2.6 Respektimi i parimit të proporcionalitetit.....	50
2.7 Standardi i ndjekur lidhur me vlerësimin harmonik të tri kritereve dhe analiza e rasteve bazuar në vlerësimin vetëm të një kriteri.....	52
2.8 Analizë e vlerësimit të kriterit të pasurisë	52
2.9 Analizë e vlerësimit të kriterit të figurës	54
2.10 Gjetje dhe konstatime nga vlerësimi i kriterit të aftësive profesionale	54
PJESA III.....	56
MBI HETIMIN, PROCEDIMIN DHE GJYKIMIN PENAL TË GJYQTARËVE DHE PROKURORËVE TË DORËHEQUR APO SHKARKUAR NË KUADËR TË PROCESIT TË VETTING-UT	56
1. Rekomandimet e KE dhe sfidat e para në drejtim të procedimit penal të subjekteve të ri-vlerësimit të shkarkuar/dorëhequr	57
2. Gjetjet dhe konkluzionet kryesore të analizës së procedimeve penale.	58
REKOMANDIME	66

Lista e Shkurtimeve

KPK - Komisioni i Pavarur i Kualifikimit

KPA - Kolegji i Posaçëm i Apelimit

KL Gj - Këshilli i Lartë Gjyqësor

KLP - Këshilli i Lartë e Prokurorisë

ONM - Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit

KP - Komisionerët Publikë

GjEDNj - Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut

KEDNj - Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut

KShH - Komiteti Shqiptar i Helsinkit

KPrC - Kodi i Procedurës Civile

KLD - Këshilli i Lartë i Drejtësisë

ILDKPKI - Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurisë dhe Konfliktit të Interesave

KprA - Kodi i Procedurave Administrative

HYRJE

Procesi i rivlerësimit kalimtar, ose siç njihet ndryshe vetting-u i gjyqtarëve dhe prokurorëve, mbart një rëndësi të veçantë me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, duke kontribuar në drejtim të forcimit të llogaridhënies dhe përgjegjshmërisë së pushtetit gjyqësor dhe prokurorisë. Edhe pse ky proces përbën vetëm një hallkë të Reformës në Drejtësi, si dhe është me natyrë tranzitore (i përkohshëm) dhe i jashtëzakonshëm, pritshmëritë dhe rezultatet e tij përgjatë këtyre 7 viteve kanë kontribuar pozitivisht në drejtim të ndryshimit të klimës mosbesuese të publikut në sistemin e drejtësisë dhe thyerjes së mitit të pandëshkueshmërisë në radhët e drejtësisë.

Procesi i vetting-ut kryhet nga institucione të posaçme kushtetuese të pavarura, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (KPK) në shkallë të parë dhe Kolegji i Posaçëm i Apelit (KPA) në shkallë të dytë dhe është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Pjesë e rëndësishme e këtij procesi është edhe Institucioni Kushtetues i Komisionerëve publikë që përfaqëson interesin e publikut në procesin e vettingut nëpërmjet ushtrimit të të drejtës së ankimit kundër vendimeve të KPK-së.

Mandati i institucioneve të vetting-ut ka filluar në Qershor të vitit 2017, me emërimin në bllok nga Kuvendi, të anëtarëve të tyre. Edhe për pak muaj, të tre institucionet janë në përmbyllje të vitit të shtatë të veprimtarisë së tyre. Para dy vitesh e gjysëm, kohëzgjatja e atëhershme e procesit vështirësoi progresin e tij në kohë dhe rrjedhimisht përfundimin e vettingut, në shkallë të parë brenda mandatit fillestar prej 5 vitesh të KPK-së. Në dt. 10.02.2022, Kuvendi miratoi ndryshimet kushtetuese që mundësojnë zgjatjen me dy vite e gjysëm të mandatit të Komisionerëve Publik (KP) dhe anëtarëve të KPK-së, përkatësisht, deri në dt. 31 Dhjetor të vitit 2024. Për Komisionerët Publikë (KP) dhe anëtarët e KPK, mandati i ri kushtetues është shtyrë nga 5 vjet në 7 vjet e gjysëm (deri në Dhjetor të 2024-ës), ndërkohë që mandati i Kolegjit të Posaçëm të Apelit mbetet i pandryshuar, përkatësisht 9 vjet, deri në Qershor të vitit 2026. Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit (ONM) u konceptua në Kushtetutë dhe Ligj si një strukturë mbështetëse e mbikëqyrëse e procesit të rivlerësimit kalimtar.

Vetting-u është një proces *sui generis*, me natyrë administrative, i cili nuk ka si qëllim të ndëshkojë penalisht gjyqtarët dhe prokurorët që i nënshtrohen atij. Në përfundim të këtij procesi, nëse subjektet nuk janë dorëhequr apo nëse nuk ka përfunduar statusi për shkaqe të tjera, institucionet e vetting-ut vendosin konfirmimin në detyrë, shkarkimin nga detyra, ose pezullimin nga detyra për një periudhë një vjeçare. Megjithatë, sipas nenit 281, pika 3 e Kodit të Procedurës Penale, institucionet e rivlerësimit kanë detyrim të bëjnë kallëzim në prokurori, nëse gjatë procedimit administrativ, zbulojnë të dhëna, fakte apo prova që përbëjnë veprë penale që ndiqet kryesisht.

Sipas të drejtës sonë penale e vetmja bazë për marrjen e një personi në përgjegjësi penale është që në veprimet ose mosveprimet e tij të ekzistojnë elementët e një figure të caktuar të veprës penale, të parashikuar nga ligji penal. Respektimi dhe plotësimi i elementeve të figurës së veprës penale ka rëndësi të madhe, sepse ka të bëjë me zbatimin e parimit të ligjshmërisë. Gjithashtu, është po kështu e rëndësishme në kuptim të përcaktimit të përgjegjësisë penale të vlerësohet nëse është

parashkruar apo jo ndjekja penale ndaj personit të cilit i atribuohet vepra penale ose është i dyshuar për kryerjen e saj. Elementet se kur ka ndodhur vepra, si paraqitet ajo ne përmbajtjen e saj apo kur demi është vërtetuar përcaktojnë kohën e kryerjes se saj dhe, për rrjedhojë veprimin e ndjekjes penale.

Për shkak të rëndësisë që ka ushtrimi i funksioneve prej organeve të mësipërme dhe ndjeshmërisë ndaj veprimtarisë së tyre, Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH) ka vëzhguar që prej vitit 2018, në mënyrë të pjesshme, organet përgjegjëse për kryerjen e procesit të vettingut si dhe veprimtarinë e organit të prokurorisë lidhur me procedimet penale ndaj subjekteve të dorëhequr apo të shkarkuar në kuadër të vettingut.

Të dhënat e publikuara nga KPK në faqen e tij zyrtare si dhe ato të medias¹, tregojnë se ky Komision pritet të mbyllë ri-vlerësimin kalimtar të të gjithë subjekteve që ka në përgjegjësi, deri në fund të vitit 2024. Gjithashtu, po sipas medias referohet se nga fillimi i procesit të vettingut në nisje të vitit 2018 dhe deri më sot, i janë drejtuar Gjykatës Evropiane të të Drejtave të njeriut, 130 subjekte të prekura nga vendimet e organeve të vettingut². Deri në 30 Shtator 2024 rezultojnë se janë dhënë nga KPK 799 vendime, prej të cilave vetëm 47% (ose 369 vendime) janë konfirmim në detyrë, 33.4% (267 vendime) janë shkarkim, 13.1% (105) janë vendime për ndërprerje procesi, 6% (48) janë vendime për përfundimin e procesit pa vendim përfundimtar, 1% (8 vendime) janë për pushim të procesit dhe 0.2% (2 vendime) janë për pezullim nga detyra³.

Kolegji i Posaçëm i Apelit rezultojnë se deri në 30 qershor 2024 ka shqyrtuar dhe shpallur 259 vendime të Juridiksionit të Rivlerësimit. Nga këto vendime të Kolegjit rezultojnë se numri më i lartë i përket vitit 2023 me 55 vendime. Deri më 30 qershor 2024, në KPA janë regjistruar **384 çështje** të juridiksionit të rivlerësimit ose 48% e vendimeve të dhëna nga KPK deri në Shtator 2024. Deri në Qershor rezultojnë se Kolegji ka evaduar 67.44% të çështjeve, ndërkohë që këto të dhëna nuk janë përfshirë vendimet e ankimuar të KPK-së si dhe vendimet e vetë Kolegjit që datojnë nga data 1 Korrik – 30 Shtator 2024. Nëse marrim në konsideratë progresin e dy viteve të fundit, Kolegjit mund ti duhen edhe afërsisht tre vite për evadimin e plotë të çështjeve që janë në juridiksionin e tij të ri-vlerësimit. Ndërkohë Kolegjit i përfundon mandati në gjysmën e këtij afati të projektuar, përkatësisht në Qershor të vitit 2026 (për afro një vit e gjysëm).

Vlen të theksohet para se Komisioni Evropian në raportin e tij për Shqipërinë për vitin 2024 e ka vlerësuar si një rezultat të drejtpërdrejtë referimin nga KPK drejt prokurorisë në Shtator të këtij viti, të 19 çështjeve të vettingut me elementë kriminalë prima facie, për hetime të mëtejshme, çka përbën ndjekjen e një rekomandimi kyç të BE-së⁴. Mgjth, deri më tani nuk është zhvilluar një analizë e plotë, nëse nga 50% të subjekteve të shkarkuar apo dorëhequr nga procesi i vettingut, sa prej tyre kanë qenë në kushte të tilla. Të dhënat flasin për shumë pak çështje penale të ndjekura dhe akoma më pak të dërguara në gjykatë nga organi i prokurorisë.

¹ <https://top-channel.tv/video/top-channel-vetingu-130-te-rrezuar-ne-strasburg-iu-drejtuan-gjyqtare-dhe-prokurore-te-pakonfirmuar/>

² Po aty.

³ <https://kpk.al/wp-content/uploads/2024/10/Raport-statistikor-shkurt-2018-30-Shtator-2024.pdf>

⁴ https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/document/download/a8eec3f9-b2ec-4cb1-8748-9058854dbc68_en?filename=Albania%20Report%202024.pdf, fq. 6

Gjithashtu, në raportin e Komisionit Evropian për Shqipërinë për vitin 2024 vlerësohet me nota pozitive fakti që komisionerët publikë kanë respektuar të gjitha rekomandimet për ushtrimin e të drejtës së ankimit në Kolegj. Ndërkohë që kërkohet nga Kolegji që të marrë masa urgjente për të rritur dinamikën e procedimeve në apel, me qëllim që të respektohet afati i mandatit të tij kushtetues. Vendimet përfundimtare të KPK vlerësohet se kanë caktuar standarte të rëndësishme në drejtim të verifikimit të figurës, aseteve dhe profesionalizmit të magistratëve, për të cilat BE vlerëson se duhet të miratohen dhe të jenë të qëndrueshme në proceset përkatëse gjyqësore⁵.

Me mbarimin e mandatit të KPK-së dhe IKP-së, një nga sfidat që mbart procesi i vijueshmërisë së vettingut prej Janarit të vitit që vjen (2025) është zëvendësimi që do i bëjë Drejtuesi i Posaçme, Komisionerëve Publikë. KShH vlerëson se ngarkesa që i vishet Drejtuesit të SPAK, duke i shtuar këtë kompetencë është e madhe. E bazojmë këtë nisur nga volumi i çështjeve penale që SPAK ka në ngarkim, ku pritshmëritë më të larta të publikut janë vijueshmëria e rezultateve pozitive që janë shënuar, në drejtim të hetimit penal të korrupsionit veçanërisht zyrtarëve të nivelit të lartë si dhe krimit të organizuar. Në opinionin e tre viteve më parë të KShH drejtuar Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të shtyrjes së afatit të KPK-së dhe IKP-së deri në Dhjetor të këtij viti, KShH ka referuar gjithashtu shqetësimin mbi premisën që krijon kjo kompetencë për “konflikte apo mbivendosje në juridiksionin” në sferën e hetimit penal që ushtron SPAK.

Sfidë tjetër për procesin e vettingut është vijueshmëria e shqyrtimit të ankimeve që janë depozituar në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut si dhe ecuria e vendimmarrjes së Kolegjit lidhur me standartet që janë elaboruar në praktikën e deritanishme të kësaj jurisprudence. Ky është një proces që do vijojë të monitorohet nga KShH, duke patur në konsideratë edhe rastet praktike të GJEDNJ-së në të kaluarën, të tashmen dhe të ardhmen.

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Ky raport studimor i KShH-së është i kategorizuar në tre pjesë. Dy pjesët e para i referohen ecurisë së procesit të vettingut përgjatë vitit 2022, duke analizuar seancat dëgjimore të monitoruara, të zhvilluara pranë KPK-së dhe KPA-së si dhe përmbajtjes së vendimeve të dhëna prej tyre. Ndërkohë në pjesën e tretë analizohet impakti që ka patur procesi i vetting-ut në veprimtarinë e organeve të sistemit të drejtësisë të ngarkuara me hetimin dhe gjykimin e veprave penale, përgjatë viteve 2021-2022

Për periudhën objekt studimi, KPK ka dhënë 37 vendime, nga të cilat, 7 vendime janë dhënë për ndërprerjen e procesit të rivlerësimit si rezultat i dorëheqjes së subjekteve, 22 vendime janë dhënë për konfirmimin në detyrë të subjekteve, ndërkohë që 4 vendime janë dhënë për shkarkimin e tyre. Në këtë periudhë, KPK ka dhënë 1 vendim për pezullimin e subjektit nga detyra për një periudhë 1-vjeçare dhe detyrimin për të ndjekur programin e trajnimit, sipas kurrikulave të miratuara nga Shkolla e Magjistraturës. Në 3 raste, KPK vendosi përfundimin e procesit të vetting-ut, pa një vendim përfundimtar, për shkak të humbjes së jetës të 1 subjekti, ndërkohë në 2 raste u vendos mbarimi i statusit të magistratit si rrjedhojë e shkarkimit nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor

⁵ Po aty, fq.29.

(KLGj) të 2 subjekteve. KPA (ose Kolegji në vijim) ka dhënë 11 vendime, prej të cilave 5 vendime kanë sjellë si rezultat shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit.

Në tërësi, duke iu referuar jurisprudencës së Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut (GjEDNj), procesi e ka kaluar testin e ofrimit dhe respektimit të garancive të një procesi të rregullt ligjor, me disa përjashtime.⁶

Nga përpunimi i të dhënave të siguruara nga vëzhguesit, rezulton se në përgjithësi seancat dëgjimore të zhvilluara në KPK dhe KPA kanë respektuar elementët formalë të solemnitetit, kanë qenë transparente për aq sa mund të deduktohet nga deklarimi i palëve në seancë si dhe pothuaj në të gjitha rastet, subjektet e rivlerësimit konfirmojnë se u është dhënë e drejta e njohjes me dosjen dhe rezultatet e hetimit administrativ.

Njëherësh, vëzhguesit raportojnë se nga relatimi i çështjes (në të dy organet e procesit të rivlerësimit) nga anëtari i trupës gjyquese, krijohet perceptimi se edhe procesi i hetimit ka qenë gjithëpërfshirës. Theksojmë se ky është një perceptim nga relatimi, pasi vëzhguesit nuk kanë qasje në dosjen hetimore.

Ka tërhequr vëmendjen e vëzhguesve të angazhuar nga KShH, moslejimi i publikut në sallën ku zhvillohet seanca dëgjimore publike pranë Kolegjit. KPA argumenton se kjo situatë është rezultat i faktit të zbatimit të masave anti-Covid. Për këtë arsye ndjekja e seancës bëhet jashtë sallës së seancës, përmes një ekrani televiziv. Theksojmë se mungesa e pranisë së publikut në sallë për të ndjekur një seancë që sipas ligjit duhet të jetë publike, nuk ofron të njëjtin akses dhe kuptim të të gjithë dinamikës së procesit të zhvilluar dhe analizës së sjelljes së trupit gjyqës dhe palëve nga një vëzhgues publik i paanshëm dhe objektiv, duke ndikuar negativisht në respektimin e parimit të publicitetit dhe transparencës së gjithë procesit.

Gjatë periudhës objekt vëzhgimi, KPK planifikon thuhajse 1-3 seanca çdo ditë, ndërsa pas kësaj periudhe ka një ritëm më të ngadaltë duke zhvilluar 1-2 seanca gjatë javës. Nga ana tjetër, KPA ka patur një ritëm më të ngadaltë pasi gjatë periudhës objekt studimi janë zhvilluar 6 seanca publike.

Publiciteti i të gjithë procesit është një element thelbësor në funksion të përmbushjes së qëllimit që pati gjithë reforma; mes të tjerash edhe rikthimi besimit të publikut tek drejtësia. Në këtë kontekst, është e nevojshme që jo vetëm seancat dëgjimore të jenë të hapura për pjesëmarrjen e të

⁶ E gjejmë me vend të përmendim çështjen Thanza kundër Shqipërisë, në të cilën GjEDNj nuk e ka gjetur në përputhje me nenin 6 të Konventës qasjen e organeve të vettingut për subjektin e rivlerësimit A.Th., i cili nuk kishte deklaruar faktin që ai së bashku me një mikun e tij ishin proceduar shkurtimisht për veprën penale të korrupsionit, por procedimi ishte pushuar. Gjykata vëren se, në përfundim, kërkuesi nuk kishte asgjë për t'u përgjigjur në lidhje me procedimin penal të pushuar në 2016, dhe arsyetimi i KPA-së për këtë arsye duket të ketë qenë tepër formalist në një kontekst që kërkonte kujdes në zbatimin e përpiktë të kërkesave të ligjit kombëtar. ...Nisur nga sa më sipër, Gjykata konstaton se vlerësimi i procedimit të kërkuesit në 2016 si dhe kontaktet e tij me L.H., ngrejnë shqetësime serioze për respektimin e së drejtës së tij për një proces të rregullt ligjor. Duke marrë parasysh konstatimet e lartpërmendura në mënyrë kumulative, Gjykata konkludon se qasja e organeve të vettingut për vlerësimin e komponentit të dytë të procesit të rivlerësimit, duke rezultuar në gjetje jo direkte mjaftonte për shkarkim nga detyra, por nuk respekton parimin e drejtësisë së procesit që imponon neni 6 § 1 të Konventës në rastin konkret. Prandaj ajo përbën shkelje të atij neni në lidhje me komponentin e dytë të procesit të vettingut.

(Shih Thanza kundër Shqipërisë, aplikimi no. 41047/19, 4 korrik 2023, paragrafet 119-123).

interesuarve, por edhe vendimet të publikohen në kohë të arsyeshme për të kuptuar arsyet e vendimmarrjes konkrete për subjektet e rivlerësimit. Në të dy organet e vetting-ut praktika e deritanishme ka qenë e konsoliduar në drejtim të publikimit të vendimeve, por jo brenda afateve të përcaktuara nga ligji. Gjithashtu, në funksion të garantimit të këtij parimi nuk është konstatuar një praktikë e njësuar në lidhje me publikimin e mendimeve të ndryshme apo paralele të përgatitura nga vëzhguesit ndërkombëtarë të ONM-së. Njëherësh është konstatuar se në vendimet e të dy organeve që po ndjekin këto procedura, nuk gjejnë pasqyrim në mënyrë të përmbledhur vendimet e ndërmjetme. Edhe pse kjo nuk është një kërkesë e detyrueshme e ligjit, ajo i shërben transparencës karshi publikut.

Periudha e hetimit nga momenti i shortimit, zgjat mesatarisht 2 vjet dhe pothuaj po kaq zgjat procesi i shqyrtimit të ankimit ndaj vendimit të KPK (nëse ka). Në total i gjithë procesi i rivlerësimit zgjat rreth 4 vjet (për subjektet ndaj të cilëve paraqitet ankim ose që paraqesin ankim ndaj vendimit të KPK). Në këndvështrimin e vëzhguesve të KShH-së, kjo kohëzgjatje është jo proporcionale duke iu referuar mungesës së arsyeve objektive.

Duhet sjellë në vëmendje veçanërisht efekti financiar që kanë rastet e subjekteve të shkarkuar, të cilët sipas ligjit, deri sa vendimi të marrë formë të prerë, pra para vendimmarrjes së KPA, kur është paraqitur ankim, trajtohen financiarisht në masën 75% të pagës. Për shembull, për një nga subjektet e rivlerësimit për të cilin KPA ka vendosur gjatë periudhës objekt studimi, vendimi i KPK është marrë në datën 21.2.2020, ndërsa data e vendimit të KPA është 28.6.2022. Pra, rreth 28 muaj pas vendimit të KPK, periudhë gjatë së cilës subjekti është trajtuar financiarisht me 75% të pagës. Nisur nga kjo analizë, vlerësohet se tejzgjatja e procesit të rivlerësimit përveçse cenon një komponent të procesit të rregullt ligjor, ka një kosto të lartë financiare për buxhetin e shtetit, pasi subjektet duhet të trajtohen financiarisht, sipas ligjit, deri kur vendimi të marrë formë të prerë.

Ndërkohë që në zgjidhjen në themel janë konstatuar në disa raste qasje jo proporcionale gjatë vlerësimit të kriterëve të ndryshme, të cilat mund të justifikohen me parimin e ekonomisë gjyqësore por jo me kohëzgjatjen reale që ka patur procesi. Përkatësisht, janë ndeshur raste në të cilat organet e vetting-ut kanë patur fokus të shtuar tek dy kriteret e tjera (profesionalizmi dhe kontrolli i figurës), jo tek ai i pasurisë, nëse subjekti i rivlerësimit rezulton me pasuri modeste dhe anasjellas një hetim më i detajuar për kriterin e pasurisë dhe më sipërfaqësor për dy kriteret e tjera, nëse subjekti rezulton të ketë pasuri të konsiderueshme.

Gjatë analizës së rasteve të vendimmarrjeve për ndërprerje të procesit të rivlerësimit për shkak të mbarimit të statusit të magjistratit si pasojë e dorëheqjes së paraqitur nga subjekti dhe miratuar nga organi kompetent (Këshilli i Lartë Gjyqësor apo Këshilli i Lartë i Prokurorisë) rezulton se Komisioni mban një qëndrim të njëjtë për të gjitha rastet e shqyrtuara, ndjekur dhe një nga qëndrim i uniformuar edhe prej Kolegjit. Për të gjitha rastet e dorëheqjeve apo situatave të cilat për nga efekti janë barazuar me të, kolegji ka vendosur ndërprerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar si dhe ndalimin e emërimit si gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare.

Nga një analizë e detajuar e vendimeve të KPK-së dhe Kolegjit, është konstatuar një qasje e ndryshme e trupave gjyqësore sa i përket reflektimit të denoncimeve të paraqitura nga publiku pasi

në disa raste ka një shtjellim të mirë të denoncimeve të publikut e në disa të tjera një paraqitje e përciptë e tyre. Madje, në disa raste këto denoncime nuk janë reflektuar as në vendimin e arsyetuar nga shumica, por gjurmë të tyre gjendjen vetëm në mendimin e pakicës së publikuar, e cila siç vë në dukje në një rast, denoncimet e paraqitura kanë ngritur shqetësime mbi gjykimin në kushtet e konfliktit të interesit në të paktën 3 raste. Si rrjedhojë është e rekomandueshme një qasje e njësuar dhe transparente nga ana e organeve që po realizojnë rivlerësimin kalimtar në pasqyrimin e denoncimeve të paraqitura nga publiku për subjektet e rivlerësimit. Për këtë arsye, sugjerimi i KShH-së do të ishte që në seancat në vijimësi të Kolegjit si dhe në vendimin përfundimtar të reflektohen qenësishëm denoncimet e bazuara të paraqitura nga publiku duke adresuar edhe qëndrimin apo vlerësimin e vet subjektit ndaj këtyre denoncimeve.

Sipas të dhënave që KShH disponon nga prokuroritë, në total rezultojnë 22 gjyqtarë, prokurorë apo funksionarë të lartë të sistemit të drejtësisë, të kallëzuar apo proceduar penalisht përgjatë viteve 2021-2022.

Për sa i përket veprave penale për të cilat është bërë referimi/kallëzimi në prokurori, apo ka nisur procedimi penal, shumica dërrmuese e rasteve, 11 raste janë për nenin 257/a/2 të Kodit Penal (Fshehja apo deklarimi i rremë i pasurisë⁷), vetëm në 3 raste ka patur procedime penale, specifikisht për nenin 319/ç të Kodit Penal (Korrupsioni Pasiv), një rast i është referuar nenit 248 i Kodit Penal (Shpërdorimi i detyrës), dhe në rastet e tjera, mungon informacioni specifik nga prokuroritë e juridiksionit të zakonshëm.

Në 4 raste subjekti referues/kallëzues në prokurori për këto subjekte ka qenë organi publik, KPK, në dy raste rezulton Sektori i Luftës ndaj Narkotikëve në Policinë e Shtetit, në 8 raste rezulton të jetë qytetar, ndërkohë që për pjesën tjetër të rasteve, ky informacion nuk mund të identifikohet.

Në 4 raste, Prokuroritë e Juridiksionit të Përgjithshëm kanë vendosur mosfillim të procedimit penal, duke mos zbatuar në mënyrë të drejtë (sipas KShH-së), dispozitat e Kodit të Procedurës Penale. Shqetësues është fakti se prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm në raste të caktuara, kanë marrë vendime mosfillimi të procedimit penal brenda një harku kohor të disa ditëve nga marrja e materialit kallëzues, edhe në rastet kur subjektet janë shkarkuar me vendim përfundimtar të KPA-së që ka konstatuar shkelje të rënda të kriterit të pasurisë ose aftësive profesionale. Në të tilla raste, prokuroritë nuk kanë administruar dosjet përkatëse të institucioneve të vetting-ut dhe kanë konkluduar mbi veprat penale për të cilat është bërë kallëzimi duke u bazuar në konkluzionet e vendimeve me natyrë administrative të institucioneve të vetting-ut, si për shembull që nuk kemi fshehje dhe as pasaktësi. Ky qëndrim ka elementë kontradiktor pasi vetë prokuroria në pjesën arsyetuese të këtyre vendimeve, referon se procesi i vetting-ut është një proces administrativ dhe jo penal.

Në ndryshim nga praktika e Prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm, SPAK ka një efikasitet ndjeshëm më të lartë lidhur me procedimet penale të këtyre subjekteve pasi rezulton të ketë

⁷ i referuar/proceduar veçmas apo së bashku me vepra të tjera penale të tilla si nenet e Kodit Penal, përkatësisht 143 “Mashttrimet”, 143/a/6 “Fshehja e Pronës”, 180 “Fshehja e të ardhurave”, 181 “Mospagimi i taksave dhe tatimeve”, 248 “Shpërdorimi i detyrës”.

zhvilluar 8 procedime penale ndaj subjekteve të vetting-ut, prej të cilave pesë për vitin 2021 dhe 3 për vitin 2022. Lidhur me këto procedime penale, 7 prej tyre janë dërguar në gjykatë, ku një pjesë e tyre kanë rezultuar me vendimmarrje fajësie.

Bazuar në të dhënat që ofrojnë vendimet objekt studimi, vërehet se teknikat speciale të hetimit janë zbatuar pjesërisht nga SPAK. Sipas KShH-së, në funksion të barrës së provës për akuzën e ngritur që e ka prokuroria, hetimet në drejtim të korrupsionit mund të ishin më produktive nëse do të ishte kërkuar përgjimi i ambienteve private (zyrat e gjyqtarëve dhe të prokurorëve), duke u nisur nga rrethanat specifike të çështjeve, ku rezultojnë se provat për marrjen e rryshfetit nga gjyqtarët/prokurorët nuk janë të drejtpërdrejta por vërtetohen indirekt nga transkriptimet e bisedave të të pandehurve të tjerë. Vlen të saktësohet se ky konkluzion nuk i referohet hetimeve mbi veprën penale të parashikuar nga neni 257/a i Kodit Penal (Refuzimi për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive, interesave privatë), figura e së cilës, në përgjithësi⁸ nuk përmbush kriteret ligjore të masës së dënimit të kërkuara si kusht për aplikimin e këtyre mjeteve speciale gjatë hetimit të tyre, sipas pikës 1 dhe 2 të nenit 221 të Kodit të Procedurës Penale.

Referuar përmbajtjes së kërkesës për dërgimin e çështjes në gjykatë, KShH vëren se nuk reflektohen të dhëna mbi hetimin financiar të korrupsionit për pasurinë në vlerë të konsiderueshme që rezulton e fshehur/padeklaruar, si ndërlidhen këto pasuri me veprimtaritë e dyshuara, por të pa hetuara, sikurse mund të jenë të paktën në 3 çështje, lidhjet potenciale të të pandehurit me segmentë të krimit apo krimit të organizuar.

Duke u nisur nga një interpretim i Gjykatës së Posaçme, konkludohet që të gjithë subjektet që nuk janë marrë si të pandehur deri në Janar të vitit 2022 (pavarësisht se janë gjetur me probleme në kuadër të procesit të vetting-ut), nuk mund të ndiqen penalisht për nenin 257/a/2 të Kodit Penal (fshehja, mosdeklarimi apo deklarimi i rremë i pasurisë), pasi afati i tyre është parashkruar sipas nenit 66 të Kodit Penal. Ky konstatim është shumë shqetësues në drejtim të pandëshkueshmërisë së mbi të paktën 90% të gjyqtarëve dhe prokurorëve të shkarkuar nga vetting-u, të cilët nuk rezultojnë të proceduar penalisht.

KShH vëren vonesa të konsiderueshme në procesin hetimor të këtyre subjekteve që shkojnë 2-3 vjet. Këto afate janë shumë të gjata, e vlerësuar kjo në raport me shkallën jo të lartë të kompleksitetit në hetim, sa kohë që në shumicën e rasteve nuk është hetuar në drejtim të korrupsionit apo përfshirjes së të pandehurit në veprimtarinë e krimit të organizuar. Në tërësi, afatet e tejzgjatura të procedimit penal, si dhe transferimet e çështjeve midis prokurorëve ndikojnë në dobësimin e efikasitetit të procesit hetimor dhe barrës së provës që ka organi i prokurorisë për të provuar akuzat e ngritura në gjykatë.

KShH vlerëson se gjyqtari i seancës paraprake duhet të marrë një rol më pro-aktiv, pasi rastet e studiara evidentojnë se nuk ka patur asnjë vendimmarrje për kthimin e akteve pranë prokurorisë, pasi nuk janë hetuar plotësisht prej saj për fakte të tjera penale që rezultojnë në kuadër të hetimeve, të lidhura me veprat penale në fushën e korrupsionit, krimit të organizuar apo pastrimit të parave.

⁸ Me përjashtim të paragrafit 1, gërma “b”, të nenit 221 të Kodit të Procedurës Penale.

Në ndryshim nga faza e hetimeve, gjykimi në themel është zhvilluar në afate kohore të shpejta dhe të arsyeshme. Në këtë drejtim, ka kontribuar edhe fakti se me kërkesë të të pandehurit, gjykata ka pranuar të procedojë me rregullat e gjykimit të shkurtuar. Nga pikëpamja e arsyetimit, vihet re se vendimet e të dyja gjykatave paraqesin në mënyrë kronologjike faktet e çështjes, kërkimet dhe pretendimet e palëve, përfshi këtu edhe përmbledhjen e konkluzioneve përfundimtare të tyre, si dhe vlerësimet e vetë gjykatës lidhur me to. Në tërësi, argumentet e përdorura janë të qarta dhe bindëse, si dhe i japin në mënyrë transparente përgjigje kërkesave dhe kundërshtimeve të mbrojtësit të të pandehurit. Në jo pak raste në këto vendime përmenden edhe standartet e elaboruara në jurisprudencën e GJEDNJ-së. KSHH vlerëson se është e nevojshme që të ketë një përmbledhje më të sintetizuar dhe të qartë të fakteve të çështjes, duke shmangur perifrazimet mekanike të të dhënave që rezultojnë gjatë fazës së hetimeve paraprahe.

Gjatë kësaj periudhe, rezulton se janë dhënë 4 vendime fajësie nga GjKKO e Shkallës së parë për 4 të pandehur, 2 prej të cilëve të dënuar për veprën penale të parashikuar nga neni 257/a/2 i Kodit Penal që sanksionon fshehjen dhe deklarimin e rremë të pasurisë, dhe 2 të pandehurit e tjerë janë dënuar për korrupsionin pasiv të gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të sistemit të drejtësisë. Për 3 nga këto subjekte, GjKKO e Apelit ka disponuar me vendime të formës së prerë, me anë të të cilave është lënë në fuqi vendimi i dënimit ose është ndryshuar vendimi duke dhënë një lloj dhe masë pak më e ashpër dënimi.

METODOLOGJIA

Ky raport studimor është hartuar në tre pjesë të cilat kanë patur objekt të ndryshëm.

a. Seancat dëgjimore në KPK dhe KPA

Në pjesën e parë janë reflektuar gjetjet nga monitorimi i seancave dëgjimore të zhvilluara në KPK dhe KPA për të evidentuar sjelljen e trupës gjyquese në drejtim të respektimit të të drejtave procedurale të subjekteve të rivlerësimit.

Vëzhguesit e KShH kanë monitoruar seancat dëgjimore sipas një metodologjie të paracaktuar. Në fund të çdo seance ekspertët kanë përcjellë pranë stafit të KShH pyetësin për monitorimin e seancës dëgjimore si dhe një përmbledhje të elementëve kyç të seancës, të quajtur *factsheet*. Në disa raste, kur është konsideruar e përshtatshme dhe me interes për publikun nga stafi është vijuar dhe me publikimin e tyre.⁹

Gjatë kësaj periudhe (periudha nën vëzhgim) në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit janë përballur me rivlerësimin e tyre 35 subjekte, nga të cilat 26 subjekte janë monitoruar nga vëzhguesit e KShH-së.

Për disa nga subjektet e rivlerësimit janë realizuar më shumë se dy seanca dëgjimore, duke sjellë në total 29 seanca dëgjimore të monitoruara. Nga seancat e monitoruara 28 prej tyre janë seanca dëgjimore për relativimin e çështjes dhe vetëm 1 prej tyre është për shpallje vendimi. KShH nuk e vlerësoi të nevojshme ndjekjen e seancave për shpallje vendimi për shkak se vet seanca nuk kishte elementë proceduralë me vlerë për t'u pasqyruar në raport.

Në Komisionin e Posaçëm të Apelit ekspertët kanë monitoruar 6 seanca dëgjimore për 3 subjekte rivlerësimi. Për një subjekt janë përcaktuar 3 seanca dëgjimore publike. Nga seancat e zhvilluara 5 seanca kishin të bënin me relativimin e çështjes dhe 1 seancë për shpallje vendimi.

b. Vendimet e KPK dhe KPA-së

Në pjesën e dytë, janë analizuar vendimet e këtyre organeve ku përveçse janë analizuar aspektet procedurale, në vëmendje ka qenë edhe zbatimi i së drejtës materiale.

Për pjesën e analizës së vendimmarrjeve ekspertët e angazhuar të Komitetit Shqiptar të Helsinkit morën në shqyrtim 48 vendimmarrje të organeve përgjegjëse të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve (procesi i vetting-ut) për periudhën janar-nëntor 2022, përkatësisht 37 vendime të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe 11 vendime të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, të zbardhura dhe të shpallura të arsyetuara në faqet zyrtare të këtyre dy organeve kyç për realizimin e procesit të vetting-ut.

⁹ 19 prej factsheeteve janë publikuar duke informuar publikun në kohë reale për konstatimet e eksperteve duke mos i humbur aktualiteti.

Ekipi i ekspertëve, të cilëve iu besua ky proces i rëndësishëm analitik dhe studimor përfaqësojnë juristë me përvojë në të drejtën publike, administrative, kushtetuese dhe në fushën e avokatisë.

Nga pikëpamja metodologjike, ekspertët kanë mbledhur dhe përpunuar të dhënat e rezultuara nga vendimet, bazuar në një metodologji të mirë përcaktuar si dhe mbështetur në një pyetësor të standardizuar. Reflektimi i të dhënave të përpunuara në një version të dedikuar elektronik të pyetësorit, u realizua me mbështetjen e stafit të KShH-së, ndërkohë që në përpunimin cilësor të të dhënave u ruajt pavarësia, paanshmëria dhe bindja e brendshme profesionale e ekspertëve.

Në fokus të analizës së këtyre vendimmarrjeve janë pasqyrimi i sjelljes së trupës gjyqësore si në aspektin formal-procedural ashtu edhe në atë përmbajtësor, roli dhe ndërhyrja e vëzhguesve ndërkombëtarë, niveli i respektimit të parimit të publicitetit të seancës, garantimi i parimit të barazisë së armëve në proces, parimit të kontradiktoritetit dhe vlerësimi i nivelit të respektimit të barrës së provës, kohëzgjatja e procesit të vetting-ut dhe transparenca në arsyetimin e vendimmarrjeve, standardet e ndjekura në drejtim të analizës dhe zbatimit të kriterëve bazë të procesit të rivlerësimit kalimtar, si dhe vlerësim i përgjithshëm profesional i vëzhguesve mbi mbrojtjen e lirive personale dhe të drejtave të subjekteve që i janë nënshtruar procesit të vetting-ut.

c. Procedimet Penale ndaj Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të shkaruar apo dorëhequr si rrjedhojë apo përgjatë procesit të vettingut

Në pjesën e tretë është vlerësuar impakti që ka patur procesi i vetting-ut në veprimtarinë e organeve të sistemit të drejtësisë të ngarkuara me hetimin dhe gjykimin e veprave penale, përfshi këtu veprat penale në fushën e korrupsionit dhe krimit të organizuar si dhe ato të kryera nga subjektet e posaçme. Kampion i kësaj analize janë vendimet e prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm dhe prokurorisë së posaçme (mosfillimi, pushimi apo dërgim në gjykatë, si dhe kërkesat për konfiskim pasurie), vendimet gjyqësore penale ndaj subjekteve të procesit të rivlerësimit kalimtar (kryesisht gjyqtarë dhe prokurorë të dorëhequr apo shkarkuar nga procesi i vetting-ut, por edhe ata që janë në proces). Lidhur me vendimmarrjet e prokurorive dhe të gjykatave, studimi shtrihet në periudhën e viteve 2021 – 2022.

KShH është bazuar mbi një metodologji të hartuar nga ekspertë të fushës së legjislacionit penal, proceduralo-penal si dhe të legjislacionit të vetting-ut. KShH ka mundur të sigurojë vendimmarrjet e studiuara në këtë raport, me anë të kërkesave për informacion, bazuar në ligjin në fuqi për të drejtën e informimit nr.119/2014.

Në komunikimin elektronik të dt.23 Janar 2023, Prokuroria e Përgjithshme informon KShH-në se, nga informacioni i marrë nga prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm, vetëm prokuroritë e Tiranës, Elbasanit dhe Durrësit kanë konfirmuar fillimin apo mosfillimin e hetimeve penale për subjektet e vetting-ut. Më tej, KShH-së i rekomandohet të vijojë komunikimet e mëtejshme me këto prokurori për të disponuar informacionin e kërkuar.

Në dt.24.09.2023¹⁰, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë i përgjigjet kërkesës së KSHH-së duke

¹⁰ Shkresa me nr.prot 377/1, dt.24.03.2023, me lëndë “Kthim përgjigje” (Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së

vendosur në dispozicion të saj, pjesërisht informacionin e kërkuar, por jo dokumentacionin përkatës. Kjo për arsye se çështjet që lidhen me subjektet e procesit të rivlerësimit, rezultojnë ende në fazën e hetimeve dhe vendimet lidhur me këto subjekte mund të vihen në dispozicion vetëm në përfundim të hetimeve paraprake.

Në dt.31.03.2023, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës i përgjigjet pjesërisht kërkesës për informacion të KShH-së, duke vendosur në dispozicion 2 vendimmarrje për mosfillimin e procedimit penal ndaj subjekteve të rivlerësimit, si dhe janë vendosur në dispozicion të dhëna të përgjithshme mbi 4 subjekte të rivlerësimit, ndaj të cilëve ka nisur procedimi penal pranë kësaj prokurorie, dhe që vijojnë të jenë nën hetim¹¹. Si rrjedhojë e karakterit të përgjithshëm të informacionit, KShH, me shkresën e datës 08.09.2023 i drejtohet sërish me kërkesë për plotësim informacioni, Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës. Në përgjigjen e saj, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës ka dhënë informacion vetëm për të dhënat identifikuese (emër, mbiemër) të subjekteve, dhe datën e fillimit të procedimit penal, duke referuar se ato janë nën hetim¹².

Në dt.15.03.2023, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Elbasan i përgjigjet pjesërisht kërkesës për informacion të KShH-së, duke vendosur në dispozicion 2 vendimmarrje për mosfillimin e procedimit penal ndaj subjekteve të rivlerësimit, me funksion prokurorë¹³. Gjithashtu, në dispozicion të KShH është vendosur informacioni lidhur me procedimin penal të datës 26.05.2020, ardhur nga SPAK ndaj një ish gjyqtareje. Ky procedim i ka kaluar për kompetencë Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr.02.06.2021. Por lidhur me këtë çështje, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë nuk ka dhënë informacion.

SPAK ka informuar KShH lidhur me 8 procedime penale në total ndaj subjekteve të vetting-ut prej kësaj prokurorie, prej të cilave pesë procedime penale për vitin 2021 dhe 3 procedime penale për vitin 2022.¹⁴ Lidhur me këto procedime penale, 1 prej tyre është në hetim (deri në dt.2 Dhjetor 2022, kur është dhënë përgjigjia prej SPAK) dhe 7 prej tyre janë dërguar në gjykatë, ku një pjesë e tyre kanë rezultuar me vendimmarrje fajësie (sikurse do të analizohet në vijimësi). SPAK referon se nuk ka patur vendime të pushimit të procedimit penal si dhe transferime për mungesë të kompetencës lëndore, në prokuroritë e juridiksionit të zakonshëm. KShH i'u drejtua me kërkesa të veçanta për informacion prokurorëve të SPAK duke kërkuar akses në aktet që nuk janë sekret hetimor, si kërkesat për dërgimin për gjykim të çështjeve penale, kërkesat për konfiskimin e pasurisë, etj. Konkretisht:

Parë Tiranë i drejtohet KSHH-së).

¹¹ Shkresa me nr.prot. 396/1, dt.31.03.2023 me lëndë “Kthim përgjigje” (Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës i drejtohet KShH-së).

¹² Shkresa me nr.prot 1510/1, dt. 14.09.2023 “Kthim Përgjigje (Prokuroria pranë Gjykatës së shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm Durrës) drejtuar KShH-së.

¹³ Shkresa me nr.prot. 2605/1, dt.15.03.2023 me lëndë “Kthim përgjigje” (Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan i drejtohet KShH-së).

¹⁴ Shkresa me nr.prot.650, dt.05.12.2022, me lëndë “Kthim përgjigje tuajës nr.561, dt.31.10.2022”, (SPAK i drejtohet KShH-së).

- Në dt.16 Janar 2023, për subjektet e rivlerësimit B.D dhe Sh.S¹⁵. Informacioni i kërkuar u vendos në dispozicion të KShH-së brenda dy ditëve¹⁶.
- Në dt.16 Janar 2023, për subjektin e ri-vlerësimit M.S¹⁷. Informacioni i kërkuar u vendos në dispozicion të KShH-së, brenda 4 ditëve¹⁸.
- Në dt.16 Janar 2023, për subjektin e rivlerësimit A.L.L. Informacioni i kërkuar u vendos në dispozicion brenda 4 ditëve¹⁹.
- Në dt.16 Janar 2023, për subjektet e rivlerësimit E.H dhe S.H²⁰. Informacioni i kërkuar u vendos në dispozicion brenda 11 ditëve²¹.

Pasi mori informacionin nga prokuroritë e juridiksionit të zakonshëm dhe SPAK, KShH vijoi më tej me kërkimin e informacionit ndaj Gjykatës së Shkallës së Parë dhe asaj të Apelit, kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, pasi vetëm këto gjykata rezultojnë të kishin procese dhe/ose vendimmarrje ndaj subjekteve të vetting-ut. Konkretisht:

Në dt.17 Janar 2023, KShH j'u drejtua me kërkesë për informacion, Gjykatës së Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar²², për disponimin e vendimeve gjyqësore për 4 subjektet e procesit të vetting-ut, A.L.L, E.H, E.K dhe S.H, si dhe kopjet e vendimeve të dhëna nga kjo gjykatë në seancë paraprake, për kërkesat e prokurorëve të posaçëm ndaj të pandehurve (ish gjyqtarë dhe ish prokurorë) M.S, B.D dhe Sh.S. Informacioni i kërkuar u vendos në dispozicion të KShH dhe kopjet e këtyre vendimeve janë analizuar në këtë raport studimor.

Në dt.16 Janar 2023, KShH iu drejtua me kërkesë për informacion, Gjykatës së Posaçme të Apelit kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar²³, për disponimin e vendimeve gjyqësore të dhëna nga kjo gjykatë për 3 subjektet e procesit të vetting-ut, A.L.L, E.H, E.K. Informacioni i kërkuar u vendos në dispozicion të KShH në rrugë elektronike, ndaj kopjet e këtyre vendimeve janë analizuar në këtë raport studimor. Ndërkohë që kjo Gjykatë, informon KShH se nuk ka patur ankime në këtë periudhë ndaj vendimeve të gjyqtarit të seancës paraprake, që shqyrton kërkesën e prokurorisë për dërgimin e çështjes në gjyq pranë GJKKO- së në Shkallë të Parë.

Pjesë e metodologjisë së monitorimit ka qenë gjithashtu marrja e të dhënave zyrtare nga institucionet e rivlerësimit kalimtar, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (KPK) dhe Kolegji i Posaçëm i Apelit, lidhur me numrin e subjekteve të shkarkuar, të dorëhequr, funksionet që ata kanë patur, numrin e subjekteve të kallëzuar penalisht nga këto institucione, në zbatim të nenit 281/3 të Kodit të Procedurës Penale, nëse ka patur raste kur prokuroritë janë vendosur në lëvizje

¹⁵ Shkresa me nr.prot 23, dt.16.01.2023 me lëndë “Kërkesë për informacion dhe vënie në dispozicion të dokumentacionit” (KShH i drejtohet prokurorës së posaçme D.M)

¹⁶ Shkresa me nr.prot 687/1, dt.18.01.2023 me lëndë “Dërgim informacioni dhe dokumentacioni” (Prokurorja e posaçme D.M i drejtohet KShH-së).

¹⁷ Shkresë me nr.prot.21, me lëndë “Kërkesë për informacion dhe vënie në dispozicion të kopjes së dokumentacionit”.

¹⁸ Shkresa me nr.port 688/1, dt.20.01.2023.

¹⁹ Përgjigje me email e dt.20 Janar 2023 nga prokurori i çështjes si dhe me shkresën zyrtare me nr.686/1, dt.23.01.2023 të Kreut të SPAK (deleguar tek drejtuesi i seksionit për firmë).

²⁰ Shkresa me nr.prot 22, me lëndë “Kërkesë për informacion dhe vënie në dispozicion të kopjes së dokumentacionit”.

²¹ Shkresa e SPAK me nr.prot 685, dt. 27.01.2023, me lëndë “Kthim Përgjigje”

²² Shkresa me nr.prot 35, me lëndë “Kërkesë për informacion dhe vënie në dispozicion të kopjes së dokumentacionit”.

²³ Shkresa me nr.prot 29, me lëndë “Kërkesë”.

me iniciativën e tyre për të filluar procedimin penal, pasi procesi i vetting-ut ka karakter publik²⁴. Gjithashtu është kërkuar shkëmbim i korrespondencës midis organeve të vetting-ut dhe prokurorisë, në kuadër të informacionit lidhur me kallëzimet penale apo fillimit të çështjes me iniciativë. KPK²⁵ i është përgjigjur pjesërisht kërkesës për informacion të KShH-së ndërkohë që KPA²⁶ është përgjigjur plotësisht (të dhënat do të analizohen në vijimësi).

d. Kufizimet Metodologjike

Në përfundim, vlen të theksohet se për të tre pjesët e këtij raporti studimor, plotësia e informacionit të analizuar, përbën edhe kufizimin në hartimin e tij. Në kushtet kur jo të gjitha zyrat e prokurorisë apo KPK është përgjigjur në mënyrë të detajuar me të dhëna të sakta, si dhe duke mos patur në fokus të studimit aktet e tjera të fashikullit hetimor të dosjeve penale apo të fashikullit të dosjeve të organeve të vettingut (ku janë të administruara provat për subjektet), mund të thuhet se autorët e këtij raporti kanë patur një kufizim metodologjik.

Një element i tillë është mbajtur parasysh prej tyre, në studimin e akteve procedurale të administruara si dhe në formulimin e gjetjeve dhe konkluzioneve. Pavarësisht këtij kufizimi, Komiteti i Helsinkit është kujdesur të zbërthejë këto të dhëna, duke i vlerësuar ato në kontekst.

²⁴ Shkresa me nr.prot 532 dhe 532/1, dt.26 Tetor 2022, me lëndë “Kërkesë për informacion dhe vënie në dispozicion të kopjes së dokumentacionit”, dërguar nga KShH për Komisionin e Pavarur të Kualifikimit dhe Kolegjin e Posaçëm të Apelit.

²⁵ Shkresa me nr.prot 4058/1, dt.11.11.2022, me lëndë “Kthim përgjigje kërkesës suaj për informacion” (KPK i drejtohet KShH-së)

²⁶ Shkresa me nr.prot 1449/1, dt.07.11.2022 me lëndë “Kthim përgjigje kërkesës për informacion” (KPA i drejtohet KShH-së)

PJESA I
MONITORIMI I SEANCAVE DËGJIMORE²⁷


²⁷ 12 tetor-22 dhjetor 2022

1. Monitorimi i seancave në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit dhe në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit

Në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, gjatë periudhës 12 tetor - 22 dhjetor 2022 janë konfirmuar në detyrë 22 subjekte, janë shkarkuar 3 subjekte dhe 1 subjekt ka kërkuar mbarimin e statusit të magjistratit. Subjektet e rivlerësimit gjatë periudhës së monitorimit kanë qenë 16 të profilit gjyqtar dhe 10 subjekte të rivlerësimit të profilit prokuror.

Të dhënat nga vëzhgimi, tregojnë që seancat dëgjimore, gjatë kësaj periudhe, në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit kanë qenë të një ritmi të shpejtë ku pothuajse çdo ditë janë planifikuar seanca dëgjimore dhe jo në pak raste janë planifikuar dhe 3 seanca dëgjimore brenda së njëjtës ditë.


KShH konstaton se vrulli i seancave dëgjimore në dy muajt e fundit të vitit tregon për devotshmërinë për t'i përmbyllur seancat dëgjimore brenda vitit 2022. I njëjti ritëm nuk evidentohet në vitin 2023, duke qenë se planifikimi tashmë konsiston në 1 deri në 2 seanca në javë.



Një situatë e ndryshme paraqitet në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit ku ritmi i seancave dëgjimore publike është më i ngadaltë. Kjo si rrjedhojë edhe e numrit më të ulët të anëtarëve që mundëson funksionimin në të njëjtën kohë vetëm të një trupe gjykimi dhe jo më shumë. Në periudhën e monitorimit nga KShH janë zhvilluar gjithsej 6 seanca publike për 3 subjekte rivlerësimi, të tre subjekte të monitoruar nga ekspertët e KShH-së. Për njërin nga subjektet e rivlerësimit janë zhvilluar gjithsej 3 seanca dëgjimore pasi trupi gjykues vendosi të çelë hetimin gjyqësor të çështjes dhe të pranojë në cilësinë e provës aktet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit. Për një tjetër subjekt fillimisht ishte vendosur që të gjykohej në dhomë këshillimi dhe më pas u vendos të kalohej në seancë publike.²⁸

²⁸ Subjekti rivlerësimit H.M. KPA kishte njoftuar me herët se kishte vendosur në dhomë këshillimi, gjykimin e çështjes në seancë gjyqësore publike bazuar në nenin 51 pika 1, shkronja b të Ligjit 49/2012 “Për Gjykatat Administrative dhe gjykimin e mosmarreveshjeve administrative”.

Në periudhën e monitorimit në KPA janë zhvilluar në total 16 seanca nga të cilat 10 seanca në dhomë këshillimi dhe 6 seanca publike.



Nga subjektet e monitoruara për të cilët rezulton se është zhvilluar një seancë publike gjatë kësaj kohe në KPA rezulton se dy prej tyre janë konfirmuar në detyrë nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit dhe një prej tyre është shkarkuar. Për subjektet e konfirmuara në detyrë, Komisioneri Publik ka ushtruar të drejtën e ankimit ndaj vendimit.²⁹ Të tre subjektet e monitoruara janë të profilit gjyqtar. Në të tre rastet KPA ka vendosur lënien në fuqi

të vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

2. Seanca dëgjimore

2.1. Seancat dëgjimore të zhvilluara në KPK: Vlerësime të përgjithshme dhe solemniteti

KPK i zhvillon procedurat e rivlerësimit për subjektet në zbatim të nenit 55 të ligjit 84/2016 të vettingut. Duke patur parasysh respektimin e elementëve formalë dhe solemnitetit gjatë seancave të monitoruara është konstatuar se trupa gjyqese kujdeset që pas shpjegimit të procedurës së zhvillimit të seancës dëgjimore të vijoje me prezantimin e trupit gjykues, të sekretarit të çështjes, vëzhguesit ndërkombëtar dhe prezantimit të subjektit të rivlerësimit ku bëhet dhe identifikimi i gjeneraliteteve të tij dhe ftohet të regjistrohet pranë sekretarit. Më tej seanca vijon me njoftimin ku falënderohet publiku dhe media e pranishme duke bërë me dije që nuk lejohet filmimi vizual i seancës dhe se përdorimi i mjeteve elektronike duhet të jetë pa zë.

Në fjalën e tij hyrëse të çdo seance dëgjimore të monitoruar nga KShH, subjekti i rivlerësimit konfirmon marrjen e dosjes hetimore nga prej tij në përputhje me nenin 47 të ligjit 84/2016 dhe neneve 45-47 të Kodit të Procedurave Administrative. Më tej, subjekti paraqet shpjegimet në raport me relatimet e bëra. Pas këtij momenti anëtarëve të trupit gjykues si dhe përfaqësuesit të ONM-së u lind e drejta të drejtojnë pyetje. Në përfundim të seancës ftohet subjekti i rivlerësimit për të shprehur qëndrimin e tij në lidhje me procedurën e ndjekur.

Vlen të theksojmë se vëzhguesit nuk kanë konstatuar vonesa në fillimin e seancave gjyqësore duke e konsideruar veprimtarinë e KPK-së të përpiktë në respektimin e orarit. Ky konstatim vlen dhe për pushime të ndërmjetme ku trupa gjyqese është kthyer në sallën e gjyqimit në orarin e përcaktuar. Kohëzgjatja mesatare e seancave ka qenë 1 deri në 3 orë dhe vetëm dy prej tyre kanë zgjatur më shumë se 3 orë. Seanca më e gjatë është zhvilluar për 10 orë gjatë një dite. Gjatë kësaj seance vëzhguesi i KShH ka konstatuar prirjen e vetë subjektit të rivlerësimit për të shtyrë kohëzgjatjen e seancës, duke kërkuar pushime të herëpashershme (jo gjithmonë të pranuar nga trupa gjyqese), konsultime me përfaqësuesin ligjor jashtë sallës së gjyqimit për disa minuta dhe

²⁹ Në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore ka të drejtën të ushtrojë të drejtën e ankimit.

kërkesa për shtyrje të seancës për shkak se subjektit i rivlerësimit ndihej i lodhur.³⁰ Sikurse e kemi evidentuar edhe në vijimësi për KPA-në, nevoja për gjykim të pandërprerë nuk duhet të cenonjë mbarëvajtjen e rregullt të procesit dhe efektshmërinë e tij.

Në përgjithësi seancat dëgjimore nuk janë shtyrë për mungesë gjyqtarësh ose subjektet e rivlerësimit. Në gjithë seancat e monitoruara ka patur 3 seanca të shtyra. Për shkak të zgjatjes së paparashikuar të një seance të planifikuar në një orë më të hershme, pësuan shtyrje 2 seanca të parashikuara për atë ditë.³¹ Në një çështje u kërkua shtyrja e seancës dëgjimore pasi subjekti i rivlerësimit ka paraqitur pranë KLGJ-së kërkesën për mbarim të statusit të magjistratit nëpërmjet dorëheqjes,³² për shkak të daljes në pension të parakohshëm, bazuar në pikën 1(a), të nenit 64, të ligjit nr. 96/2016.

2.2 Seancat dëgjimore në KPA: Vlerësime të përgjithshme dhe respektimi i solemnitetit

Seancat e zhvilluara pranë KPA respektojnë solemnitetin. Në KPA, trupa gjyquese e përbërë me 5 anëtarë në përputhje me nenin F të Aneksit të Kushtetutës, çel seancën dëgjimore publike me verifikimin e palëve në procesin gjyqësor duke filluar nga trupa gjyquese, Komisioneri Publik (KP), subjekti i rivlerësimit, vëzhguesit ndërkombëtarë dhe sekretari gjyqësor, si pjesë e procedurës së zakonshme në frymën e parimit të transparencës si dhe ruajtjes së solemnitetit të seancës.³³ Pas këtij momenti subjekti i rivlerësimit dhe KP konfirmojnë aksesin në dosjen gjyqësore dhe dokumentet/parashtrimet e palëve ndërgjyqëse konform nenit 47 të ligjit nr 84/2016 të vettingut.

Megjithatë, nga vëzhgimi i ekspertëve të angazhuar në seancat dëgjimore të vëzhguara është konstatuar se në KPA nuk relatohet çështja gjyqësore sipas nenit 464 apo 483 të KPrC. Përveç se ky është një detyrim ligjor, publiku i thjeshtë e ka të vështirë të kuptojë natyrën dhe rolet procedurale në këtë proces gjyqësor.

Pushimet e ndërmjetme në seancën dëgjimore kanë qenë të shpeshta, por jo gjithmonë janë respektuar afatet për fillimin e saj. Në një seancë është vënë re dhe një vonesë prej rreth 60 minutash për fillimin e saj. Trupa gjyquese nuk arsyetoi shkaqet e vonesës në fillimin e seancës gjyqësore, ndërkohë që në faqen zyrtare në internet të KPA nuk kishte të parashikuara seanca gjyqësore të tjera në atë datë. Për subjektin e rivlerësimit E.T, seanca gjyqësore datë 05.12.2022 ka zgjatur më tepër se 5 orë. Gjatë procesit, vërehet një volum i lartë i provave të paraqitura nga subjektet e rivlerësimit, ndërkohë që palët kanë relatuar qëndrimet e tyre në mënyrë që të sigurohej përkthimi në gjuhë të huaj për vëzhguesin e ONM. Gjatë dy pushimeve të realizuara përgjatë kësaj seance, orari i rifilimit të tyre nuk është respektuar nga trupa gjyquese. Pavarësisht se KPA ka respektuar parimin e gjykimit të pandërprerë, del në pah edhe nevoja për ruajtjen e balancës në raport me efikasitetin procedural.

³⁰ Seanca dëgjimore për subjektin e rivlerësimit A.Y.

³¹ Seanca dëgjimore e subjektit të rivlerësimit A.Y në datë 14.04.2022 ka zgjatur më shumë duke shkaktuar shtyrje të dy seancave të parashikuara për dy subjektet e tjerë të rivlerësimit për S.P dhe R.K

³² Perfaqesuesja ligjore kërkoi ndërprerjen dhe shtyrjen e seancës dëgjimore me arsyetimin se subjekti në datën 05.11.2022 ka paraqitur pranë KLGJ kërkesën për mbarimin e statusit të magjistratit nëpërmjet paraqitjes së dorëheqjes, bazuar në pikën “a”, pika 1, të nenit 64, të ligjit nr. 96/2016.

³³ Neni 461 i Kodit të Procedurës Civile

Në seancën dëgjimore të zhvilluar në KPA për subjektin e rivlerësimit H.M., është vendosur marrja e një pushimi të ndërmjetëm në dhomë këshillimi me një afat kohor prej 1 orë e 30 minuta. Ky pushim cilësohet nga vëzhguesi i KShH-së si i tepërt dhe jo efikas, pasi në dukje nuk kishte kërkesa të reja gjatë seancës. Për këtë subjekt rivlerësimi, konstatohet se fillimisht KPA kishte vendosur që seanca të zhvillohej në dhomë këshillimi por më pas u vendos që seanca të zhvillohej publike për korrigjimin e shkeljeve procedurale të KPK-së. Seanca publike jep më shumë garanci se ajo në dhomë këshillimi. Gjith, vëzhguesi raporton se në këtë seancë dëgjimore trupi gjykues nuk informoi konkretisht se cilat ishin shkeljet e rënda procedurale, mbi vendimin e KPK si dhe as nuk relatoi çështjen sipas nenit 464 apo 483 të Kodit të Procedurës Civile. Edhe avokati i subjektit të rivlerësimit, në fillim të fjalës së tij kërkoi të informohej mbi shkeljet e rënda procedurale të KPK, që KPA i ka vlerësuar si të tilla. Nga parashtrimet e subjektit të rivlerësimit u pretendua se vendimi i KPK nuk është nënshkruar nga ana e relatorit dhe nuk është arsyetuar nga ana e tij sipas nenit 308 të Kodit të Procedurës Civile (KPrC), relatori në çështjen e KPK-së ka qenë më herët i shkarkuar nga ish-Këshilli i Lartë i Drejtësisë dhe në kuptim të nenit 107-108 të Kodit të Procedurave Administrative dhe Nenit 123 të KPrC, vendimi i KPK është absolutisht i pavlefshëm, duke paralelizuar me vendimin gjyqësor të GJEDNJ “Canë kundër Shqipërisë”, gjithashtu vlerësimi pasurisë nga ana e KPK është realizuar jo në përputhje me ligjin 84/2016 dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit. Subjekti i rivlerësimit kërkoi administrimin provave të reja, çeljen e hetimit gjyqësor dhe kthimin për rigjykim të çështjes. Trupa gjykuese pas marrjes së vendimit të ndërmjetëm në dhomë këshillimi vendosi të riçelë hetimin gjyqësor dhe administrimin e provave të reja të depozituar nga subjekti si dhe rrëzimin të gjithë kërkesave të tjera.

Këtë seancë vëzhguesi i KShH-së nuk e ka ndjekur fizikisht, por ndodhej në korridorin e KPA-së për të monitoruar seancën nga ekrani audioviziv, i cili ndodhej ngjitur me derën e dhomës së këshillimit të KPA. Vëzhguesi i KShH-së ka konstatuar se dhoma e këshillimit frekuentohej nga këshilltarët ligjor kur trupa gjykuese ishte tërhequr për të marrë vendim të ndërmjetëm në dhomë këshillimi.³⁴

Po në këtë seancë nuk ka qenë shumë i qartë vendimi i ndërmjetëm i KPA, në të cilën Kolegji do të realizonte një analizë financiare të re për subjektin e rivlerësimit, rezultati i të cilit, subjektit të rivlerësimit do t'i bëhet me dije në shpalljen e vendimit përfundimtar ose vendimit të arsyetuar. Për sa më sipër edhe avokati i subjektit, i kërkoi se përse rezultati i analizës së re financiare të subjektit të rivlerësimit, të mos bëhej me dije para shpalljes së vendimit dhe t'i nënshtrohej debatit gjyqësor. Trupa gjykuese nuk dha shpjegime ligjore, vetëm konfirmoi vendimmarrjen e saj. Vëzhguesi i KShH-së, bazuar në informacionin e marrë gjatë seancës vlerësoi nevojën për respektimin e parimit të kontradiktoritetit, referuar nenit 19 dhe 20 të KPrC.³⁵

³⁴ Neni 306 i Kodit të procedurës Civile citon se: Në dhomën e këshillimit, kur bisedohet çështja dhe përpilohet vendimi, qëndrojnë vetëm gjyqtarët që përbëjnë trupin gjykues. Nuk lejohet që gjatë bisedimit të çështjes të hyjnë e të qëndrojnë aty sekretari i seancës, ekspertë ose persona të tjerë.

³⁵ Neni 19 Palët duhet t'i bëjnë të njohur njëra-tjetrës, në kohën e duhur, mjetet dhe faktet mbi të cilat mbështesin pretendimet e tyre, provat që do të paraqesin dhe dispozitat ligjore që do t'u referohen, në mënyrë që të bëhet e mundur për secilën palë mbrojtja e interesave të tyre në gjykim.

Neni 20 Gjykata duhet të ndjekë dhe të kërkojë të zbatohet parimi i kontradiktoritetit. Ajo mbështet vendimin e saj vetëm në mjetet, shpjegimet, dokumentet e provat e tjera të treguara ose të sjella nga palët, kur këto të fundit kanë

Në një tjetër seancë dëgjimore për subjektin e rivlerësimit M.A seanca e parashikuar i ishte dedikuar vetëm paraqitjes së konkluzioneve përfundimtare me shkrim nga Komisioneri Publik dhe subjekti i rivlerësimit. Trupa gjyquese, pas përfundimit të fjalës nga Komisioneri Publik, i parashitroi pyetje, për të cilat KP kërkoi kohë për t'u përgjigjur dhe për të paraqitur fakte të reja. Tërheq vëmendjen fakti se në kuptim neneve 302-303 të KPrC, dhe të dispozitave pararendëse, trupa gjyquese i kishte dhënë fund më herët hetimit gjyqësor.

3. Të dhëna mbi vendimmarrjen, dinamikën, transparencën e procesit të “Vetting”

Parimi i transparencës është një parim themelor i zhvillimit të procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, pasi vetëm përmes procedurave të hapura dhe transparente, grupet e interesit dhe publiku informohen për ecurinë dhe rezultatet e këtij procesi që si objektiv madhor ka rikthimin e besimit të publikut tek drejtësia. Për këtë arsye ekzistojnë shumë garanci në kuadrin rregullues të të gjithë procesit që synojnë të mbrojnë fort këtë parim themelor të procesit. Në këtë kontekst, transparenca sigurohet jo vetëm përmes mundësisë për të ndjekur çdo seancë për të cilën të tretët mund të kenë interes, por edhe duke publikuar çdo vendimmarrje të organeve të vetting-ut. Rëndësi të madhe në këtë këndvështrim kanë vendimet e arsyetuara të KPA-së dhe KPK-së, ku subjekti i rivlerësimit gjen arsyet e vendimmarrjes përkatëse, si dhe përgjigjet për pretendimet e tij, por edhe personat e interesuar ndjekin qëndrimet e mbajtura nga KPK dhe KPA.

3.1. Publikimi i vendimeve nga KPK dhe KPA

Me përjashtim të një rasti, vendimet e arsyetuara të KPK-së janë publikuar për subjektet e rivlerësimit brenda afat ligjor të parashikuar. Konkretisht, për prokurorin K.Sh, vendimi është dhënë në datë 12.12.2022 ndërsa publikimi i vendimit në faqen zyrtare të KPK ka ndodhur në datë 21.02.2023 në cenim të afatit 30 ditor nga data e seancës dëgjimore, të parashikuar në nenin 55/7 të ligjit nr. 84/2016³⁶.

Ndonëse, në përputhje me nenin 55 (6) të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve” vendimi shpallet në fund të seancës dëgjimore, përjashtimisht vendimi është shpallur në të njëjtën ditë me seancën dëgjimore vetëm për një subjekt rivlerësimi.³⁷ Për të gjithë subjektet e tjerë shpallja e vendimit është bërë duke filluar nga e nesërmja e datës së dhënies së vendimit dhe deri maksimalisht në 10 ditë pas përfundimit të seancës dëgjimore.

Për KPA-në, duke qenë se zbatohet ligji nr. 49/2012 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative”, vendimi i arsyetuar duhet të publikohet brenda 10 ditësh nga data e shpalljes.³⁸ Vëzhguesit e KShH-së nuk kanë raportuar vonesa në drejtim të respektimit të këtij afati.

qenë në gjendje të debatojnë sipas parimit të kontradiktoritetit. Mos njohja paraprakisht të provës së re të prodhuar nga Gjykata, do ti mohonte të drejtën e palës (subjektit të rivlerësimit) të prapësojë analizën e re financiare.

³⁶ Ligji ka parashikuar që vendimi me shkrim i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisioneri Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore. Vendimi publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit.

³⁷ Seanca për shpallje vendimi për subjektin e rivlerësimit E.B

³⁸ Neni 64 i ligjit 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

3.2. Publiciteti seancës dëgjimore

Për të realizuar me sukses këtë raport studimor të monitorimit të veprimtarisë së organeve të vetting-ut, KShH me anë të korrespondencës zyrtare me KPK dhe KPA ka rënë dakord për ndjekjen e seancave gjyqësore publike nga ana e vëzhguesve të angazhuar prej KShH.

Seancat dëgjimore në KPK janë publike.³⁹ KPK ka siguruar transparencë të plotë për të gjitha seancat dëgjimore, të cilat kanë qenë të hapura për publikun e thjeshtë, duke mos krijuar pengesa të asnjë lloji. Në sallën ku u zhvilluan seanca dëgjimore u lejuan, gazetarë, familjarë të subjektit të rivlerësimit, si dhe kushdo që ishte i interesuar. Në asnjë nga seancat dëgjimore nuk i është kërkuar askujt të largohej nga salla.

Ndërsa, në seancat e zhvilluara në KPA vëzhguesit e KShH-së nuk janë lejuar në sallë, pavarësisht se në shkresën zyrtare të saj, KPA njofton se mbetet në dispozicion për përmbushjen e misionit.⁴⁰

KPA i njofton seancat dëgjimore publike përmes faqes zyrtare të internetit, ku përcaktohet data, ora, vendi dhe trupa gjyqësore. Për këtë edhe subjekti i rivlerësimit është njoftuar me njoftim të posaçëm.⁴¹ Publikut nuk i është lejuar që të aksesojë sallën gjyqësore. Në momentin e hyrjes së publikut në godinë, pas kontrollit të sigurisë, vëzhguesit informohen se publiku nuk ka qasje në sallë, por seanca mund të monitorohet nëpërmjet një pajisje audiovizive (televizor). Ekrani televiziv ndodhet në korridor (jo në një dhomë apo sallë të veçantë të KPA-së), ku kalojnë persona nga administrata, rojet, persona të tretë që kryenin shërbime ndaj KPA-së. Në korridor ka zhurma, mjeti audioviziv ka herë pas here probleme me audion, për shkak dhe të mikrofonit, ose të volumit të ulët të zërit të personit që ka të drejtën e fjalës. Ekrani pasqyron pamje të gjithë sallës së seancës dëgjimore, kur flet ndonjë prej anëtarëve të trupës gjyqësore dhe vetëm të tavolinës së subjektit kur flet ky i fundit. Në bazë të informacioneve të kërkuara nga koordinatori për të drejtën e informimit u sqarua se KPA vazhdon të respektojë masat anti Covid, që ndonëse janë shfuqizuar nga Ministria e Shëndetësisë, rregullorja nuk është shfuqizuar ende nga Ministria e Drejtësisë dhe për këtë kanë dërguar shkresë zyrtare dhe nuk kanë akoma përgjigje.⁴² Kjo qasje është e pakuptimtë tashmë kur të gjitha gjykatat e tjera në Shqipëri, i zhvillojnë pa kufizime seancat gjyqësore publike. Vërehet se nga masat anti-Covid, respektohet vetëm mosprania në sallë e publikut, pasi të tjerat si për shembull, mbajtja e maskave, apo higjienizuesve, ruajtja e distancave mes personave të pranishëm në sallë nuk respektohen. Në kushtet kur KPA zbaton ende masat anti-Covid, nëse sallat që përdorin aktualisht nuk sigurojnë praninë e publikut të interesuar në sallë, duhet të vlerësojë mundësinë për zhvillimin e këtyre seancave në një mjedis të përshtatshëm për të siguruar publicitetin maksimal të seancës.

Në përfundim, konstatohet se mos prania e publikut në zhvillimin e seancës gjyqësore, është në

³⁹ Në përputhje me nenin 55 pika 2 të Ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në republikën e Shqipërisë” dhe neni 20 të ligjit për “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

⁴⁰ Shkresa nr. 3910/1 prot., e datës 24.10.2022 të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

⁴¹ Njoftimi në faqen e ëeb të KPA, me ngjyre të kuqe dhe me shënim Seancë Publike.

⁴² Bëhet fjale për rregulloren e KPA date 12.06.2020 “Për përcaktimin e masave për kufizimin e përhapjes së infeksionit Covid-19 gjatë ushtrimit të veprimtarisë gjyqësore dhe administrative të Kolegjit të Posaçëm të Apelit”, rregullore që mesa duket është akoma në fuqi

thyerje të plotë të parimeve për një seancë publike dhe dispozitave ligjore të cilat, normojnë procedurat në KPA.⁴³ KShH i është drejtuar KPA me shkresë zyrtare duke rekomanduar rishikimin e Rregullores, parashikimet e të cilës krijojnë premisa për cenimin e parimit të publicitetit, element i rëndësishëm i të drejtës për një proces të rregullt.⁴⁴ Në vlerësimin e KShH, transmetimi live i seancave publike të KPA-së për personat e interesuar nuk garanton të njëjtin nivel aksesit dhe rrjedhimisht edhe kuptueshmëri të mbarëvajtjes së procesit dhe vëzhgimit të sjelljes së secilës palë në seancë, si dhe në rastet kur publiku është prezent fizikisht në sallë. Lidhur me këtë shkresë, KShH nuk ka marrë përgjigje nga KPA.

3.3. Njoftimi i seancave dëgjimore në KPK

Gjatë periudhës objekt monitorimi, seancat dëgjimore të zhvilluara pranë KPK-së kanë qenë të shpeshta, ku gati çdo ditë ka qenë e planifikuar së paku një seancë dëgjimore. Megjithatë, nga monitorimi i kujdesshëm i vëzhguesve të KShH-së është konstatuar se data dhe të dhënat e tjera të seancës publike, nuk janë njoftuar për të gjithë subjektet e rivlerësimit sipas të njëjtit standard. Është vënë re problematika e mos publikimit në kohë të arsyeshme të datave të seancave dëgjimore, duke qenë se faqja e Komisionit të Pavarur e Kualifikimit nuk ka funksionuar rregullisht përherë. Këto probleme teknike sjellin si pasojë njoftimin në afate shumë të ngushta të seancës dëgjimore duke pamundësuar ose vështirësuar ndjekjen e saj nga personat e interesuar. Në disa raste është evidentuar se seancat janë publikuar në faqen e internetit dhe pas orarit zyrtar të punës duke bërë që të publikohen dhe në orët e vona të mbrëmjes për seanca të planifikuara ditën e nesërme.

Kjo situatë nuk sjell asnjë problematikë për subjektin e rivlerësimit pasi ai, sipas relativitetit në seancë gjyqësore, ka marrë njoftim nëpërmjet email-it dhe në asnjë rast nuk janë shprehur vërejtje mbi njoftimin e datës së zhvillimit të seancës. Por, kjo është një praktikë që pengon ndjekjen e seancës nga personat e tretë të interesuar, të cilët duhet të kenë së paku, kohën e mjaftueshme për t'u njoftuar për seancën dhe për të bërë planifikimet e nevojshme për ndjekjen e saj.

Përkundër kësaj situate, në publikimet e seancave pranë KPA nuk është konstatuar diçka e ngjashme. Seancat, qoftë ato të zhvilluara si publike apo në dhomë këshillimi, njoftohen kohë përpara zhvillimit duke ruajtur të njëjtin standard për të gjithë subjektet e rivlerësimit.

3.4 Respektimi i etikës gjatë seancave dëgjimore

Në lidhje me këtë element nga ana e trupës gjyqësore nuk janë konstatuar shkelje apo presione të asnjë lloji nga ana e trupës gjyqësore para, gjatë apo pas përfundimit të seancës dëgjimore në KPK kundrejt subjektit të rivlerësimit. Por, në disa raste është konstatuar se anëtarë të trupës gjyqësore apo edhe përfaqësuesi i ONM-së ka qenë në përdorim të vazhdueshëm të celularit. Pavarësisht se në fillim të çdo seancë dëgjimore jepet lajmërimi që nuk lejohet përdorimi i mjeteve telefonike me

⁴³ Neni 9 i Rregullores “Për përcaktimin e masave për kufizimin e përhapjes së Infeksionit covid-19 gjatë ushtrimit të veprimtarisë Gjyqësore dhe administrative të Kolegjit të Posaçëm të Apelit” si neni nr. 65 pika 1 të Ligjit 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; neni 20 dhe 51 të Ligjit Nr. 49/2012 “Për Gjykatat Administrative dhe gjykimin e mosmarreveshjeve administrative”,

⁴⁴ Me shkresën nr. 637 datë 25.11.2022 KSHH I drejtohet KPA, me objekt “Rekomandohet rishikimi i Rregullore së KPA dt.20.06.2020 që krijon premisa për cenimin e parimit të publicitetit, element i rëndësishëm i të drejtës për një proces të rregullt”.

zë, efektivisht, në disa seanca është vënë re përdorimi i tyre paksa i tejzgjatur, prej vetë trupës që përbën një cenim të normave të etikës dhe ruajtjes së solemnitetit të procesit. Përdorimi i tejzgjatur dhe i vazhdueshëm i telefonit, apo manifestimi i sjelljeve të tjera si mos-interesim gjatë seancës, mungesa e pyetjeve drejtuar subjektit të rivlerësimit, mund të perceptohen si shfaqje e paragjykitimit të çështjes. Prandaj, është i rëndësishëm edhe respektimi i këtyre normave të etikës në mënyrë që të ruhet serioziteti i seancës, por edhe i procesit.

Për shembull, në seancën dëgjimore për subjektin e rivlerësimit E.GJ. është vënë re komunikim i përsëritur dhe i pavend nga kryesuesja dhe një anëtare e trupit gjykues, përdorimi i celularit dhe letërkëmbimi me shënime në letra. Marrja e një vendimi të pakonsultuar me dy anëtarët e tjera të trupës dhe i paarsyetuar për pjesëmarrësit në sallë, për një pushim prej 5 minutash pasqyroj gjithashtu një sjellje tjetër jo etike prej saj.

Për sa i përket seancave dëgjimore në KPA, për shkak të monitorimit të seancës gjyqësore nga një ekran audioviziv, jashtë sallës, është e pamundur për të monitoruar sjelljen apo aktivitetin e trupit gjykues. Ekran audioviziv, në momentin kur fliste subjekti, nuk fokusonte trupën gjykuese. Bazuar vetëm nëpërmjet mjetit audioviziv dukej që trupa gjykuese paraqet sjellje profesionale, të gatshëm për të hetuar dhe për të dëgjuar subjektin. Nuk paraqiten shfaqje të paragjykitimit apo të anshmërisë.⁴⁵

4. Kushtet e sallës

4.1. Kushtet e sallës për seancat e zhvilluara në KPK

Për seancat dëgjimore në KPK është përdorur vetëm një sallë⁴⁶. Pavarësisht numrit të kufizuar të mjediseve në dispozicion, puna është mirë-organizuar pasi nuk ka patur përplasje apo shtyrje të seancave të tjera të planifikuara më herët.⁴⁷ Përmasat e sallës janë konsideruar të mjaftueshme për të siguruar akses të mirë të të gjithë të pranishmëve dhe publikut. Salla është vlerësuar me ndriçim të mirë dhe me ajër të kondicionuar, e cila ofron komoditet dhe standard të duhur për zhvillimin e procesit, duke marrë në konsideratë edhe përmasat e saj të mjaftueshme. Përmasat e mëdha të sallës respektonin parimin e konfidencialitetit, ku trupi gjykues, vëzhguesi ndërkombëtar, subjekti i rivlerësimit dhe mbrojtësi i tij ligjor ishin të akomoduar në distancë të mjaftueshme nga njëri-tjetri duke respektuar solemnitetin, etikën dhe mos-intimidimin e subjektit të rivlerësimit. Trupi gjykues, vëzhguesi ndërkombëtar dhe subjekti i rivlerësimit ishin të pajisur me mikrofona, foni dhe dëgjohej qartë çdo fjalë e artikuluar prej tyre. Vlen për t'u përmendur që për pyetjet e drejtuara nga vëzhguesi ndërkombëtar, në sallë nuk është vendosur ndonjë pajisje përkthyes për publikun, vetëm subjekti i rivlerësimit ishte i pajisur me kufje të nevojshme për të dëgjuar përkthimin. Me përjashtim të një rasti kur kryesuesja e trupit gjykues kërkoi nga stafi prezent që vëzhguesi i KShH-së të pajisej me kufjet e nevojshme gjatë pyetjeve të vëzhguesit ndërkombëtar.

4.2. Kushtet e sallës për seancat e zhvilluara në KPA

Në KPA ka qenë e pamundur të vlerësohen kushtet e sallës, pasi sikurse është përmendur më herët,

⁴⁵ Referuar nenit 4 pika 5 te Ligjit Nr. 84/2016 apo nenit 14 te K.Pr.Civile.

⁴⁶ Pallati i koncereteve, Salla B, Kati 0

⁴⁷ Këtu përjashtohet rasti i senacës maratonë të subjektit të rivlerësimit A.Y i cili zgjati më shumë se 10 orë.

vëzhguesit të KShH nuk i është lejuar akses në sallë.

5. Procesi i rregullt ligjor

Organet e procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, në përmbushje të misionit të përcaktuar nga kushtetuta dhe nga ligji, duhet domosdoshmërisht të garantojnë një trajtim të subjekteve të rivlerësimit sipas parimit të barazisë, ligjshmërisë, proporcionalitetit dhe sigurisht të garantohet e drejta e tyre për një proces të rregullt ligjor. Kjo, jo vetëm si garanci individuale, por edhe si garanci për procesin në tërësi, për të ruajtur integritetin dhe qëndrueshmërinë e tij.

Në tërësi, duke iu referuar jurisprudencës së Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut (GjEDNj), me përjashtim të disa gjetjeve dhe përfundimeve të disa raste prej kësaj gjykate, procedurat e përcaktuara nga kuadri kushtetues dhe ligjor, si dhe respektimi i tyre prej organeve të vetting-ut e kanë kaluar testin e kësaj gjykate për pajtueshmëri me garancitë procedurale të nenit 6 të KEDNj-së.⁴⁸

Procesi i rregullt ligjor, është një koncept i gjerë për hir të së vërtetës, por me një gjuhë të thjeshtë do të kuptohet si mundësia e palës në proces për t'u gjykuar nga një trupë e pavarur dhe e paanshme, për t'u njohur me rezultatet e hetimit, për t'u mbrojtur e për të paraqitur të gjithë provat që vlerëson të përshtatshme për mbështetjen e argumenteve të saj, si dhe dhënien e një vendimi të arsyetuar që adreson pothuaj të gjitha kërkesat e paraqitura nga pala.

Në fakt, një nga problematikat e ngritura nga subjektet e rivlerësimit që kanë paraqitur ankesë në GjEDNj ka qenë e lidhur me barrën e provës. Nga vlerësimi i vendimeve të GjEDNj-së, subjektet e rivlerësimit si kërkues kanë pretenduar një barrë prove të paarsyeshme që i gjithë procesi ka ngarkuar mbi ta, pasi nuk ishte tipike që në procedura të tilla, barra e të provuarit të binte mbi subjektin e rivlerësimit apo siç është edhe pretendimi për një barrë prove e cila shtrihet shumë pas në kohë.⁴⁹ Megjithatë, pavarësisht këtyre pretendimeve GjEDNj, përfundimisht vlerësoi se "...nuk është në vetvete arbitrare, për qëllimet e degës/trungut "civil" të nenit 6 § 1 të Konventës, që barra e provës i kaloi kërkuesit në procedurat e verifikimit, pasi KPK kishte vënë në dispozicion gjetjet paraprake që rezultuan nga përfundimi i hetimeve dhe kishte dhënë akses në provat që gjendeshin në dosje."⁵⁰

Nga informacioni i siguruar prej vëzhguesve të KSHH-së, rezulton se subjektet e rivlerësimit konfirmojnë në krye të seancës se janë njohur me përbërjen e trupës gjykuese të KPK-së dhe nuk kanë konflikt interesi me trupën gjykuese. Subjekteve u janë garantuar të drejtat e parashikuara në

⁴⁸ Shih Xhoxhaj kundër Shqipërisë (aplikimi no. [15227/19](#), 9.2.2021), pg. 336.

⁴⁹ Shih Xhoxhaj kundër Shqipërisë (aplikimi no. [15227/19](#), 9.2.2021), pg. 345. Shih gjithashtu edhe çështjen Sevdari kundër Shqipërisë (aplikimi no. [40662/19](#), 13.3.2023), pg 130. Në të cilën GjEDNj riafrimon përfundimin në rastin Xhoxhaj si dhe thekson barra e provës dhe vlerësimi i provave është një çështje që mbeten në domainin e ligjit kombëtar, "...referohet gjetjeve të tij në këtë rast të Xhoxhajt se në përgjithësi rregullat e barrës së provës në procedurë sipas ligjit të Vettingut, duke përfshirë mungesën e kufizimeve të rrepta kohore për vlerësimin e pasurisë, nuk përbëjnë shkelje të nenit 6 në këndvështrimin e parimit të siguri së juridike, por që implikimi i këtyre dispozitave për sigurinë dhe të drejtat e kërkuesit sipas nenit 6 § 1 duhet të konsiderohen rast pas rasti."

⁵⁰ Xhoxhaj kundër Shqipërisë, aplikimi no. [15227/19](#), 9.2.2021, pg. 352.

nenin 47⁵¹ të ligjit 84/2016, si edhe nenet 35-40 dhe neneve 45-47 të Kodit të Procedurave Administrative⁵². Subjektet njoftohen lidhur me dosjen dhe u lihet 15 ditë kohë për t'u njohur me të dhe për të marrë një kopje të saj. Subjektet e rivlerësimit paraqesin dokumente plotësuese, depozitojnë prova gjatë kalimit të barrës së provës. Subjektet thirren në përputhje me nenin 55 të ligjit 84/2016 në seancë dëgjimore për të dhënë parashtrimet e tyre, si dhe u jepet e drejta të dëgjohen si edhe të mbrohen me anë të një përfaqësuesi. Si rrjedhojë, bazuar në këto gjetje, vërehet se procedura është kryer në mënyrë të rregullt dhe mund të thuhet se subjektit i janë respektuar standartet dhe garancitë e së drejtës për një proces të rregullt.

5.1. Pavarësia dhe paanshmëria

Sipas jurisprudencës së konsoliduar të GjEDNj, paanshmëria nënkupton mungesën e paragjykimit ose të anshmërisë ndaj palëve. Ekzistenca e anshmërisë mund të vlerësohet në disa mënyra: (i) *testit subjektiv, ku duhet kushtuar kujdes tek bindja dhe sjellja personale e një gjyqtari të caktuar, nëse reflekton paragjykim në një çështje konkrete; dhe (ii) testi objektiv, që kërkon vlerësimin nëse trupa në tërësi, në disa aspekte, si përbërja, ofrojnë garanci të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim të ligjshëm në lidhje me paanshmërinë e saj.*⁵³ Në këtë kontekst, edhe dukja (që reflekton sjelljen e anëtarëve të trupës gjyqësore) ka rëndësi, ose e thënë me fjalë të tjera “*drejtësia nuk duhet vetëm të bëhet, por ajo gjithashtu duhet të duket që po bëhet*”. Ajo që është me rëndësi është besimi të cilin gjykatat në një shoqëri demokratike duhet të frymëzojnë tek publiku.⁵⁴

Nisur nga standartet e jurisprudencës së GjEDNj është me rëndësi që në kushtet e analizimit të veprimtarisë së organeve të procesit të vetting-ut, të vlerësohet paanshmëria si një komponent themelor i procesit të rregullt ligjor në suastën e testeve të mësipërme. Kjo pjesë e raportit studimor është fokusuar në vlerësimin e testit subjektiv, duke nxjerrë në pah veprime apo sjellje nga anëtarët e trupës gjyqësore, të cilat krijojnë perceptim tek të tretët për respektimin ose jo të parimit në paanshmërisë.

Përgjithësisht, nga të dhënat e mbledhura nga seancat e vëzhguara, rezulton se seanca respekton elementët e nevojshëm proceduralë të cilët garantojnë paanshmërinë e trupës gjyqësore, ndonëse në raste të izoluara janë vënë re edhe shmangie nga zbatimi i këtyre rregullave procedurale që krijojnë përshtypje të qasjeve favorizuese ndaj subjekteve të caktuar të rivlerësimit.

Siç është vënë në dukje edhe nga monitorimi i seancave të zhvilluara pranë KPA-së mund të konkludojmë se ruhet i njëjti standard i respektimit të të drejtave procedurale dhe për rrjedhojë i garantimit të parimit të pavarësisë dhe paanshmërisë, pasi respektohen e drejta për mbrojtje (neni 22-23 i KPrC), e drejta për t'u dëgjuar (neni 24 i KPrC), e drejta për të paraqitur prova (neni 11-13 i KPrC), pranimi i kërkesave procedurale për administrim provash të reja duke riçelur hetimin gjyqësor.⁵⁵ Për këto arsye vlerësojmë se edhe në këtë fazë të procesit të vetting-ut respektohet

⁵¹ “Të drejtat e subjektit të rivlerësimit gjatë procesit të rivlerësimit rregullohen sipas përcaktimeve të neneve 35 - 40 dhe neneve 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative.”

⁵² Këto të drejta, sipas Kodit të Procedurave Administrative, përfshijë përgjithësisht, të drejtën e palës për përfaqësim, të drejtën për t'u njohur me dosjen, e drejta për të paraqitur mendime apo shpejgime etj.

⁵³ *Xhoxhaj kundër Shqipërisë*, pg 292. Shih gjithashtu edhe *Kyprianou v. Cyprus* [GC], no. 73797/01, § 118, ECHR 2005-XIII, and *Micallef v. Malta* [GC], no. 17056/06, § 93, ECHR 2009

⁵⁴ *Xhoxhaj kundër Shqipërisë*, pg. 293.

⁵⁵ Sipas nenit F, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe neneve 45 dhe 49 të ligjit nr. 84/2016,

parimi i kontradiktoritetit dhe nuk ka shfaqje të dukshme nga ana e trupës gjyqësore për cenim të parimit të paanshmërisë.

5.2 Kërkesa paraprake

Kërkesat paraprake janë kërkesa, për të cilat ligji kërkon paraqitjen para apo brenda një afati kohor të caktuar në fazën fillestare të procesit. Ato kanë të bëjnë me parakushtet procedurale për rregullshmërinë e gjykimit apo elementë të tjerë të parashikuar në ligj, si për shembull përjashtimi i gjyqtarit, kërkesë për marrjen e një prove të re përmes zgjerimit të hetimit gjyqësor etj.

Gjatë seancave dëgjimore pranë KPK-së rastet e kërkesave paraprake janë të pakta. Për shembull, ka patur kërkesë paraprake nga përfaqësuesi ligjor i një subjekti, i cili ka kërkuar ndërprerjen dhe shtyrjen e seancës dëgjimore me arsyetimin se subjekti i rivlerësimit ka depozituar pranë KLGj-së kërkesë për mbarim të statusit të magjistratit⁵⁶, me qëllim për t'i dhënë mundësi KLGj-së të shqyrtonte kërkesën e subjektit. Sipas relatores së çështjes, subjekti i rivlerësimit nuk kishte depozituar si provë kërkesën e bërë pranë KLGj-së edhe pse i ishte kërkuar, në momentin e njoftimi të zhvillimit të seancës dëgjimore. Nga trupa gjykuese u theksua se kërkesa e bërë nga subjekti i rivlerësimit ishte e paqartë pasi në disa kërkesa shprehej si “dalje në pension të parakohshëm” dhe në raste të tjera “ndërprerje për shkak të gjendjes shëndetësore”. Duke qenë se vetë subjekti i rivlerësimit nuk ishte prezent në sallë u vendos shtyrja e seancës dëgjimore.

Një tjetër kërkesë paraprake është paraqitur nga subjekti i rivlerësimit K.Sh, i cili në krye të seancës dëgjimore ka kërkuar që të çelet hetimi dhe për dy kriteret e tjera, duke marrë parasysh se seanca dëgjimore po zhvillohej vetëm mbi kriterin e pasurisë. Seanca dëgjimore u zhvillua vetëm për këtë kriter, ndërkohë që nga ana e trupës gjykuese u shpreh se do të merreshin në konsideratë dhe dy kriteret e tjera para dhënies së vendimit. Në datën e caktuar për dhënien e vendimit trupa gjykuese ka vendosur të riçelë hetimin gjyqësor dhe për dy kriteret e tjera. Pas kësaj vendimmarrjeje u zhvillua një seancë e dytë dëgjimore për këtë subjekt.

Para KPK-së ka patur edhe kërkesa paraprake për përjashtim anëtar i trupës gjykuese. Subjekti i rivlerësimit në mënyrë të vazhdueshme ka kërkuar zëvendësimin e të paktën një gjyqtari për trup gjykues. Ai ka kërkuar ndërrimin disa herë të trupit gjykues duke shprehur se ka konflikt interesi.⁵⁷ Kjo sjellje është raportuar nga vëzhguesi si përpjekje për të shtyrë në mënyrë të vazhdueshme seancën.

Në KPA në seancë gjyqësore nuk është paraqitur asnjë kërkesë për përjashtim gjyqtari, por në faqen zyrtare të KPA-së rezulton se është njoftuar zëvendësimi i një gjyqtareje, pas kërkesës për përjashtim të bërë nga subjekti i rivlerësimit E.T, ku kjo kërkesë u pranua unanimisht, por në seancë nuk është relatuar në lidhje me këtë ndryshim.


5.3 Përfaqësimi

⁵⁶ Me çeljen e seancës, përfaqësuesja ligjore e P.F kërkoj ndërprerjen dhe shtyrjen e seancës dëgjimore me arsyetimin se subjekti i rivlerësimit 3 ditë më parë kishte paraqitur pranë KLGJ kërkesën për mbarimin e statusit të magjistratit nëpërmjet paraqitjes së dorëheqjes, bazuar në pikën “a”, pika 1, të nenit 64, të ligjit nr. 96/2016

⁵⁷ Subjekti i rivlerësimit A.Y

Përfaqësimi në një seancë dëgjimore është një nga elementët më të rëndësishëm të procesit të rregullt ligjor, ku dhe subjekti i rivlerësimit në fillim të çdo seance dëgjimore pyetet nga kryesuesi i trupës nëse ka ushtruar të drejtën e caktimit të një përfaqësuesi ligjor.⁵⁸ Përgjithësisht, nga vëzhguesit është konstatuar prirja e subjekteve të rivlerësimit për t'u mbrojtur personalisht dhe vetëm në 7 seanca dëgjimore nga 26 subjekte të monitoruara, subjekti i rivlerësimit është paraqitur me një përfaqësues të zgjedhur prej tij.

Referuar seancave dëgjimore subjektet kanë qenë vetë të pranishëm (së bashku me përfaqësuesin, nëse ka zgjedhur në një tillë) gjatë gjithë zhvillimit të tyre. Vetëm në 2 raste, subjekti rivlerësimit nuk është paraqitur personalisht. Në një prej këtyre rasteve, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, me profesion avokat ka kryer përfaqësimin e subjektit.



Në KPA vërehet se dy nga subjektet e monitoruara kanë zgjedhur ta ushtrojnë personalisht mbrojtjen, ndërsa një subjekt ka vendosur ta ushtrojë mbrojtjen bashkërisht me një përfaqësues ligjor të zgjedhur prej tij.

5.4 Ndërhyrja e trupit gjykues

Në seancat e monitoruara, ndërhyrjet e trupit gjykues janë konsideruar minimale, duke i lënë subjektit kohën e nevojshme për të paraqitur mbrojtjen e tyre, por pa e lejuar të ripërsërisë materialet tashmë të sqaruara nëpërmjet parashtrimeve të depozituara prej tij.⁵⁹

Në një rast, në bazë të kërkesave të subjektit të rivlerësimit për mos ndërprerje të së drejtës së fjalës, subjekti i rivlerësimit ka relatuar shpjegimet e tij në 5 seanca dëgjimore.⁶⁰ Çdo ndërhyrje nga ana e trupit gjykues për të kufizuar fjalën e subjektit është konsideruar nga ana e subjektit të rivlerësimit në kundërshtim me nenin 6 të KEDNj. Siç referojnë vëzhguesit, gjatë seancës dëgjimore të këtij subjekti, në seancën e parë është dëgjuar relatori i çështjes, në dy seanca pasardhëse janë dëgjuar shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, në seancën e katërt subjekti i rivlerësimit ka kërkuar shtyrje të saj për të parashtruar qëndrimin e tij përfundimtar, ndërkohë që mund ta shprehte këtë qëndrim në përfundim të seancës së tretë.⁶¹

Në një çështje pranë KPA-së, kryesuesi i trupës gjyqësore ka kërkuar që subjekti i rivlerësimit në fjalën e tij të parashtronte vetëm fakte të reja, ndryshe nga ato të përcjella gjatë kalimit të barrës së provës (neni 52 ligji nr. 84/2016) në fazën e hetimeve, kjo në favor të administrimit të kohës gjatë seancës gjyqësore (neni 55 ligji nr. 84/2016). Por kjo kërkesë është vlerësuar nga ana e

⁵⁸Në përputhje me nenet 33-35 të ligjit gëzojnë të drejtën e një përfaqësuesi ligjor.

⁵⁹ Bazuar në nenin 55/4 të Ligjit Nr.84/2016

⁶⁰ Subjekti i rivlerësimit A.Y

⁶¹ Seancat dëgjimore për subjektin e rivlerësimit A.Y zhvilluar në datë 12.12.2022, 13.12.2022, 14.12.2022, 16.12.2022 dhe 19.12.2022

subjektit të rivlerësimit në kundërshtim me nenin 6 të KEDNJ.


5.5 Standartet e afatit të arsyeshëm (duke marrë si referencë shortimin e çështjeve)

Gjatë periudhës së monitorimit, subjektet që janë përballur me rivlerësimin e tyre në KPK kanë qenë pjesë e shortimeve të bëra në 16 dhjetor 2019⁶² dhe 15 qershor 2020⁶³. Rrjedhimisht, pas më shumë se 28 muajsh është zhvilluar seanca dëgjimore ndaj tyre. Në përputhje me standartet e parashikuara nga aneksi i Kushtetutës dhe ligji 84/2016 kohëzgjatja nga shortimi deri në gjykimin e çështjes, duke mos patur arsye ligjore për zgjatjen e saj, vlerësohet se ka tejkaluar afatin për një proces të rregullt ligjor (neni 3/1 ligji 49/2012). Theksojmë se arsyeja e tejzgjatjes së këtij afati hetimor përtej parashikimeve ligjore nuk është argumentuar në asnjë rast nga ana e trupës gjykuese. Kjo do t'i shërbente transparencës ndaj publikut si dhe konkludimit më të mirë nga vëzhguesit e KShH-së.

Situatë e ngjashme vërehet dhe në KPA, ku konstatohet se seancat e monitoruara kanë kaluar 25 muaj nga shortimi i çështjes. Në KPA, ka rëndësi veçanërisht shqyrtimi i atyre çështjeve në të cilat KPK ka vendosur për shkarkimin nga detyra. Në këto raste kohëzgjatja jo e arsyeshme e procesit sjell efekte të ndjeshme financiare. Sipas nenit 62 (1) të ligjit ligji 84/2016, “*Subjekti i rivlerësimit, i cili ka ushtruar të drejtën e ankimit ndaj vendimit të Komisionit për masën disiplinore për shkarkimin nga detyra, pezullohet ex lege nga detyra e tij në pritje të vendimit të Kolegjit të Apelineve. Gjatë periudhës së pezullimit atij i njihet e drejta e pagës në masën 75 për qind të saj, në përputhje me nenin F, pika 5, të Aneksit të Kushtetutës.*”. Për rrjedhojë, kërkohet një ritëm më i shpejtë i gjykimeve të çështjeve nga KPA, dhe veçanërisht të atyre që kanë të tilla efekte financiare. Sipas ligjit që rregullon veprimtarinë e KPA, përkatësisht ligjit nr. 84/2016, vlen të evidentohet se për organizimin dhe funksionimin e saj zbatohen normat e ligjit 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar. Sipas këtij ligji, gjykimi pranë KPA duhet të përfundojë brenda një marzhi 30-90 ditor nga data e paraqitjes së ankimit në KPA (referuar nenit 48(2) dhe 60(2), ligji nr. 49/2012), varësisht “barazimit” të pozitës së KPA me Gjykatën Administrative të Apelit apo Gjykatën e Lartë.

6. Kriteret e Vlerësimit

Sipas ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioni dhe Kolegji i Apelimit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit. Vendimi merret bazuar në një ose disa prej kriterëve, në vlerësimin e përgjithshëm të tre kriterëve, ose në vlerësimin tërësor të procedurave.⁶⁴ Pra, sipas ligjit, edhe vlerësimi për vetëm një kriter konsiderohet i mjaftueshëm për të



⁶² <https://kpk.al/njoftim-per-shortin-e-dates-16-dhjetor-2019/19/>

⁶³ <https://kpk.al/njoftim-per-shortin-e-dates-15-qershor-2020/28/>

⁶⁴ Neni 4(2), ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në republikën e Shqipërisë”

marrjen e vendimit. Në fakt, pavarësisht kritikave të mëhershme të KShH-së në raportet e tij monitoruese, vlen të theksohet se kjo qasje është gjetur e përshtatshme edhe nga jurisprudenca e GjEDNj, e cila ka konfirmuar se “...është në përputhje me frymën e procesit të vetting-ut për të patur një shkallë të limituar sanksionesh në rast se një subjekt dështon të përmbushë një ose disa nga kriteret e përcaktuara në ligjin e Vetting-ut”.⁶⁵

Në përgjithësi, seancat dëgjimore janë zhvilluar bazuar në të tre kriteret e rivlerësimit. Përjashtim këtu bëjnë seancat për dy subjekte rivlerësimi, të cilat fillimisht janë zhvilluar vetëm mbi kriterin e pasurisë për shkak të kompleksitetit të këtij komponenti dhe më pas ku është caktuar seanca për shpallje vendimi është vendosur të riçelet gjykimi dhe për dy kriteret e tjerë kriterin e kontrollit të figurës dhe kriterin e aftësive profesionale.⁶⁶

Duhet mbajtur në konsideratë që në total për të gjithë seancat e zhvilluara, kriteri i pasurisë ka prevaluar duke zënë pjesën më të madhe të kohës për shkak të kompleksitetit që paraqet. 13 nga seancat e realizuara në KPK kanë pasur fokusin kryesor në kriterin e pasurisë, ndërkohë që në seancat e tjera kanë dhënë shpjegime për kriterin e kontrollit të figurës dhe kriterin profesional. Vetëm për 4 subjekte seanca është zhvilluar në ndarje të barabartë midis kriterëve.

Sa i përket kriterit të profesionalizmit, gjatë seancave dëgjimore, është nxjerrë në pah rasti i një subjekti rivlerësimi të funksionit gjyqtar, që ka patur njohje me një avokat ku është pretenduar për marrëdhënie shoqërore disa vjeçare dhe ka gjykuar 122 vendime në të cilët avokati ka qenë përfaqësues i palëve në proces, dukshëm në kushtet e konfliktit të interesit.⁶⁷ Vetë subjekti i rivlerësimit ka mohuar kontakte përveç atyre profesionale.

Gjithashtu janë vërejtur raste kur subjekti i rivlerësimit disponon pasuri modeste, i kushtohet rëndësi të posaçme kriterit profesional. Ndërsa, kur subjekti ka asete të konsiderueshme, kriteri i profesionalizmit merr më pak peshë në procesin e vettingut.

6.1. Kriteri i pasurisë

Kriteri i pasurisë zë përgjithësisht pjesën kryesore të seancave dëgjimore, për shkak të pamundësisë së subjekteve të rivlerësimit për të justifikuar pasuri të caktuara apo për shkak të përfitimit të saj në konflikt interesi. Në disa raste është konstatuar që përlogaritja e analizës financiare nga ana e KPK nuk korrespondon me rezultatet e raporteve të përcjella nga institucionet ndihmëse (ILDKPKI), duke kërkuar që shpesh herë të përditësohen këto raporte.

Përgjithësisht, KPK ka konkluduar për shkeljet vijuese sa i përket kriterit të pasurisë: Deklarim i pasaktë në përputhje me ligji; Burime jo të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasurinë; Deklarim i rremë; Përfitimi i pasurisë në vlerë më të ulët se çmimi i tregut; Deklarim i pasaktë për “personin e lidhur”; Transaksione të cilat nuk reflektojnë vlerën reale të tregut (sikurse është shitja e një automjeti nga ana e subjektit 2 vjet më vonë nga dita e blerjes me një shumë gati 3-fish më të lartë se çmimi i blerës)⁶⁸. Gjetjet kryesore të KPK-së nga relatiimi në seancë lidhur me pasurinë

⁶⁵ Nikëhasani kundër Shipërisë, pg. 126.

⁶⁶ Seancat dëgjimore për subjektet e rivlerësimit K.Sh dhe T.H

⁶⁷ Subjekti i rivlerësimit A.Y

⁶⁸ Subjekti i rivlerësimit R.K

në zotërim të personit të lidhur përfshijnë: ⁶⁹ mos justifikimi i pasurisë së bashkëshortit; ⁷⁰ blerja e një automjeti nga vajza e subjektit nën vlerën e tregut; ⁷¹ shitësi ishte mik i bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit dhe palë në një proces të gjykuar nga subjekti i rivlerësimit.

Një nga pasaktësitë më të çuditshme të evidentuara mbi këtë kriter lidhet me plotësimin e Deklaratës Vetting nga babai i subjektit të rivlerësimit. ⁷²

Ndërsa në KPA, në një nga rastet e vëzhguara rezulton se është kërkuar kryerja e një analize të re financiare nga Komisioneri Publik, për shkak të krijimit të pasurive nga babai i subjektit të rivlerësimit.

6.2 Kontrolli i figurës

Kontrolli i figurës kryhet me qëllim identifikimin e subjekteve të nënshtuar rivlerësimit që mund të kenë kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar. ⁷³

Raporti i përcjellë nga institucioni ndihmës si DSIK, krahas hetimit kryesisht të kryer nga KPK ka qenë vendimtar për konkluzionet e arritura për këtë kriter.

Shkeljet tipike për kriterin e figurës rezultojnë si vijon:

- Konflikt interesit i subjektit me shtetas ndaj të cilëve janë ngritur akuza penale, si pastrim i produkteve të veprës penale (neni 287 i KP),
- Dyshime për përfshirjen e familjarëve në aktivitete të paligjshme,
- Përdorimi i automjeteve të të afërmeve të dyshuar për kryerjen e veprave penale të parashikuara në nenet 245 dhe 287 të K.P (në bashkëpunim),
- Përfshirja në hetimin e dy procedimeve ndaj një shoqërie aksionare ku bashkëshorti i subjektit rezultonte i punësuar.

6.3 Kriteri i Aftësive Profesionale

Subjektet e rivlerësimit i nënshtrohen vlerësimit të veprimtarisë etike dhe profesionale në përputhje me këtë ligj dhe me legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve ose prokurorëve. ⁷⁴ Vlen për t'u theksuar që për këtë kriter subjektet e rivlerësimit janë vlerësuar kryesisht pozitivisht. Ky vlerësimi i aftësive mbështetet kryesisht në raportin e përpiluar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë, si organe ndihmëse.

Shkeljet tipike të konstatuara për kriterit e aftësive profesionale:

⁶⁹ Personi i lidhur me subjektin e rivlerësimit, (bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja, fëmijët në moshë madhore dhe çdo person të përmendur në certifikatën familjare), i cili mbart detyrimin për deklarim të pasurisë në Inspektoratin e Lartë.

⁷⁰ Subjekti i rivlerësimit V.C.

⁷¹ M.D.

⁷² Subjekti i rivlerësimit A.Y është shprehur se Deklarata Vetting është plotësuar nga babai i tij për vite me radhë pasi vet ai ka kaligrafinë e keqe. ⁷²

⁷³ Neni Dh i Ankesit Kushtetues.

⁷⁴ Referuar nenit E të aneksit Kushtetues dhe nenit 40 të ligjit 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në republikën e Shqipërisë”

- Prishja e vendimit nga gjykata e apelit për mos njoftim të palëve;
- Kualifikim i gabuar i veprës penale;
- Gjykimi i çështjeve në kushtet e konfliktit të interesit (për shembull: me qiradhënësin e saj).

Në seancën dëgjimore të subjektit të rivlerësimit A.H është diskutuar mbi një vendim të dhënë nga gjyqtarja në mungesë të palës së paditur, vendim i cili është ankimuar në Gjykatën e Apelit. Gjykata e Apelit ka vendosur që vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë duhet të priset dhe të dërgohet për rigjykim me një tjetër trup gjykues. Subjekti shprehu se ka respektuar procedurën ligjore, por pala e paditur ka refuzuar marrjen dijeni, madje letërthirja është nënshkruar në prani të një dëshmitari. Kryetarja e trupës gjykuese të KPK, shprehu se Gjykata e Apelit ka dhënë një vendim të drejtë. Ky qëndrim mbart elementë të cënimit të parimit të paanshmërisë, duke paragjykuar çështjen përpara se të merret një vendim përfundimtar.

Përdorimi i frazës *”Subjekti ka dhënë shpjegime të cilat do të vlerësohen nga trupi gjykues para marrjes së vendimit përfundimtar”* është përmendur në pjesën më të madhe dhe të denoncimeve të publikut, duke mos referuar qoftë përmbledhtazi natyrën e denoncimeve, çka do të kontribuonte në mbështetje të parimit të publicitetit të seancës.

7. Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit

Vëzhguesi ndërkombëtar ka një rol kyç në gjithë procesin e vetting-ut. Kushtetuta dhe veçanërisht ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ka njohur Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit si dhe vëzhguesve ndërkombëtarë një pozitë të veçantë në mënyrë që të bëjnë edhe ata një vlerësim të drejtë të rastit të shortuar, duke vlerësuar dhe hetuar individualisht të gjitha faktet. Sipas ligjit të sipërpërmendur, vëzhguesi ndërkombëtar ka të drejtë të hetojë plotësisht të gjitha kriteret e vlerësimit për subjektet e rivlerësimit, të bëjë pyetje ndaj subjektit të rivlerësimit gjatë seancës dëgjimore, etj.⁷⁵

Gjatë seancave të monitoruara nga vëzhguesit e KShH-së, janë evidentuar raste kur vëzhguesi ndërkombëtar ka drejtuar pyetje ndaj subjektit të rivlerësimit⁷⁶ ashtu siç janë evidentuar raste kur vëzhguesi ndërkombëtar nuk ka marrë pjesë aktivisht gjatë seancës dëgjimore. Për 15 seanca të subjekteve të rivlerësimit vëzhguesi ndërkombëtar ka qenë i pranishëm në seancë, duke respektuar qëndrimin etik. Në tre seanca është konstatuar që vëzhguesi ndërkombëtar ka qenë aktiv gjatë seancës dëgjimore, duke paraqitur dhe mbledhur denoncime mbi subjektin e rivlerësimit për sa i përket aspektit të kontrollit profesional apo në drejtim të pyetjeve që i ka bërë subjektit.⁷⁷

8. Përfshirja e publikut - Denoncimet e Publikut

Përgjatë monitorimit të seancave dëgjimore, rezulton se publiku në mënyrë proaktive ka depozituar ankesa dhe denoncime pranë KPK të cilat janë vlerësuar para marrjes së vendimit, ku subjekti i vlerësimit mund të japë shpjegime shtesë dhe në seancë. Mgjith, vëzhguesit raportojnë se relatimi

⁷⁵ Shih nenet 33 (3), 45(1), 49(10), 55(3) të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”

⁷⁶ Në seancën e A.Y

⁷⁷ Seanca dëgjimore për subjektin e rivlerësimit E.Sh

përceptazi e në shumë raste mungesa e relatimit të tyre kanë kaluar me shprehjen “subjektit të rivlerësimit i ka kaluar barra e provës dhe shpjegimet e tij do merren parasysh nga ana e trupës gjyquese para marrjes së vendimit”.

Ndër rastet e pakta kur janë relatuar shkurtimisht denoncimet vërehet se ato kanë të bëjnë kryesisht me:

- Zvarritje të çështjes.
- Mungesë e arsytimit⁷⁸;
- Arsyetim i vendimeve në kundërshtim me ligjin.
- Gjykim pa njoftuar palët në proces.

KShH, në respekt të parimit të transparencës, publicitetit të seancës dëgjimore dhe frymës e objektit të ligjit nr. 84/2016 me qëllim rikthimin e besimit të publikut tek drejtësia, vlerëson se duhet të relatohen në seancë dëgjimore edhe denoncimet e mbërritura, natyra dhe përmbajtja e tyre në mënyrë koncize dhe të kuptueshme për pjesëmarrësit në sallë.

⁷⁸ Shtetasi B.K për subjektin e rivlerësimit A.J

PJESA II

STUDIMI I VENDIMMARRJES SË ORGANEVE TË VETTINGUT⁷⁹

⁷⁹ Të dhëna nga KPK dhe KPA përgjatë periudhës Janar – Nëntor 2022

1. Vendimet e KPK-së dhe KPA-së për ndërprerjen/pushimin e vetting-ut

1.1 Subjektet e dorëhequra/dala në pension të parakohshëm

Në analizë të vendimmarrjeve të shqyrtuara, konstatohet se KPK ka vendosur ndërprerjen/pushimin e rivlerësimit kalimtar të 2 subjekteve, bazuar në vullnetin e tyre për dorëheqje, në përputhje me nenin G të Aneksit Kushtetues dhe nenit 64 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.⁸⁰ Të dy këto subjekte kanë ushtruar funksionin e gjyqtarit pranë Gjykatave të Rretheve Gjyqësore Tiranë dhe Durrës. Në të dyja këto raste rezulton se subjektet e rivlerësuara kanë ushtruar të drejtën e përfaqësimit të interesave të tyre ligjore personalisht KPK-së.

Për shkak të natyrës së kërkesave të depozituara nga ana e subjekteve të rivlerësuara, vihen re një sërë elementësh përcaktues, që dallojnë rrethanat faktike nga njëra tjetra. Në njërin prej rasteve, trupa shqyrtuese pranë KPK pas realizimit të procedurës së hetimit vendosi mbylljen e saj kryesisht vetëm për kriterin e pasurisë, ndërkohë që subjekti u njoftua në rrugë elektronike për rezultatet e hetimit dhe të drejtat e tij. Pas njohjes me rezultatet e hetimit administrativ, rezulton se subjekti depozitoi pranë KPK-së kërkesën për pushimin e procedurës së vlerësimit të saj, për shkak se kishte depozituar pranë KLGJ-së kërkesën për dorëheqje, bazuar në nenet 64 dhe 65 të ligjit nr. 96/2016.⁸¹ Sa i përket kohëzgjatjes së procesit të rivlerësimit, vëzhguesi i KShH-së ka vlerësuar se vendimmarrja e KLGJ-së për deklarimin e përfundimit të statusit është marrë 9 ditë para afatit maksimal të parashikuar në ligj. Në referim të nenit 65, paragrafi 2 të ligjit nr. 96/2016 është parashikuar se statusi i magjistratit përfundon *ipso jure*, automatikisht në fund të muajit pasardhës nga paraqitja e dorëheqjes, dhe KLGJ e deklaroi me vendim. Referuar kësaj norme ligjore evidentohet se statusi i magjistratit ka përfunduar më datë 31.08.2022, ndërkohë që KLGJ e ka deklaruar atë më herët, nëpërmjet një klauzole tjetër të pa shpjeguar qartësisht. Në zbatim të normës ligjore të sipërcituar, KLGJ ka si kompetencë deklarimin dhe jo përcaktimin kur merr efekt mbarimi i statusit të magjistratit, pasi ky element përcaktohet nga ligji dhe është një pasojë juridike e pashmangshme dhe e përcaktuar në kohë. Zbatimi i paragrafit të tretë të dispozitës së mësipërme duket se nuk është shpjeguar sa duhet nga KLGJ. Nga ana tjetër vendimmarrja e KPK-së për ndërprerjen e procesit të rivlerësimit që mban datën 16.09.2022, është vlerësuar në përputhje me Kushtetutën dhe ligjin.

Ndërkohë në rastin tjetër objekt shqyrtimi rezulton se KPK njoftoi subjektin e rivlerësimit mbi fillimin e procesit të rivlerësimit të thelluar dhe të gjithanshëm sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, por ky proces nuk u përfundua me një rezultat konkret, pasi që subjekti i rivlerësimit njoftoi KPK se do të paraqesë kërkesë për miratimin e pensionit të parakohshëm dhe ndërprerjen e statusit të gjyqtarit pranë KLGJ-së. Vëzhguesi përgjegjës i KShH-së ka analizuar se short-listimi i çështjes mban datën 16.12.2019, ndërkohë që komunikimi për të drejtën e zhvillimit të një seance dëgjimore për shpalljen e vendimit për subjektin në mbështetje të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016,

⁸⁰ Vendim nr. 515, dt. 03.03.2022: <https://kpk.al/z-sokol-tona-gjyqtar-prane-gjykates-se-rrethit-gjyqesor-tirane/50/>
Vendim nr. 561, dt. 16.09.2022: <chrome-extension://efaidnbmninnibpcapcglclefindmkaj/https://kpk.al/wp-content/uploads/2022/09/Vendim-Flora-Hasimi.pdf>

⁸¹<chrome-extension://efaidnbmninnibpcapcglclefindmkaj/https://kpk.al/wp-content/uploads/2022/09/Vendim-Flora-Hasimi.pdf>, fq.2

mban datën 15.02.2022. Rrjedhimisht, konstatohet se KPK-së i janë dashur pothuajse 2 vjet, një kohë relativisht e gjatë, pavarësisht kompleksitetit të provave dhe informacioneve të administruara. Kohëzgjatja e hetimit tej afateve të arsyeshme çënon në tërësi procesin e rregullt ligjor, pasi subjektet e rivlerësimit kanë të drejtë për t'u hetuar brenda një afati të arsyeshëm, si pjesë e procesit të rregullt ligjor, pasi vonesat në dhënien e drejtësisë janë gjetur nga GjEDNJj në shkelje të nenit 6 të KEDNJ.⁸² Në rastin në fjalë, kjo kohëzgjatje çënon edhe interesin e publikut dhe të qytetarëve për drejtësi, pasi nëse arsyeja subjektive e këtij gjyqtari është dorëheqja si rrjedhojë e problematikave që kanë rezultuar nga procesi i vettingut, kjo situatë mbart rrezikun që shkeljet e kryera më herët të kenë vijuar nga subjekti edhe gjatë procesit të gjatë të vettingut.

Nga analiza e vendimmarrjeve të KPA-së, konstatohet se në 2 raste janë lënë në fuqi vendimet e KPK-së me anë të të cilave është vendosur ndërprerja e procesit të rivlerësimit për subjektet e rivlerësimit dhe zbatimin e pasojës juridike të parashikuar nga pika 2 e nenit G të Aneksit të Kushtetutës. Në njërin prej rasteve subjekti kishte ushtruar detyrën e Prokurorit pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ndërkohë rasti tjetër i përkiste një ndihmësi ligjor pranë Gjykatës së Lartë.⁸³ Sa i përket analizës mbi nivelin e garantimit të parimit të publicitetit të seancës dëgjimore, konstatohet se në rastin e parë të shqyrtuar, trupi gjykues, me vendim të ndërmjetëm, bazuar në nenin F, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, nenin 4, pika 5 e ligjit nr. 84/2016 si dhe nenin 51, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 49/2012 ka vendosur shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore publike, pasi çmoi se vendimi i dhënë nga Komisioni për subjektin në fjalë është bazuar në shkelje të rënda procedurale dhe në gjendjen faktike të konstatuar gabimisht e në mënyrë jo të plotë. Ndërkohë në rastin tjetër të analizuar ndaj subjektit S. Z., konstatohet se seanca gjyqësore është zhvilluar në dhomë këshillimi, pa prezencën e palëve dhe jo në seancë gjyqësore publike, në përputhje me nenin 65 të ligjit 84/2016.

Trupa gjykuese e KPA-së në rastin e konstatimit të shkeljeve të rënda procedurale gjatë shqyrtimit të KPK-së ka vlerësuar pretendimet e subjektit të rivlerësimit duke mbajtur të njëjtin qëndrim me të. Përkatesisht është konstatuar se qëndron pretendimi i subjektit se në kërkesën e tij drejtuar KLP-së, nuk kërkohet dorëheqja sipas nenit 65 të ligjit nr. 96/2016, i ndryshuar dhe se referimi i KPK-së në pikën 7, në faqen 2 të vendimit nr. 506, datë 31.01.2022, nuk përputhet me përmbajtjen e vendimit nr. {***}, datë 14.01.2022, të KLP-së “Për miratimin e pensionit të parakohshëm dhe deklarin e mbarimit të statusit të magjistratit prokuror”. Në në preambulën e këtij të fundit nuk rezulton të jetë referuar neni 65 i ligjit nr. 96/2016. Gjithashtu, është konstatuar se situata e “daljes në pension të parakohshëm pleqërie” nuk është e njëjtë me atë të “dorëheqjes nga detyra”, por vlerësohet se mbarimi i statusit të magjistratit për shkak të daljes në pension pleqërie, parashikuar nga neni 64, pika 1, shkronja “c” e ligjit nr. 96/2016, nuk lidhet vetëm me ndalimin e ushtrimit efektivisht të detyrës në kuptim të ligjit nr. 96/2016, por në të njëjtën kohë e në mënyrë të pashmangshme ndikon dhe procesin e rivlerësimit në zbatim të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, duke sjellë për pasojë humbjen e statusit si subjekt rivlerësi *ex officio* dhe ndërprerjen e procesit të rivlerësimit.

⁸² Shih Botazzi v Italy [GC], 1999, pg. 22.

⁸³ [Vendim Nr. 13/2022 \(JR\) datë 16.05.2022; përfshirë mendimin e pakicës:](https://kpa.al/ep-content/uploads/2022/08/VENDIMI_PETRIT-BICA-_perfshire_pakicen_anonimizuar.pdf) chrome-extension://efaidnbmnnnibpcajpcgglefindmkaj/https://kpa.al/ep-content/uploads/2022/08/VENDIMI_PETRIT-BICA-_perfshire_pakicen_anonimizuar.pdf
[Vendim Nr. 21/2022 \(JR\) datë 17.06.2022; përfshirë mendimin e pakicës](https://kpa.al/ep-content/uploads/2022/09/Vendim_Selami_Zalli_perfshire_pakicen_anonimizuar.pdf) : chrome-extension://efaidnbmnnnibpcajpcgglefindmkaj/https://kpa.al/ep-content/uploads/2022/09/Vendim_Selami_Zalli_perfshire_pakicen_anonimizuar.pdf

Sa i përket administrimit të provave të reja, në rastin e subjektit të parë të analizuar konstatohet se në kuptim të nenit 47 të ligjit nr. 49/2012, si edhe nenit 49, pika 6 të ligjit nr. 84/2016, mbi bazën e të cilave Kolegji ka konstatuar se provat e paraqitura plotësonin kriteret e parashikuara për të gëzuar statusin e provës që mund të merret në gjykimin në apel të çështjes, ka vendosur të marrë në administrim në cilësinë e provës edhe aktet e përcjella bashkëlidhur ankimit nga subjekti i rivlerësimit. Ndërkohë në rastin e dytë, Kolegji ka vlerësuar se duke iu referuar ankimit të subjektit nuk plotësohen kriteret për gjykimin e çështjes në seancë gjyqësore publike në kuptim të nenit 51 të ligjit 49/2012, si rrjedhojë nuk është kërkuar administrimi i provave të reja, si dhe nuk janë konstatuar pretendime procedurale mbi zhvillimin e seancës dëgjimore në KPK.

Referuar analizës së kohëzgjatjes së shqyrtimit nga momenti i shortimit të çështjes deri në realizimin e seancës së parë publike, rezulton se KPA-së i është dashur 3-4 muaj për të përmbyllur shqyrtimit përkatës, një afat ky i vlerësuar i përshtatshëm, duke e krahasuar edhe me raste të tjera e në përputhje me nenin 3 të ligjit nr. 49/2012.

Vëzhguesit e KShH-së vlerësojnë analizën gjithëpërfshirëse dhe të detajuar të ndjekur nga ana e Kolegjit, por në kontekstin e transparencës vëmë në dukje mungesën e pasqyrit në faqen zyrtare të institucionit (*website*) të datës së publikimit të vendimmarrjes së arsyetuar.

Në vendimmarrjet e analizuara, nuk konstatohet publikim i mendimeve ndryshe/paralele të vëzhguesve ndërkombëtar të ONM-së, një e drejtë ligjore që i është njohur atyre nga ana e ligjvënësit në zbatim të nenit 55 pika 5 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Pasqyrimi i argumentuar i vendimmarrjes së ndërmjetme në rastin e shqyrtimit të çështjes ndaj subjektit P.B., i cili përkon në metodologjinë e ndjekur nga ana e Kolegjit për verifikimin e akteve të administruara nga Komisioni, përpos garantimit të së drejtës procedurale të transparencës kundrejt subjektit të rivlerësimit, konsiderohet pozitiv edhe në raport me njësimin e praktikës mbi mbarimin e statusit të magjistratit për shkak të daljes në pension të parakohshëm pleqërie.

Të dyja vendimmarrjet objekt analize janë shoqëruar me mendim pakice, në respektim të nenit 55 pika 5 të ligjit 84/2016, të cilat trajtojnë çështje të rëndësishme që duhen konsideruar. Përkatësisht, në rastin e subjektit P.B. në ndryshim nga shumica e trupit gjykues, anëtarja në pakicë argumentoi ndër të tjera se: *“Instituti i “dorëheqjes” dhe instituti i “daljes në pension”, si të drejta të magjistratit që rregullohen me baza ligjore të ndryshme dhe passjellin pasoja personale e financiare të ndryshme, nuk mund të aplikohen për analogji të njëri-tjetrit, në funksion të vijimit apo ndërprerjes së procesit të rivlerësimit kalimtar. Të dyja këto institute sjellin ndërprerjen e marrëdhënieve të punës, por dallojnë qartësisht njëri nga tjetri sepse “dalja në pension të parakohshëm” është e lidhur domosdoshmërisht me dy kushte ligjore: me moshën, ku magjistrati duhet të ketë mbushur moshën 60 vjeç, dhe me ushtrimin e funksionit të magjistratit për të paktën 30 vjet, kushte të cilat, nga shqyrtimi i akteve në fashikull, rezulton se subjekti i rivlerësimit i plotëson. Ndërsa “dorëheqja”, si shprehje vetëm e vullnetit subjektiv të magjistratit, kur ende ekzistojnë marrëdhëniet e punës, rezulton të mos jetë e kushtëzuar me kërkesa të posaçme ligjore. Këto dy institute, në rastin kur nuk janë të parashikuara shprehimisht në Kushtetutë apo në ligj, nuk mund ta zëvendësojnë njëri-tjetrin. Leximi i nenit G të Aneksit të Kushtetutës dhe aplikimi si bazë ligjore e “dorëheqjes” në rastet e “daljes në pension”, kur kjo nuk është e përcaktuar*

*qartësisht nga ligjvënësi, përveç cenimit të parimit të ligjshmërisë të parashikuar nga neni 4 i Kodit të Procedurave Administrative, duke bërë që subjekti i rivlerësimit të penalizohet pa ligj, vjen ndesh me Kushtetutën, me ligjet në fuqi, si dhe me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut”.*⁸⁴

Ndërkohë një tjetër qëndrim nga shumica e trupës gjykuese ka mbajtur edhe anëtarja në pakicë, në rastin e subjektit S.Z. Për shkak të ndërprerjes së detyrës funksionale të subjektit të rivlerësimit, pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, vlerësohet nga ana e anëtares në pakicë se subjekti nuk duhet të ishte sanksionuar sipas nenit G të Aneksit Kushtetues, për shkak se pranë organeve përgjegjëse të vetting-ut ai ka kërkuar t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit për të tre kriteret. Me qëllim hapjen rrugë të procesit të rivlerësimit, anëtarja në pakicë shprehet se duhet të ishte prishur vendimi i KPK-së, sipas nenit 66/1/c të ligjit 84/2016, për shkak se Kushtetuta në nenin 179/b pika 4 i jep të drejtën e rivlerësimit me kërkesë, ndër të tjerë edhe ish këshilltarëve të Gjykatës së Lartë.

1.2 Afati i dorëheqjes dhe depozitimi i dorëheqjes pranë organit përgjegjës

Një nga problematikat e hershme të procesit të vetting-ut, lidhej me dorëheqjen dhe pasojat që do të sillte ky proces në raport me rivlerësimin kalimtar dhe nëse paraqitej tej afatit tre mujor të përcaktuar nga ligjit 84/2016. Sipas kuptimit të ligjit, dorëheqjet e paraqitura brenda afatit të sipërpërmendur, e përjashtojnë subjektin e rivlerësimit nga detyrimi për t’iu nënshtrohet procesit të rivlerësimit kalimtar. Kufizimi i dorëheqjes brenda afatit 3 mujor të sipërcituar, është gjetur nga Gjykata Kushtetuese në vendimin e saj 2/2017 në përputhje me Kushtetutën dhe i ka rrëzuar pretendimet e kërkuësit si të pabazuara.⁸⁵ Kjo do të thotë, që këta subjekte nuk plotësojnë dhe depozitojnë dokumentacionin e nevojshëm për nisjen e procesit të rivlerësimit për ta. Ndërsa, dorëheqjet tej këtij afati, do të trajtohen nga organet kompetente sipas ligjeve përkatëse rregulluese, por KPK do të vijojë me procedurën e hetimit të kriterëve për të cilat subjekti në fjalë ka depozituar dokumentacionin sipas kërkesave të ligjit. KPK, në rastet e dorëheqjeve jashtë afatit të sipërcituar, ka marrë vendim për ndërprerjen e procesit të rivlerësimit. Ndërkohë, duket se krijohet një situatë ligjore paksa kontradiktore, pasi fryma e dispozitës së mësipërme është e tillë që synon t’ia nënshtrojë procesit të rivlerësimit të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët të cilët nuk kanë dhënë dorëheqjen brenda afatit 31.3.2017. Nga ana tjetër, edhe argumenti se procesi ka kuptim ndaj personave që e kanë statusin e gjyqtarit apo prokurorit nuk është i pabazuar dhe dorëheqja gjatë realizimit të këtij procesi e lë pa objekt veprimtarinë e Komisionit për rastin konkret. Megjithatë, qëllimi për të cilin u ndërmor e gjithë kjo reformë, ishte të verifikoheshin të gjithë funksionarët e drejtësisë, për sa i përket të tri kriterëve dhe dorëheqja pas hyrjes në fuqi të ligjit, dhe mbarimit të afatit që neni 56 i ligjit nr. 84/2016 nuk do të duhej të ndikonte në procesin e verifikimit të subjekteve që e kishin statusin e gjyqtarit/prokurorit.

Në çdo rast, diskutimi i mësipërm ka vetëm natyrë teorike, pasi jurisprudenca e KPA-së e ka konfirmuar qëndrimin e mbajtur nga KPK.

Shtatë (7) subjektet e rivlerësimit, që kanë qenë pjesë e vendimeve të studiuara gjatë periudhës objekt i raportit studimor, e kanë depozituar kërkesën për heqjen dorë nga statusi i magjistratit jashtë afatit të sipërcituar. Në përputhje me metodologjinë e ndjekur për studimin e këtyre

⁸⁴https://kpa.al/ep-content/uploads/2022/08/VENDIMI_PETRIT-BICA-_perfshire_pakicen_anonimizuar.pdf

⁸⁵ Vendimi i Gjykatës Kushtetuese 2/2017, pg. 69-70.

vendimeve konstatohet se subjektet e rivlerësimit i kanë depozituar kërkesat respektive për dorëheqje pranë Këshillave përkatës (qoftë KLGj apo KLP). Në analizën e këtyre vendimmarrjeve në shumicë nuk janë përshkruar shkaqet mbi të cilat ngrihen kërkesat për dorëheqje, por vetëm në rastin e subjektit të rivlerësimit B.Q. evidentohet se arsyet e heqjes dorë nga statusi i magjistratit rezultojnë të jenë ngarkesa në rritje e punës; plotësimi i vjetërsisë në punë prej më tepër se 35 vjet; si dhe gjendja jo e mirë shëndetësore.⁸⁶

Nga analiza e nenit 65 të ligjit nr. 96/2016 rezulton se ligjvënësi ka parashikuar dy situata të paraqitjes së dorëheqjes prej magjistratëve: (i) dorëheqje e pamotivuar dhe (ii) dorëheqje e motivuar. Në rastin e parë, magjistrati paraqet dorëheqjen nuk njofton apo justifikon dorëheqjen e paraqitur. Në këtë rast, dorëheqja i jep efektet në fund të muajit pasardhës, nga dita kur Këshilli merr deklarinimin me shkrim të dorëheqjes. Mbarimi i statusit të magjistratit deklarohet me vendim të Këshillit jo më vonë se dy javë nga mbarimi i statusit. Pra, në këtë situatë, Këshilli përkatës bën thjesht konstatim të mbarimit të statusin, sipas afatit që përcakton vet ligji. Ndërsa në rastin e dytë, të dorëheqjes së motivuar, magjistrati duhet të sjellë përpara Këshillin përkatës, arsyet e dorëheqjes dhe nëse kjo miratohet nga Këshilli, atëherë afati i përfundimit të statusit nuk është ai i sipërpërmendur, por sipas kërkesës së magjistratit (nëse miratohet nga KLGj) mund të jetë përpara këtij momenti.

Gjithashtu, në tejkallim të afatit ligjor të sipërpërmendur (31.3.2017) konstatohet të jetë depozituar edhe kërkesa për dorëheqje nga ana e njërit prej subjekteve, procesi i rivlerësimit të të cilit për shkak të ankimit është shqyrtuar pranë KPA-së. Në këtë rast konstatohet se subjekti i rivlerësimit me vullnetin e tij, e ka humbur statusin për shkak të dorëheqjes nga detyra që mbante dhe, për pasojë, procedura që do të zhvillohej ndaj tij *ex officio*, duhej të ndërpritej duke u shoqëruar me aplikimin e pasojave (ndalimeve) të nenit G të Aneksit të Kushtetutës.

Në të gjitha vendimmarrjet e analizuara, organet përgjegjëse të vetting-ut janë treguar të kujdesshme në përcaktimin në dispozitivin e vendimmarrjes sanksionin e parashikuar në pikën 2 të nenit G të Aneksit Kushtetues, që parashikon ndalimin e emërimit të subjektit të dorëhequr për një periudhë 15 vjeçare si gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm.

1.3 Analiza e përmbajtjes së vendimeve të ndërprerjes së procesit të vetting-ut dhe atij të pezullimit nga detyra

Vendimet e KPK-së dhe KPA-së që kanë qenë objekt studimi dhe janë analizuar nga ekspertët e KShH-së, përmbajnë elementët formalë të kërkuara nga neni 57 i ligjit nr. 84/2016. Gjithashtu, organet përgjegjëse të vetting-ut vlerësohet se kanë pasqyruar në vendim argumentimin e detajuar të procedurës së ndjekur nga ana e KLGj-së ose KLP-së për shqyrtimin e kërkesës për heqjen dorë nga statusi i magjistratit. Ndërkohë konstatohet se në mbështetje të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, subjektet e rivlerësimit që kanë ushtruar këtë të drejtë iu është garantuar mundësia të dëgjohen në seancë dëgjimore nëse do të ushtrojnë të drejtën e ankimit ndaj vendimeve të dhëna nga KLGj ose KLP. Paralelisht nga ana e organeve përgjegjëse të vetting-ut është kërkuar informacion nga ana e Gjykatës Administrative të Apelit mbi mundësinë e depozitimit të ankimit ndaj vendimmarrjeve

⁸⁶ Paragrafi 6, Vendim nr. 562, dt. 16.09.2022, link: <https://kpk.al/ep-content/uploads/2022/09/Vendim-Bedri-Qori.pdf>

konfirmuese të organeve të reja të qeverisjes së sistemit të drejtësisë.

Sa i përket vendimmarrjes së vetme të ndërmjetme, nëpërmjet të cilës KPK ka vendosur në përputhje me nenin 58 pika 1, gërma b) të ligjit nr. 84/2016, për prokuroren pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër M.F., vëzhguesit e KShH-së kanë hasur me vështirësi për të konkluduar me vlerësime lidhur me sjelljen e trupës shqyrtuese, për shkak të mungesës së aksesit në dosjen përkatëse. Në rastin konkret evidentohet se argumentimi i vendimmarrjes së trupës gjyqësore është bazuar në masë të përgjithshme në vlerësimin vetëm të kriterit profesional, duke mos arsyetuar në asnjë rast nëse shtrirja e hetimit administrativ është realizuar edhe mbi dy kriteret e tjera të parashikuara në nenet 4 pika 1, 30 e vijues dhe 34 e vijues të ligjit nr. 84/2016. Përpos kësaj, në vendimmarrjen e argumentuar, Komisioni në mënyrë përgjithësuese referon se rivlerësimi ka përfunduar për të tre kriteret,⁸⁷ por në fakt asnjë e dhënë nuk pasqyrohet mbi analizën e kriterëve të sipërcituara, si të munguara. Në këtë përfundim, ekspertët mbajnë në konsideratë rastin analog të subjektit të rivlerësimit E.G., ku pavarësisht vendimit të KPK-së bazuar në nenin 60 të ligjit nr. 84/2016 për shkak të gjetjeve të konstatuara në rivlerësimin e kriterit të aftësive profesionale, trupa gjyqësore ka arsyetuar edhe dy kriteret e tjera të rivlerësimit.⁸⁸ Gjithashtu, KPA nëpërmjet vendimmarrjes së saj për këtë të fundit, nuk e ka gjetur praktikën e KPK-së si të gabuar apo të pabazuar në ligj, sa i përket shtrirjes së hetimit dhe reflektimit në vendimmarrje edhe gjetjet për dy kriteret e tjera të rivlerësimit.⁸⁹

Vlerësojmë se mungesa e njësimit të praktikës e cila vijon të jetë ekzistente, në raste sporadike, nga ana e organeve përgjegjëse të vetting-ut, krijon premisa për cënim të parimeve të barazisë para ligjit të subjekteve të rivlerësimit, si dhe garantimit të procesit të rregullt ligjor.

2. Analiza e detajuar e Vendimmarrjeve të KPK dhe KPA

2.1 Garantimi i parimit të transparencës nëpërmjet publikimit të vendimeve në faqet zyrtare të internetit të Institucioneve të Vetting-ut

Në nenin 55 të ligjit nr. 84/2016, ligjvënësi ka parashikuar detyrimin e organeve përgjegjëse të vetting-ut për të publikuar vendimet në faqet zyrtare të internetit. Në analizë të vendimmarrjeve të përzgjedhura si kampion rezulton se organet përgjegjëse e kanë respektuar në çdo rast procesin e publikimit të këtyre vendimmarrjeve, e në rastet e KPA-së shoqëruar edhe me mendimin e pakicës së anëtarëve përkatës.

Megjithatë përkundrejt transparencës vlen të evidentohet se faqja zyrtare e KPK-së është më e mirë-strukturuar sa i përket mënyrës së publikimit të vendimmarrjeve duke pasqyruar numrin, datën, emrin e subjektit dhe pozicionin e tij. Ndërkohë në faqen zyrtare të Kolegjit vendimmarrjet klasifikohen nën kategorinë e përgjithshme ‘juridiksion rivlerësimi’ apo ‘juridiksion disiplinor’, të grupuara më pas sipas viteve të shpalljes së vendimit e duke identifikuar subjektin përkatës të rivlerësimit.

⁸⁷ Pika 15, Vendim nr. 6, dt. 13.05.2022, link: <chrome-extension://efaidnbmnnnibpajpcglclefindmkaj/https://kpk.al/ep-content/uploads/2022/05/Vendim-M.Fraseri.pdf>

⁸⁸ Vendim nr. 187, dt. 24.07.2019, link: <chrome-extension://efaidnbmnnnibpajpcglclefindmkaj/https://kpk.al/ep-content/uploads/2019/10/Vendim-Elvin-Gokaj.pdf>

⁸⁹ Vendim nr. 31, dt. 18.11.2020, link: chrome-extension://efaidnbmnnnibpajpcglclefindmkaj/https://kpa.al/ep-content/uploads/2021/02/Vendimi_Elvin_Gokaj.pdf

Gjithashtu, nga monitorimi i vendimmarrjeve në faqen zyrtare të KPA-së, vëzhguesit evidentojnë pamundësinë për të konstatuar datën e saktë të shpalljes së vendimit të arsyetuar në mënyrë publike.

Në përgjithësi, vendimmarrjet e publikuara nuk reflektojnë vendime të ndërmjetme të marra nga ana e trupës shqyrtuese gjatë procesit administrativ. Por edhe në ato raste kur vendime të ndërmjetme janë cituar, në vendimet përfundimtare, të dhënat lidhur me to janë të pakta.⁹⁰ Ndërkohë nuk kanë munguar rastet sporadike, kur organet përgjegjëse të vetting-ut kanë cituar në vendimmarrje në mënyrë të përgjithshme vendimet e ndërmjetme të marra në lidhje me konfliktin e interesit ose jo të anëtarëve të trupës gjyquese; të administrimit të provave, etj.⁹¹

2.2 Respektimi i parimeve të barazisë së armëve juridike dhe atij të kontradiktoritetit

Në jurisprudencën kushtetuese për parimin e barazisë së armëve është theksuar se çdo palë në proces duhet të ketë mundësi të barabarta që të paraqesë çështjen e saj, me anë të argumentave dhe provave në mbrojtje të interesave të saj. Nëse nuk do të ekzistonte barazia e armëve në gjykim, atëherë argumentet e njëres palë do të prevalonin mbi argumentet e palës tjetër, për rrjedhojë e drejta për të marrë pjesë në gjykim do të zhvishej nga funksioni i saj kushtetues për të garantuar procesin e rregullt ligjor⁹².

Në analizë të nivelit të garantimit të këtij parimi, vëzhguesit e KShH-së kanë konstatuar se në shumicën e vendimmarrjeve të publikuara të arsyetuara, është elaboruar nëse subjekteve të rivlerësimit i është garantuar akses në dokumentacion nga ana e organeve përgjegjëse të vetting-ut, por ka pasur disa raste sporadike kur ka qenë e pamundur konstatimi nga ana e vëzhguesve mbi mbarëvajtjen e procedurës së ndjekur⁹³.

Ndërkohë, në një tjetër rast të shqyrtuar nga KPA, trupa gjyquese e njohu subjektin e rivlerësimit F.I. me opinionin e lëshuar nga ana e vëzhguesit ndërkombëtar, ndonëse ky opinion u paraqit në fazën procedurale në të cilën trupa shqyrtuese ishte tërhequr në dhomë këshillimi për marrjen e vendimit përfundimtar. Trupi gjyques, bazuar në nenin 315 të Kodit të Procedurës Civile, vendosi të revokojë vendimin e ndërmjetëm për përfundimin e hetimit gjyqësor dhe rihapjen e tij, me qëllim marrjen në shqyrtim në gjykimin e çështjes të opinionit me shkrim të dhënë nga vëzhguesi ndërkombëtar dhe vënien e tij në dispozicion të subjektit të rivlerësimit.⁹⁴

⁹⁰ Vendim nr. 552, dt. 14.07.2022, link <chrome-extension://efaidnbmnnnibpcajpcgglefindmkaj/https://kpk.al/ep-content/uploads/2022/09/Vendim-Riselda-Fishta.pdf>

Konkretisht gjatë rivlerësimit të subjektit, KPK referon vendimin e ndërmjetëm nr. 3 datë 8.7.2021 dhe nr. 4 datë 14.7.2021, të dyja të cilat i referohen vlerësimit të kriterit të aftësive profesionale, por nuk ofrohet ndonjë informacion më shumë lidhur me të.

⁹¹ Vendim nr. 576, dt. 20.10.2022, link <chrome-extension://efaidnbmnnnibpcajpcgglefindmkaj/https://kpk.al/ep-content/uploads/2022/11/Enerjeta-Shehaj-Vendim.pdf>

⁹² Shih vendimet nr. 8, datë 23.02.2021; nr. 34, datë 29.05.2015 të Gjykatës Kushtetuese.

⁹³ Vendim nr. 511, dt. 18.02.2022, link: <chrome-extension://efaidnbmnnnibpcajpcgglefindmkaj/https://kpk.al/ep-content/uploads/2022/02/Vendim-Roland-Hysi-.pdf>

⁹⁴ [Vendim Nr. 10/2022 \(JR\) datë 14.04.2022; përfshirë mendimet e pakicës](chrome-extension://efaidnbmnnnibpcajpcgglefindmkaj/https://kpa.al/ep-content/uploads/2022/06/Vendim-dhe-mendimet-pakice_Fatri-Islamaj_anonimizuar.pdf), link chrome-extension://efaidnbmnnnibpcajpcgglefindmkaj/https://kpa.al/ep-content/uploads/2022/06/Vendim-dhe-mendimet-pakice_Fatri-Islamaj_anonimizuar.pdf

Vendimmarrja e KPK-së gjatë rivlerësimit të subjektit E.C. konsiderohet standardi optimal nga ana e vëzhguesve të KShH-së për shkak të analizës vlerësuese që trupa shqyrtuese ka realizuar sa i takon parimit të "pjesëmarrjes efektive" dhe parimit të "barazisë së armëve", si pjesë e një gjykimi të drejtë dhe procesi të rregullt ligjor, bazuar në nenin 6 të KEDNJ, pasi subjektit të rivlerësimit nuk i është dhënë akses në provat dhe faktet e identifikuar nga DSIK lidhur me kriterin e "vlerësimit të pastërtisë së figurës".⁹⁵

Në analizë të vendimmarrjeve të studiuara, vëzhguesit nuk evidentuan në asnjë rast vlerësim nga ana e organeve përgjegjëse të vetting-ut mbi natyrën publike të vendimeve, garantuar ndër të tjera nëpërmjet gjithëpërfshirjes së subjekteve të interesuara, ose ekzistencën e pengesave apo vështirësive që çenojnë pjesëmarrjen e publikut në seancën e planifikuar dëgjimore.

Sa i përket parimit të kontradiktoritetit, vëzhguesit e KShH-së vlerësojnë se në masë është bërë i mundur respektimi i këtij parimi nga ana e trupave gjykuese të organeve të vetting-ut, në rastet e subjekteve të rivlerësimit, çështja në ngarkim të të cilëve është shqyrtuar në seancë dëgjimore. Duke vlerësuar ndërlidhjen substanciale ndërmjet këtij parimi dhe institutit të barrës së provës, vëzhguesit konstatojnë se si Komisioni, edhe Kolegji, i kanë garantuar subjekteve të drejtën e tyre për të paraqitur kërkesa, duke përfshirë dhe ato që kanë si objekt marrjen e provave të reja.

Analiza e kampionit të vendimeve ka identifikuar raste të ndryshme, siç është ai i subjektit E.C., në të cilin KPK duket se në vendimmarrje ka pasqyruar në mënyrë të papërpunuar kërkesat dhe pretendimet e subjektit, ndërkohë që analiza e realizuar nga organi përgjegjës i rivlerësimit shfaqet më e detajuar dhe e argumentuar nga ana juridike. Përkundër kësaj qasje, vëzhguesit kanë konstatuar një frymë mbështetëse nga trupa shqyrtuese e KPK-së, në rastin e analizës së vendimmarrjes ndaj subjektit A.B.⁹⁶ Në perceptimin e vëzhguesit ka tërhequr vëmendjen mënyra se si citohen argumentet e paraqitura nga subjekti, të redaktuara në formë pozitive dhe të formuluar qartë e në mënyrë të plotë nga ana e KPK-së.

Ndërkohë që nuk kanë munguar rastet si për shembull subjekti E.B., ku janë rrëzuar disa kërkesa të depozituara nga ana e subjektit të rivlerësimit si për marrjen e provave të reja apo thirrjen e dëshmitarëve në shqyrtim, kryerjen e një analize të re financiare dhe konstatimin e nivelit të besueshëm për kriterin e pasurisë dhe çeljen e hetimit administrativ për të tre kriteret e rivlerësimit.⁹⁷ Vendimmarrja e Komisionit karakterizohet nga mungesa e bazës ligjore apo e arsyeve se ku mbështetet rrëzimi i kërkesave të ndërmjetme të paraqitura nga subjekti gjatë procesit ndaj tij.

2.4 Impakti i denoncimeve të publikut në vendimmarrjen e organeve të vetting-ut

Nga analiza e vendimmarrjeve objekt studimi, vëzhguesit e KShH-së konstatojnë se në masë janë pasqyruar numri i denoncimeve të adresuara nga publiku, qasja e trupës gjykuese në trajtimin e tyre, si dhe vlerësimi i organeve përgjegjëse të vettingut pas shqyrtimit të pretendimeve të subjektit

⁹⁵ Vendim nr. 509, dt. 17.02.2022, link <chrome-extension://efaidnbmnnnibpcajpcglclefindmkaj/https://kpk.al/ep-content/uploads/2022/05/Vendim-Edlira-Cufi.pdf>

⁹⁶ Vendim nr. 536, dt. 02.06.2022, link <chrome-extension://efaidnbmnnnibpcajpcglclefindmkaj/https://kpk.al/ep-content/uploads/2022/07/Vendim-Alma-Bramo.pdf>

⁹⁷ Vendim nr. 516, dt. 03.03.2022, link <chrome-extension://efaidnbmnnnibpcajpcglclefindmkaj/https://kpk.al/ep-content/uploads/2022/04/Vendimi-E.-Beqiri-.pdf>

të rivlerësimit. Në përgjithësi, qytetarët kanë pretenduar cënim të elementëve të procesit të rregullt ligjor, nga ana e subjekteve të rivlerësimit. Gjithashtu, nuk kanë munguar rastet kur në vendim nuk janë referuar denoncime nga publiku, ose kur objekti i këtyre denoncimeve është cekur përciptazi vetëm në mendimin e pakicës të publikuar si pjesë e vendimit.

Konkretisht në rastin e subjektit të rivlerësuar F.I.⁹⁸ anëtarja në pakicë e trupës gjyquese të Kolegjit bën me dije se në adresë të subjektit kanë mbërritur minimalisht 25 denoncime, disa prej të cilave edhe publike. Është konstatuar se subjekti i rivlerësimit ka gjykuar në (të paktën) 3 çështje, në kushtet e konfliktit të interesit. Vlen të theksohet se, trupa gjyquese e Kolegjit i ka vlerësuar këto çështje pa peshë në rivlerësimin e subjektit, megjithëse në njërin prej tyre subjekti ka qenë në dijeni të konfliktit gjyqësor të vëllait të tij me institucionin shtetëror palë ndërgjyqëse. Sipas trupës gjyquese, meqenëse “palët nuk kanë kërkuar përjashtimin e tij” apo meqenëse subjekti nuk mund të kishte dijeni për marrëdhënien e interesit mes vëllait të tij dhe një personi juridik, gjykimet në kushtet e konfliktit të interesit nuk përbëjnë shkak për shkarkim. Pavarësisht peshës që kanë këto denoncime, në kuadër të transparencës, rritjes së besimit të publikut tek sistemi i drejtësisë dhe përligjes së këtij procesi në sytë e publikut, vlerësojmë se denoncimet e ardhura nga publiku në emër të subjektit të rivlerësimit do duhet të analizuar në vendim, duke ruajtur anonimatit e denoncuesve.

Në procesin e rivlerësimit të subjektit E.B., vëzhguesit e KShH-së kanë konstatuar një analizë të plotë të KPK-së gjatë trajtimit të dy denoncimeve të adresuara nga ana e publikut, nëpërmjet të cilave pretendohet cënim i rregullave procedurale dhe materiale ligjore. Përkatesisht në rastin e parë, trajtohet çështja e mos komunikimit në kohë të vendimmarrjes së prokurorisë për mosfillimin e procedimit penal, ndërkohë në rastin e dytë subjekti i rivlerësimit pretendohet se ka vendosur pushimin e çështjes penale, pavarësisht vendimmarrjeve të Gjykatave lidhur me vijueshmërinë e hetimit.⁹⁹

Në rastin e subjektit A.A., KPK është përballur me një numër të lartë prej 18 denoncimesh të adresuara nga publiku, të natyrave të ndryshme, si pretendime për veprime korruptive dhe zvarritje të procesit gjyqësor nga ana e subjektit ose shkelje procedurale.¹⁰⁰ Në masë këto denoncime nuk janë marrë në konsideratë nga ana e KPK-së, duke argumentuar se kanë lidhje me fazën e ekzekutimit të vendimit dhe jo në mënyrë të drejtpërdrejtë me subjektin, për mungesë provash ose faktesh për bazueshmërinë e denoncimit. Në rastet e disa denoncimeve që kanë si objekt zvarritjen e proceseve gjyqësore, KPK duket se ka shfaqur fleksibilitet në argumentimin e tij, ku në njërin rast, pavarësisht se sipas sistemit të vlerësimit nga KLD shqyrtimi i çështjes duhet të ishte 4 muaj, në fakt kishte zgjatur 9 muaj 16 ditë, për shkak të shtyrjes së seancave me kërkesë të denoncuesit/avokatit dhe ngarkesës së vetë subjektit të rivlerësimit në atë periudhë. Ndërkohë në rastin tjetër me objekt shqyrtimin e një kërkesë për vërtetim fakti rezulton se procesi ka zgjatur 2 vjet e 5 muaj, ndërkohë që sipas sistemit të vlerësimit të KLD-së duhet të ishte shqyrtuar për 6 muaj. Pavarësisht këtij disproporcionaliteti të madh në kohë, kjo zvarritje është konsideruar e justifikuar objektivisht nga Komisioni, për shkak të ngarkesës së subjektit të rivlerësimit në atë

⁹⁸ [Vendim Nr. 10/2022 \(JR\) datë 14.04.2022; përfshirë mendimet e pakicës](#)

⁹⁹ Vendim nr. 524, dt. 08.04.2022, link <chrome-extension://efaidnbmnnnibpcajpcglclefindmkaj/https://kpk.al/ep-content/uploads/2022/05/Vendim-Elfrida-Bregova.pdf>

¹⁰⁰ Vendim nr. 522, dt. 01.04.2022, link <chrome-extension://efaidnbmnnnibpcajpcglclefindmkaj/https://kpk.al/ep-content/uploads/2022/04/Vendim-Arapi.pdf>

periudhë.

Në këtë drejtim, raporti nxjerr në pah mungesën e një standarti të unifikuar mbi vlerësimin dhe pasqyrimin e denoncimeve të paraqitura nga publiku në drejtim të subjekteve të rivlerësimit. Nga konstatimet e mësipërme, rezulton që praktika është e ndryshme, duke krijuar edhe perceptim për trajtim të diferencuar mes subjekteve të rivlerësimit.

2.5 Roli proaktiv i ONM-së dhe trajtimi i denoncimeve të përcjella prej përfaqësuesve të tyre

Nga natyra e kompetencave kushtetuese të njohura, fushëveprimi i ONM-së shtrihet mbi monitorimin dhe mbikëqyrjen e gjithë procesit, ndërkohë që adresimi i gjetjeve dhe rekomandimeve me shkrim ndaj organeve përgjegjëse të vetting-ut ka si qëllim garantimin e standardeve ndërkombëtare ndaj subjekteve të rivlerësimit si dhe ruajtjen e integritetit dhe pacënueshmërinë e procesit në tërësi.

Në përmbajtjen e vendimeve të studiuara, vëzhguesit e KShH-së kanë identifikuar pasqyrimin e të dhënave identifikuese të përfaqësuesve të ONM-së, ndërkohë që informacion konkret mbi kontributet e vëzhguesit ndërkombëtar, nuk kanë gjetur gjithmonë pasqyrim në vendimin e zbardhur.

Në vendimin e KPK-së ndaj subjektit të rivlerësimit E.Sh. janë pasqyruar gjetje dhe orientime të vëzhguesit ndërkombëtar, në kuptim të nenit 49 pika 11 të ligjit nr. 84/2016. Më konkretisht *“Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit, me shkresën nr. *** prot., datë 22.9.2021, bazuar në nenin B, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 49, pika 11 e ligjit të posaçëm nr. 84/2016, ka depozituar në Komision opinionin për subjektin, duke kërkuar që të verifikojë dhe kontrollojë dosjet e vendimmarrjeve të subjektit që ju takojnë denoncuesve: SH.Ç, shkurt 2019; N.M, qershor 2019; N.Sh, nëntor 2019; V.A, shtator 2020. Analiza e këtyre dosjeve, shprehet opinioni, është i rëndësishëm, për të vlerësuar aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit.”*¹⁰¹

Gjithashtu, nga studimi i vendimit ndaj subjektit E.I. referohen të dhëna ku vërehet një rol proaktiv nga vëzhguesi ndërkombëtar, në adresimin e rekomandimeve dhe gjetjeve për të tre kriteret e rivlerësimit, referuar nenit B të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 45 të Ligjit 84/2016, pasqyruar kjo nëpërmjet adresimit të 7 gjetjeve dhe 6 opinioneve lidhur me të tre kriteret e rivlerësimit.¹⁰² Në këtë vendimmarrje, vërehet se denoncimet nga publiku nuk pasqyrohen në një seksion të veçantë, por duke qenë se ato janë kanalizuar ose përcjellë nga vëzhguesi ndërkombëtar, janë trajtuar si pjesë e gjetjeve të ONM-së për sa i përket vlerësimit të kriterit të pastërtisë së figurës së subjektit.

Gjithashtu, në vendimmarrjen ndaj subjektit E.C., KPK ka reflektuar në vendimin e tij opinionin

¹⁰¹ Pika 16.1, fq 23 e vendimit nr. 567, dt. 20.10.2022, link chrome-extension://efaidnbmnnnibpcajpcglclefindmkaj/https://kpa.al/ëp-content/uploads/2022/11/Enerjeta-Shehaj-Vendim.pdf

¹⁰² [Vendim Nr. 11/2022 \(JR\) datë 27.04.2022](https://kpa.al/ëp-content/uploads/2022/06/Vendim_Elizabeta_Imeraj_anonimizuar.pdf) link chrome-extension://efaidnbmnnnibpcajpcglclefindmkaj/https://kpa.al/ëp-content/uploads/2022/06/Vendim_Elizabeta_Imeraj_anonimizuar.pdf

e vëzhguesit ndërkombëtar , në të cilin parashtrohen veprat penale për të cilat ishte dënua në shtetin italian shtetasi A.H dhe N.H, të cilat bëjnë pjesë në gamën e veprave penale të parashikuara në pikat 8 dhe 15, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016, sipas të cilave personi cilësohet si i person i përfshirë në krimin e organizuar.¹⁰³ Në këtë vendim nuk është pasqyruar rekomandimi përfundimtar i ONM-së.

Duke mbajtur në konsideratë pavarësinë e opinioneve të vëzhguesve ndërkombëtarë të ONM-së sjellim në vëmendje rastin e subjektit Zh.P, e cila ka mbajtur funksionin e inspektore pranë KLD-së, për të cilën ONM ka konkluduar se subjekti nuk duhej t'i nënshtrohej procesit të rivlerësimit. Gjithashtu, vëzhguesi ndërkombëtar i ONM-së referon se në zbatim të neneve 165 pika 4 e ligjit 96/2016 dhe 42 pika 4 e ligjit 84/2016, subjekti i rivlerësimit duhet t'i ishte nënshtuar edhe testimit në Shkollën e Magjistraturës, duke mos pasur statusin e magjistratit. Edhe Komisioni në analizën e tij arrin në të njëjtin përfundim, por më pas vlerësoi përfundimisht se duke pasur parasysh anën subjektive në mirëbesim të subjektit për ruajtjen e statusit të magjistratit të konfirmuar edhe nga një vendim i KLGJ-së në vitin 2019 nuk e konsideroi mos-kryerjen e testimit në Shkollën e Magjistraturës si shkak për pamjaftueshmëri të vlerësimit profesional të saj.

2.6 Respektimi i parimit të proporcionalitetit

GjEDNj lidhur me parimin e proporcionalitetit thekson se ky parim në thelb është një '*alter ego*' ose një variant i parimit të mbrojtjes efektive dhe ka pasur një ndikim të gjithanshëm në praktikën e saj lidhur me zbatimin e KEDNj, në rastet kur është dashur të përcaktohet marrëdhënia midis koncepteve të ndryshme, normave, interesave dhe të drejtave të cilat parashikon konventa.¹⁰⁴

Kryesisht në analizën e vlerësimit të pasurisë, vëzhguesit e KShH-së kanë konkluduar se referuar relativitetin në seancë dëgjimore, duke qenë se disa prej subjekteve të rivlerësimit disponojnë pasuri modeste, Komisioni i ka kushtuar rëndësi të posaçme vlerësimit të kriterit profesional. Parë në një këndvështrim krahasues me raste të mëparshme, kur subjektet kanë pasuri të konsiderueshme, krijohet përshtypja se nuk i kushtohet vëmendja e duhur kriterit të profesionalizmit apo të figurës, të cilat trajtohet në mënyrë më sipërfaqësore. Analiza e Komisionit vërehet se herë pas here gjatë vlerësimit të kriterëve të ndryshme, reflekton qasje të ndryshme në drejtim të testimit të proporcionalitetit, kjo bazuar në volumet përkatëse të kriterit përkatës objekt vlerësimi.¹⁰⁵

Mungesë proporcionaliteti ndërmjet vendimmarrjes së Komisionit dhe gjetjeve të referuara nëpërmjet raporteve të organeve ndihmëse si DSIK dhe ILDKPKI, është konstatuar në rastin e rivlerësimit të subjektit T.B. Pavarësisht rezultateve të këtyre raporteve, Komisioni me të drejtën që i jep ligji nëpërmjet nenit 4(2), kreu VII të ligjit nr. 84/2016, por edhe vendimit të Gjykatës Kushtetuese ka realizuar një proces të mirëfilltë kontrolli që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet ndihmëse. Megjithatë, kur, në këtë rast, Komisioni merr

¹⁰³ Fq 25 i vendimit nr. 509, dt. 17.02.2022, link chrome-extension://efaidnbmnnnibpcajpcglclefindmkaj/https://kpk.al/ep-content/uploads/2022/05/Vendim-Edlira-Cufi.pdf

¹⁰⁴ M.A. Eissen, "The Principle of Proportionality in the Case-Laë of the European Court of Human Rights" in R.St.J.Macdonald *et al.* (eds.), *op. cit.*, pp.125-146; J. McBride, "Proportionality and the European Convention on Human Rights" in E. Ellis (ed.), *The Principle of Proportionality in the Laës of Europe* (Oxford: Hart Publishing, 1999) 23-35.

¹⁰⁵ Vendim nr. 577, dt. 21.10.2022, link chrome-extension://efaidnbmnnnibpcajpcglclefindmkaj/https://kpk.al/ep-content/uploads/2022/11/Vendim-L.-Kole-1.pdf

përsipër një kontroll të mirëfilltë do duhej të analizonte me përpikmëri të gjitha të dhënat dhe të arrijë në një analizë të mirëfilltë gjë e cila nuk rezulton e tillë nëse i referohemi citimit nga vendimi: *“Gjithsesi, vlen të theksohet se kjo është një analizë me rezervë, për sa kohë nuk rezulton që për këto dy vite tatim fitimi të jetë parapaguar dhe për më tepër nuk mund të bëhet një përlllogaritje e saktë dhe objektive e të ardhurave dhe shpenzimeve të realizuara nga subjekti tregtar deri në datat e kryerjes së pagesave, sipas kësteve, për likuidimin e çmimit të pasurisë objekt vlerësimi”*¹⁰⁶. Situata do ishte në kufijtë e të pranueshmes në rast se do kishim të bënim me rezultate të diskutueshme në rastin e një kriteri vlerësimi. Fakti që Komisioni dhe organet ndihmëse, për të trija kriteret kanë dalë në rezultate hetimi të kundërta krijon pikëpyetje tek sytë e një vëzhguesi të jashtëm e të paanshëm.

Parimi i proporcionalitetit është trajtuar edhe në rastin e mendimit paralel të hartuar nga ana e kryesuesit të trupës gjyquese të KPK-së, në vendimmarrjen për subjektin e rivlerësimit A.L., në përfundim të së cilës u vendos shkarkimi i tij nga detyra. Në mendimin paralel argumentohet se përdorimi i nenit 4 pika 2 e ligjit 84/2016 është jo proporcional, në kuptim të vendimmarrjes sipas nenit 61 pika 3 dhe 5 të ligjit 84/2016. Më konkretisht *“Nëse të njëjtat fakte do të ripërdoreshin për një rikualifikim të dytë në mbështetje, këtë herë, edhe të aplikimit të pikës 5 të kësaj dispozite, atëherë do të gjendeshim përballë një penalizimi të padrejtë dhe të dyfishtë të subjektit, duke u bazuar mbi të njëjtat rrethana faktike. Kjo do të binte ndesh me parimin e proporcionalitetit, pasi deformon atë ekuilibër që duhet të ruhet dhe të jetë gjithmonë prezent në një raport të drejtë midis shkakut dhe pasojës, dhe kështu do të kishim një dyfishim të pasojës për të njëjtat shkaqe apo shkelje. Gjithashtu, kjo qasje nuk do të ishte në përputhje as me jurisprundencën e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, që ka qartësuar pamundësinë e një kualifikimi të dyfishtë mbi konstatimet dhe faktet e provuara përgjatë hetimit administrativ”*.¹⁰⁷

Në fakt, çështja e zbatimit të parimit të proporcionalitetit është ngritur edhe përpara GjEDNj dhe më konkretisht kjo e fundit është shprehur për proporcionalitetin në çështjen *Sevdari kundër Shqipërisë*. Në këtë çështje, GjEDNj pranon se *“...shkarkimi nga detyra-i gjyqtarëve dhe prokurorëve që janë të caktuar përjetë- është një sanksion i rëndë, në mos masa më e rëndë disiplinore që mund t'i caktohet një individ. Caktimi i një mase të tillë që ndikon negativisht në jetën private të një individ kërkon vlerësimin e provave të qarta që lidhen me etikën, integritetin dhe aftësisë profesionale të tij”*.¹⁰⁸ Njëherësh, GjEDNj thekson se ndonëse evazioni fiskal është një çështje e rëndë, për qëllim të procedurave të vetting-ut të kërkueses, është më rëndësi që shuma e të ardhurave bashkëshortore, mbi të cilat nuk ishte provuar pagimi i tatimit përkatës, përfaqësonte një përqindje shumë të vogël të totalit të të ardhurave bashkëshortore gjatë periudhës së vlerësimit dhe gjithashtu me rëndësi ishte fakti që nuk u gjetën probleme për bashkëshortin për të ardhurat e siguruara brenda vendit për disa vite rresht.¹⁰⁹ Për rrjedhojë, GjEDNj konkludon se bazuar kryesisht në faktin se kërkuesja ishte e paaftë të provonte që bashkëshorti i saj kishte paguar tatimin mbi disa nga të ardhurat e tij nga veprimtari i ligjshme e kryer para dy dekadash dhe në mungesë të ndonjë treguesi për keqbesim ose shkelje e qëllimshme e normave nga vet kërkuesja, masa e

¹⁰⁶ Vendim nr. 520, dt. 30.03.2022, link <chrome-extension://efaidnbmnnnibpcajpcgclefindmkaj/https://kpk.al/ep-content/uploads/2022/04/Vendim-Taulant-Banushi.pdf>

¹⁰⁷ Mendim paralel ndaj vendimit nr. 497, dt. 13.01.2022, link <chrome-extension://efaidnbmnnnibpcajpcgclefindmkaj/https://kpk.al/ep-content/uploads/2022/02/Mendimi-Paralel.pdf>

¹⁰⁸ *Sevdari kundër Shqipërisë*, aplikimi no. [40662/19](#), 13.3.2023, pg. 86. Shih gjithashtu edhe *Xhoxhaj kundër Shqipërisë*, pg. 403

¹⁰⁹ *Sevdari kundër Shqipërisë*, aplikimi no. [40662/19](#), 13.3.2023, pg. 93.

dhënë ndaj saj ishte jo përpjesëtimore me qëllimin që ndjek procesi i vetting-ut.¹¹⁰

Kjo vendimmarrje e GjEDNj dëshmon për standardin kontekstualizimit të secilës shkelje apo pasaktësi dhe për ta vlerësuar me kujdes në raport edhe me kriteret e tjera, duke i kushtuar vëmendje edhe provave përkatëse që subjekti i rivlerësimit ka paraqitur në mbrojtje të pretendimit të tij.

2.7 Standardi i ndjekur lidhur me vlerësimin harmonik të tri kriterëve dhe analiza e rasteve bazuar në vlerësimin vetëm të një kriteri

Nga vlerësimi i vendimeve objekt studimi, konstatohet se organet përgjegjëse të vetting-ut e kanë shtrirë procesin e tyre të rivlerësimit në të tre kriteret, siç kërkohet nga neni 7 i Aneksit Kushtetues dhe 4 i ligjit nr. 84/2016.

Në rastin e vendimit të KPA-së ndaj subjektit L.D., vëzhguesi i KShH-së ka konstatuar se Kolegji ka analizuar në mënyrë të veçantë kriterin e pasurisë dhe atë të aftësive profesionale (konkretisht etikës profesionale). Në vendim analizohet në masën mbi 95% të vendimmarrjes vetëm kriteri i pasurisë, krahasuar me kriterin e aftësive profesionale. Por vlen të theksohet se ankimi bazuar në gjetjet e konstatimet mbi kriterin e aftësive profesionale është ngritur nga ana e Komisionerit Publik vetëm mbi një moment që ngre dyshim mbi konfliktin e mundshëm të interesit të subjektit të rivlerësimit. Vendimmarrja e KPA-së ka si fokus kryesor analizën dhe vlerësimin e aftësive financiare të subjektit LD., për krijimin e pasurive dhe mbulimin e shpenzimeve të jetesës.¹¹¹

Gjatë procesit të rivlerësimit të subjektit M.F., KPK argumenton në vendimin e saj se ka shtrirë procesin hetimor në të tre kriteret e rivlerësimit, por në këtë vendim do të trajtohet vetëm kriteri i aftësive profesionale. Në vlerësimin e vëzhguesit të KShH-së, mungesa e arsytimit për dy kriteret e tjera të rivlerësimit, nuk i shërben pozitivisht garantimit të proporcionalitetit dhe transparencës karshi publikut.¹¹²

2.8 Analizë e vlerësimit të kriterit të pasurisë

Siç edhe më lart u evidentua, pavarësisht se në disa vendimmarrje merren në analizë të treja kriteret e vlerësimit, një pjesë e konsiderueshme e vendimit i kushtohet kriterit të pasurisë. Organet përgjegjëse të vetting-ut e kanë fokusuar analizën e vendimmarrjeve të tyre në vërtetësinë e deklarimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe personave të lidhur, verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve si dhe evidentimin ose jo të fshehjes së pasurive, deklarimeve të rremë apo konfliktit të interesit.

Për shkak se gjetjet dhe konstatimet mbi kriterin e pasurisë kanë qenë shkak ankimi pranë KPA-së, vërehet se Kolegji nuk i ka kaluar barrën e provës subjektit të rivlerësimit gjatë gjykimit në KPA, por ka analizuar në vendim në disa momente, se si KPK i ka kaluar barrën e provës këtij subjekti. Përkatësisht, Kolegji argumenton se “... Në zbatim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, KPK i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën për të provuar të ardhurat e ligjshme të personit

¹¹⁰ Ibid., pg. 96.

¹¹¹ [Vendim Nr. 28/2022 \(JR\) datë 14.07.2022; përfshirë mendimin paralel dhe mendimet e pakicës;](#)

¹¹² Vendim i ndërmjetëm dt. 13.05.2022, link kpk.al/ep-content/uploads/2022/05/Vendim-M.Fraseri.pdf

tjetër të lidhur, babait, për dhënien e shumës 5.000 euro".¹¹³

Në mendimin paralel të dhënë gjatë shqyrtimit të subjektit të rivlerësimit D.B., anëtarja e trupës gjyquese të Kolegjit ka argumentuar në lidhje me konceptin e 'personit tjetër të lidhur' referuar ligjit 84/2016 dhe nenit D pika 1, 3 dhe 5 të Aneksit Kushtetues. Në këtë vendim argumentohet se babai i subjektit të rivlerësimit duhet kualifikuar si person tjetër i lidhur për shkak të marrëdhënies së përdorimit (nga ana e subjektit) të një pasurie të paluajtshme në pronësi të babait.¹¹⁴ Gjithashtu, sa i përket përkufizimit të 'personave të lidhur' sipas ligjit nr. 84/2016, vendimi i KPA-së ndaj subjektit të rivlerësimit R.S.¹¹⁵ argumenton se nën këtë përkufizim nuk përfshihen personat në rrethin e afërt familjar të subjektit të rivlerësimit të cilët mundet praktikisht të shërbejnë për fshehjen e pasurive të paligjshme të tyre, si për shembull vjehrrin, vjehrra, motrat dhe vëllezërit, apo kunat etj, nëse ata nuk janë pjesë e certifikatës familjare të tyre. Në vlerësimin e Kolegjit, kjo krijon pengesë për organet e rivlerësimit për të zbatuar nenin 32 pika 1, duke i klasifikuar këta persona si "persona të tjerë të lidhur", pasi nuk është e mundur që të zbatohet neni 32 pika 4 nëse ata nuk kanë qenë dhurues apo huadhënës apo huamarrës kundrejt subjektit të rivlerësimit, ndërkohë që ata realisht mund të kenë qenë "mjet" për fshehjen e pasurisë së subjektit të rivlerësimit. Kjo vendimmarrje është shoqëruar ndër të tjera edhe me dy mendime paralele nga dy anëtarë pjesë e shumicës votuese. Edhe pse shumica e trupit gjyqësor nuk e ka konsideruar vjehrrin e subjektit si person tjetër të lidhur, dy anëtarët e trupës gjyquese në opinionet e tyre në pakicë kanë argumentuar të kundërtën.

Disa nga elementët kyç që vëzhguesi i KShH-së ka identifikuar nga analiza e kësaj vendimmarrje të Kolegjit rezultojnë se pasuritë e krijuara nga personat e lidhur përpara se ata të bëheshin të lidhur nuk janë objekt i deklaratimit dhe kontrollit të ligjshmërisë së burimeve të tyre.

Ndërkohë gjatë realizimit të procedurës së rivlerësimit të subjektit A.J., KPA e bazoi objektin e kontrollit të pasurisë mbi deklaratimet e bëra nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën vetting, ndërsa deklaratimet e realizuara në deklaratat periodike u klasifikuan si provë për të mbështetur deklaratimet e bëra në deklaratën Vetting. Nga analiza që Kolegji rezultojnë se këto bërë në këtë rast konstatohet se KPK ka bërë një lexim dhe llogaritje të gabuar të deklarimeve të gjendjes cash në fund të çdo viti, duke llogaritur shtesat në kursime që quheshin "kursime vjetore" si gjendje cash në fund të vitit. Kjo vendimmarrje është shoqëruar nga dy mendime në pakicë nga anëtarët e trupës gjyquese të Kolegjit, ku njëra prej anëtareve argumenton se sa i takon deklarimeve të pasakta në deklaratën vetting që përbejnë fshehje të pasurisë sipas ligjit, subjekti i rivlerësimit ka pasur detyrimin të deklarojë saktë në deklaratën periodike dhe atë të pasurisë vetting situatën faktike të përdorimit dhe të shkëmbimit të një apartamenti si dhe heqjen dorë nga apartamenti tjetër, i porositur fillimisht nga bashkëshorti i subjektit. Për sa i përket kriterit të vlerësimit të pasurisë, në ankimin e tij të mbështetur në rekomandimin e tre vëzhguesve ndërkombëtarë, Komisioneri Publik argumentoi se dështimi i subjektit për të deklaruar përdorimin e apartamentit në pronësi dhe ku jeton aktualisht që nga viti 2011, parë së bashku me mungesën e burimeve të ligjshme për kryerjen e pagesës së kështit të parë të apartamentit, përbejnë deklaratim të pasaktë që passjell mosarritjen e nivelit të besueshëm në vlerësimin e kriterit të pasurisë.¹¹⁶

¹¹³ [Vendim Nr. 20/2022 \(JR\) datë 14.06.2022; përfshirë mendimet paralele](#)

¹¹⁴ [Vendim Nr. 18/2022 \(JR\) datë 08.06.2022, përfshirë mendimin paralel](#)

¹¹⁵ [Vendim Nr. 22/2022 \(JR\) datë 22.06.2022; përfshirë mendimet paralele](#)

¹¹⁶ [Vendim Nr. 2/2022 \(JR\) datë 15.02.2022, përfshirë mendimet e pakicës](#)

2.9 Analizë e vlerësimit të kriterit të figurës

Edhe sa i takon këtij kriteri, jo në çdo rast vendimmarrjet e organeve përgjegjëse të vetting-ut kanë reflektuar të njëjtën linjë argumentimi me gjetjet e referuara nga DSIK, kjo nisur edhe nga shtrirja e hetimit të thelluar nga vetë organet përgjegjëse të vetting-ut.

Në rastin e subjektit të rivlerësimit L.K.,¹¹⁷ KPK administroi një dosje gjyqësore nga ana e Gjykatës së Rrethit Korçë, e cila ishte shqyrtuar nga subjekti i rivlerësimit. Në këtë vendimmarrje, tërheq vëmendjen mungesa e relativitetit të indicies që shtyu organin përgjegjës të vetting-ut që të mos bazohej vetëm në raportin pozitiv të DSIK-së, por të përditësonte informacionin me të dhëna të tjera nga organet ligjzbatuese. Por pavarësisht nga kjo, në përfundim, u konkludua nga KPK se subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel të besueshëm për kriterin e figurës.

KPK ka mbajtur qëndrim tjetër nga DSIK edhe gjatë shqyrtimit të çështjes ndaj subjektit të rivlerësimit T.B. Më konkretisht, të dhënat fillestare të DSIK-së të pasqyruara në raportin e hartuar prej këtij institucioni kanë krijuar bindje për përshtatshmëri të subjektit për vazhdimin e detyrës. Pas përditësimit të këtij informacioni, sërish ky institucion bën të ditur se disponohen të dhëna për përfshirje në veprimtari korruptive, gjatë disa proceseve penale dhe civile në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier. Në përfundim të hetimit të realizuar nga KPK konkludohet se informacionet e përcjella nga institucioni i verifikimit, mbi bazën e të cilave është përditësuar/ndryshuar raporti i DSIK-së, nuk pasqyrojnë raste konkrete mbi të cilat mund të provohet tej çdo dyshimi të arsyeshëm ekzistenca e kontakteve të papërshtatshme të subjektit të rivlerësimit me persona të përfshirë në krimin e organizuar dhe/apo përfshirja e tij në veprimtari të kundërligjshme. Në përfundim të analizës, KPK ka vlerësuar se subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.¹¹⁸

2.10 Gjetje dhe konstatime nga vlerësimi i kriterit të aftësive profesionale

Rivlerësimi i kriterit të aftësive profesionale, i realizuar në mbështetje të nenit E të Aneksit Kushtetues dhe nenet 40 e vijues të ligjit nr. 84/2016, ka si qëllim identifikimin e atyre subjekteve të rivlerësimit të cilët janë ose jo të kualifikuar për të kryer funksionin e tyre.

Në përgjithësi, nga analiza e vendimmarrjeve të kampionuara, rezulton se kriteri i aftësive profesionale ka qenë në fokus të drejtpërdrejtë të trupave gjyqësore të organeve të vetting-ut në disa raste sporadike, ndërkohë që në shumicën e rasteve kur është vlerësuar paralelisht me dy kriteret e tjera të rivlerësimit duket se ai është zbehur përballë atij të pasurisë.

KLP dhe KLGj, në cilësinë e organeve ndihmëse për vlerësimin profesional që kryhet nga institucionet e rivlerësimit kalimtar, bazuar në ligjin nr. 84/2016 dhe në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” përcjellin pranë organeve përgjegjëse të vetting-ut raportin për vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit.

Në rastin e subjektit L.D., nisur nga ankimi i depozituar nga ana e Komisionerit Publik rezultonte

¹¹⁷ Vendim nr. 577, dt. 21.10.2022, link [Vendim-L.-Kole-1.pdf \(kpk.al\)](#)

¹¹⁸ Vendim nr. 520, dt. 30.03.2022, link [Vendim-Taulant-Banushi.pdf \(kpk.al\)](#)

se lindte nevoja që Kolegji, veç të tjerash, të shqyrtonte vendimmarrjen e KPK-së, sa i përket vlerësimit të etikës profesionale të subjektit. Ndërkohë që ky shkak është një ndër arsyet e ankimit, gjatë hetimit administrativ nga ana e Kolegjit dhe shqyrtimit të provave e dokumentacionit përkatës, Komisioneri Publik ndryshon qëndrimin e tij, duke konkluduar paralelisht me Kolegjin, se subjekti i rivlerësimit nuk ka shqyrtuar çështjen e pretenduar në kushtet e konfliktit të interesit.¹¹⁹ Subjekti u shkarkua nga Kolegji, por jo për këtë kriter.

Kriteri i profesionalizmit ka qenë në objekt të drejtpërdrejtë të hetimit të realizuar nga KPK, në rastin e subjektit të rivlerësuar M.F.¹²⁰, në përfundim të të cilit u vendos pezullimi nga detyra i subjektit, për një periudhë njëvjeçare dhe detyrimin për të ndjekur programin e trajnimit, sipas kurrikulave të miratuara nga Shkolla e Magjistraturës. Nga verifikimi i të dhënave arkivore të KLP-së dhe Prokurorisë së Përgjithshme rezulton se ndaj prokurores më herët është dhënë masa disiplinore e “kalimit në një detyrë tjetër më të ulët brenda sistemit të drejtësisë”, si rrjedhojë e neglizhencës së pajustificuar në kryerjen e detyrës dhe tejzgjatjes së pajustificuar të hetimeve paraprake. Këto konstatime janë prapësuar nga ana e subjektit të rivlerësimit, ndër të tjera edhe me vështirësitë e ngarkesën me të cilën ajo përballej në punë, faktorë që kishin shërbyer si shkak i disa kërkesave të saj për transferim. Komisioni argumenton në mënyrë të përmbledhur se *“mangësitë e konstatuara janë kryesisht ato të karakterit organizativ dhe veprimit me efikasitet, të cilat kanë sjellë në mënyrë të përsëritur mospërmbushjen e detyrës si prokurore, duke konkluduar se nuk është efektive”*.

E njëjta vendimmarrje rezulton të jetë dhënë më herët nga Komisioni edhe në rastin e subjektit të rivlerësimit R.F., e cila pas përfundimit të trajnimit pranë Shkollës së Magjistraturës iu nënshtroa procesit të testimit, i cili u përmbyll me rezultate të mira, duke i kaluar mangësitë e parashtruara.¹²¹

Në rastin e subjektit të rivlerësimit E.I., vëzhguesi i ONM-së i ka rekomanduar Kolegjit vlerësimin e kriterit të profesionalizmit duke mbajtur në konsideratë mënyrën joprofesionale të sjelljes së subjektit të rivlerësimit në seancën dëgjimore të datës 24.03.2021. Në këndvështrimin e anëtarëve të trupës gjyquese të KPA-së rezulton se “komunikimi me një subjekt procedural, qoftë ai/ajo vëzhgues, apo anëtar/e i një prej institucioneve të rivlerësimit, nuk mund të perceptohet ndryshe, përveçse një ndërhyrje e drejtpërdrejtë ndaj pavarësisë së këtyre individëve në kryerjen e detyrës së tyre”.¹²²

¹¹⁹ [Vendim Nr. 28/2022 \(JR\) datë 14.07.2022; përfshirë mendimin paralel dhe mendimet e pakicës](#)

¹²⁰ Vendim i ndërmjetëm dt. 13.05.2022, link [Vendim-M.Fraseri.pdf \(kpk.al\)](#)

¹²¹ Vendim nr. 552, dt. 14.07.2022, link [Vendim-Riselda-Fishta.pdf \(kpk.al\)](#)

¹²² [Vendim Nr. 11/2022 \(JR\) datë 27.04.2022](#)

PJESA III

MBI HETIMIN, PROCEDIMIN DHE GJYKIMIN PENAL TË GJYQTARËVE DHE PROKURORËVE TË DORËHEQUR APO SHKARKUAR NË KUADËR TË PROCESIT TË VETTING-UT¹²³

¹²³ Për periudhën 2021-2022.

1. Rekomandimet e KE dhe sfidat e para në drejtim të procedimit penal të subjekteve të ri-vlerësimit të shkarkuar/dorëhequr

Në raportin vjetor për Shqipërinë të vitit 2021, Komisioni Evropian nënvizoi se prej organeve të vetting-ut, pritet t'u referojnë organeve të prokurorisë të gjitha rastet kur ka të dhëna për kryerjen e veprave penale¹²⁴. Në raportin e fundit *Screening*, të Korrikut të vitit 2023, KE nënvizon se Shqipëria duhet të sigurojë fillimin sistematik të procedimit penal ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve, për të cilët, procesi i vetting-ut ka zbuluar elementë kriminalë. Institucionet e vetting-ut pritët që në mënyrë sistematike t'i referojnë rastet në prokurori kur ka tregues të veprave penale, ndërkohë që paralelisht inkurajohet prokuroria në mënyrë proaktive, të fillojë procedimin penal ndaj tyre¹²⁵.

Në shkurt të vitit 2022, KShH publikoi raportin e parë studimor¹²⁶ që ka të bëjë me kallëzimet në prokurori për gjyqtarët dhe prokurorët që i janë nënshtruar vetting-ut, nëse ka patur raste të fillimit me iniciativë të prokurorisë së çështjeve, nëse është vendosur ose jo fillimi i procedimit penal për subjektet, çfarë ka rezultuar në përfundim të tij, nëse janë marrë masa paraprake për sekuestrimin e pasurive të pajustificuara apo të paligjshme, nëse është ngritur akuzë në gjykatë dhe rrjedhimisht a ka patur apo jo ndëshkueshmëri penale të këtyre subjekteve me vendim gjykate. Për të siguruar këto të dhëna, KShH ka kërkuar në rrugë zyrtare informacion nga Prokuroria e Posaçme dhe Prokuroria e Përgjithshme.

Nga ky raport i parë studimor, rezultoi se në 5 vitet e para të veprimtarisë të institucioneve të vetting-ut, përkundrejt detyrave të lëna nga BE, një numër i ulët gjyqtarësh dhe prokurorësh të dorëhequr apo të shkarkuar që janë gjetur me probleme në drejtim të kriterëve të ri-vlerësimit, ose afro 8.5%, rezultojnë se janë proceduar penalisht. Në pjesën më të madhe të tyre, procedimi penal ka ardhur si rezultat i kallëzimeve të publikut, ndërkohë që numërohen tepër të pakta rastet e filluara me nismë kryesisht të prokurorisë (ku iniciativën e ka marrë vetëm SPAK) apo rastet e kallëzuara nga organet e vetting-ut (në një rast). Gjysma e rasteve që janë proceduar penalisht nga SPAK i përkasin më së shumti subjekteve të posaçëm (funksionarë të lartë të sistemit të drejtësisë), ndërkohë që gjysma tjetër e rasteve i janë kaluar nga SPAK për mungesë të kompetencës lëndore, prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm.

Nga analiza e disa prej këtyre çështjeve, në raport me vendimmarrjen e organeve të vetting-ut apo pasuritë e sekuestruara, KShH vërejti se Prokuroria e Posaçme ka filluar procedimin penal duke kufizuar hetimin vetëm për nenin 257/a/2 të Kodit Penal që ka të bëjë me fshehjen apo deklarimin e rremë të pasurive apo interesave private. Gjithashtu u vërejt se afatet e hetimit për subjektet e posaçme janë afro 2 vjet, të konsiderueshme në raport jo vetëm me afatet e parashikuara në Kodin e Procedurës Penale, por njëkohësisht edhe me veprën penale për të cilën ka filluar procedimi penal. Gjatë kësaj periudhe, rezultoi se vetëm ndaj një subjekti ka përfunduar procesi penal, ndaj të cilit gjykata e posaçme e Apelit (GJKK) ka disponuar me vendim të formës së prerë, duke lenë në fuqi vendimin për caktimin e dënimit me 2 vite burg

¹²⁴ <https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2021-10/Albania-Report-2021.pdf>

¹²⁵ https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2023-07/AL%20Cluster_1%20Draft%20screening%20report_external%20version.pdf

¹²⁶ https://ahc.org.al/wp-content/uploads/2022/05/Final_Policy-Paper-1-_-Vetting-Process.pdf

dhe dënimin plotësues të heqjes të së drejtës për të ushtruar funksione publike për 5 vjet (ish Prokurori i Përgjithshëm).

Duke qenë se gjetjet dhe konkluzionet në këtë raport të parë studimor ishin të pjesshme, për arsye se nuk janë monitoruar seancat publike të proceseve gjyqësore penale përkatëse dhe as vendimmarrjet e secilës çështje (qoftë të prokurorisë apo të gjykatës), KShH realizoi një studim të dytë, më të thelluar nga pikëpamja e dokumentacionit të studiuar (sikurse do të analizohet në vijimësi).

2. Gjetjet dhe konkluzionet kryesore të analizës së procedimeve penale.

Në vitet 2021 – 2022, rezultojnë 140 subjekte, shumica dërrmuese gjyqtarë dhe prokurorë, të dorëhequr apo shkarkuar në kuadër të procesit të vetting-ut, për të cilët KPK ka vendosur ndërprerje të procesit ose shkarkim nga detyra. Nga Marsi i vitit 2018, prej kur datojnë vendimet e para të KPK-së, deri në Tetor të vitit 2022, rezulton se KPK ka referuar vetëm 13 raste pranë Prokurorisë së Posaçme, duke u bazuar në rezultatet e hetimit administrativ (bazuar në nenin 281/3 të Kodit të Procedurës Penale).

KPA ka informuar KShH, se qoftë ky institucion, apo ndonjë nga gjyqtarët individualisht, nuk kanë paraqitur kallëzim penal pranë SPAK për çështje që lidhen me subjektet e vetting-ut, duke analizuar se ky nuk është një detyrim sipas dispozitave përkatëse kushtetuese (nenet 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenit F të aneksit Kushtetues). Sipas KShH-së, detyrimi për kallëzimin penal i parashikuar në nenin 281/3 të Kodit Penal, lind pa përjashtim për çdo procedim civil apo administrativ, duke përfshirë këtu edhe procesin e ri-vlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, i cili ka një natyrë gjyqësore me karakter administrativ, veçanërisht kur zhvillohet nga KPA. Si rrjedhojë e këtij interpretimi të gabuar, nuk përjashtohet mundësia që gjyqtarë apo prokurorë të mos jenë denoncuar sipas detyrimeve të nenit 281/3 të Kodit Penal. Vlen gjithashtu të theksohet se Komisioni Evropian ka rekomanduar ndaj institucioneve të vetting-ut, pa përjashtim, që në mënyrë sistematike t'i referojnë rastet në prokurori kur ka tregues të veprave penale nga subjektet e vetting-ut.

Pavarësisht se të tre organet e vetting-ut kanë patur një nivel shumë të mirë bashkëpunimi me qytetarët, si rrjedhojë e disponimit të një numri të lartë ankesash që i ka ndihmuar ato në procesin e hetimit administrativ, këto të dhëna nuk i kanë shërbyer prokurorisë për të bërë verifikime të mëtejshme me veprimet hetimore të parashikuara në Kodin e Procedurës Penale. Në vlerësimin tonë, ato mund të kontribuonin në dinamikën e hetimeve dhe zbardhjen e përgjegjësisë penale për subjektet e vetting-ut, të marrë në cilësinë e të pandehurve.

Sa i takon prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm, rezulton se vetëm prokuroritë e Tiranës, Elbasanit dhe Durrësit kanë konfirmuar raste të fillimit apo mosfillimit të hetimeve penale. Kompetenca lëndore e këtyre prokurorive mund të ushtrohet vetëm ndaj prokurorëve dhe gjyqtarëve që nuk janë subjekte të posaçme sipas nenit 75/a gërma “c” e Kodit të Procedurës Penale¹²⁷ si dhe vetëm për veprat penale që nuk janë në fushën e korrupsionit dhe krimit të

¹²⁷ Sikurse janë anëtarët apo ish anëtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjykatës së Lartë dhe Prokurori i Përgjithshëm, kur vepra kryhet gjatë ushtrimit të detyrës

organizuar. Nga ana tjetër, kompetenca lëndore e Prokurorisë së Posaçme është e kufizuar dhe ushtrohet ndaj subjekteve të posaçëm të përmendur më sipër, për çdo vepër penale për të cilën ata dyshohen se kanë kryer, si dhe ndaj prokurorëve dhe gjyqtarëve të çdo niveli, vetëm nëse ata dyshohet se kanë kryer veprat penale në fushën e korrupsionit dhe krimit të organizuar, të parashikuar në nenin 75/a, gërmat “a” dhe “b” të Kodit të Procedurës Penale.

Bazuar në informacionin e siguruar nga këto prokurori, KShH ka analizuar në këtë raport studimor, në përputhje me metodologjinë e paracaktuar, 21 raste që i përkasin subjekteve të vetting-ut, të kallëzuar apo referuar pranë Prokurorisë të Juridiksionit të Përgjithshëm, SPAK-ut, ose që janë kaluar për mungesë kompetence nga SPAK në drejtim të Prokurorisë të Juridiksionit të Përgjithshëm. Përkatësisht, për periudhën 2021 – 2022, të dhënat sasiore dhe konkluzionet e përmbledhura të këtij studimi paraqiten si vijon.

a. Të dhëna mbi subjektet e kallëzuara/proceduara dhe veprat penale që i ngarkohen

Sa i takon statusit që kanë patur subjektet e kallëzuar apo proceduar penalisht, rezulton se kemi të bëjmë me 13 prokurorë, duke përfshirë edhe raste të ish drejtuesve, përkatësisht 3 prokurorë të apelit, 7 prokurorë të prokurorisë të rrethit gjyqësor, 2 prokurorë në Prokurorinë e Përgjithshme, një prej të cilëve ish-prokuror i përgjithshëm dhe 1 prokuror në Prokurorinë e Krimeve të Rënda. Ndërkohë në sistemin gjyqësor (gjykatat e të tre niveleve) rezultojnë se janë kallëzuar apo proceduar 8 gjyqtarë, duke përfshirë këtu edhe ish kryetarë të gjykatave, prej të cilëve 6 gjyqtarë në Gjykatat e Rretheve Gjyqësore, 1 gjyqtar në Gjykatën e Apelit dhe 1 gjyqtar në Gjykatën e Lartë. Pjesë e subjekteve të proceduar është një ish anëtar i Gjykatës Kushtetuese.

Në total rezultojnë 22 gjyqtarë, prokurorë apo funksionarë të lartë të sistemit të drejtësisë, të kallëzuar apo proceduar penalisht.

Për sa i takon raportit që këto subjekte kanë patur me vendimmarrjet e procesit të vetting-ut, 12 prej tyre rezultojnë të dorëhequr dhe rrjedhimisht procesi i vetting-ut është ndërprerë për ta, 5 të shkarkuar, dhe 4 janë në proces në proces vetting-u (pra procesi ende nuk ka përfunduar). Sa i takon subjekteve të dorëhequr për të cilët ka nisur ose jo procedim penal, interesant është fakti se dorëheqja e tyre ka ardhur pasi janë njohur me konkluzionet e hetimit administrativ të KPK-së.

Për sa i përket veprave penale për të cilat është bërë referimi/kallëzimi në prokurori, apo ka nisur procedimi penal, shumica dërrmuese e rasteve, 11 raste janë për nenin 257/a/2 të Kodit Penal (Fshehja apo deklarimi i rremë i pasurisë), i referuar/proceduar veçmas apo së bashku me vepra të tjera penale¹²⁸), vetëm në 3 raste ka patur procedime penale, specifikisht për nenin 319/ç të Kodit Penal (Korrupsioni Pasiv), një rast i është referuar nenit 248 i Kodit Penal (Shpërdorimi i detyrës), dhe në rastet e tjera, mungon informacioni specifik nga prokuroritë e juridiksionit të zakonshëm.

¹²⁸ Të tilla si nenet e Kodit Penal, përkatësisht 143 “Mashttrimet”, 143/a/6 “Fshehja e Pronës”, 180 “Fshehja e të ardhurave”, 181 “Mospagimi i taksave dhe tatimeve”, 248 “Shpërdorimi i detyrës”.

Sa i takon zbatimit të masave të sigurisë, rezulton se vetëm për tre të pandehur (subjekt i procesit të vetting-ut), të proceduar penalisht për nenin 319/ç të Kodit të Procedurës Penale (Korrupsioni Pasiv), me kërkesë të prokurorisë së posaçme, gjykata ka vendosur që ata të hetohen dhe/ose gjykohen me masën e “arresit në burg”.

b. Të dhëna lidhur me subjektin kallëzues/referues

Për sa i takon të dhënave lidhur me subjektet kallëzues apo referues të çështjeve në prokurori, nga materialet e disponuara është vërejtur se në 4 raste subjekti referues ka qenë organi publik, KPK, në dy raste rezulton Sektori i Luftës ndaj Narkotikëve në Policinë e Shtetit, në 8 raste rezulton të jetë qytetar (por në 4 nga këto raste SPAK ka referuar çështjen në prokuroritë e juridiksionit të zakonshëm), ndërkohë që për pjesën tjetër të rasteve, ky informacion nuk mund të identifikohet.

c. Të dhënat e cunguara për publikun për nisjen e procedimit penal

Vërehet se në vendimet e KPK-së për ndërprerjen e procesit të vetting-ut për shkak të dorëheqjes, në shumë raste nuk janë pasqyruar rezultatet e hetimit administrativ që është mbyllur, para se subjekti të japë dorëheqjen. Kjo praktikë sjell që fakte të rëndësishme për këta subjekte të mos jenë publike, çka nuk i shërben, jo vetëm transparencës, por njëkohësisht as pro-aktivitetit të qytetarëve në denoncimin e tyre në organet e ndjekjes penale, si dhe nismës kryesisht që këto të fundit mund të ushtrojnë ndaj tyre. Sikurse evidentohet nga të dhënat, qytetarët janë denoncuesit kryesorë të subjekteve të dorëhequr apo të shkarkuar.

d. Vendimet e mosfillimit të procedimit penal

Në 4 raste, Prokuroritë e Juridiksionit të Përgjithshëm kanë vendosur mosfillim të procedimit penal, duke mos zbatuar në mënyrë të drejtë (sipas KShH-së), dispozitat e Kodit të Procedurës Penale. Kjo praktikë ka ndikuar negativisht në drejtim të pandëshkueshmërisë së këtyre subjekteve.

Në konkludimin për mosfillimin e procedimit penal, në raste të caktuara Prokuroria është mbështetur në faktin se vendimi i KPK-së ndaj subjektit nuk është botuar ende i arsyetuar si dhe nuk është një vendim përfundimtar, pasi ai është i ankimeshëm. Në vlerësimin e KShH-së nuk mund të justifikohet mosfillimi i çështjes penale, me argumentin se vendimi i organeve të vettingut nuk është zbardhur, apo botuar dhe se ai është i ankimeshëm. Nuk ka asnjë dispozitë të Kodit të Procedurës Penale që të mbështesë këtë arsyetim të prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm¹²⁹.

Shqetësues është fakti se prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm në raste të caktuara, kanë marrë vendime mosfillimi të procedimit penal brenda një harku kohor të disa ditëve nga marrja e materialit kallëzues, edhe në rastet kur subjektet janë shkarkuar me vendim përfundimtar të

¹²⁹ Vetëm gjykata, sipas nenit 343 të Kodit të Procedurës Penale ka të drejtë të pezullojë shqyrtimin gjyqësor, kur përfundimi i çështjes penale varet nga zgjidhja e një mosmarrëveshje civile ose administrative, për të cilën zhvillohet një gjykim, gjykata mund të vendosë pezullimin e shqyrtimit gjyqësor derisa çështja të zgjidhet me vendim të formës së prerë.

KPA-së, e cila ka konstatuar deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm të pasurisë së tyre dhe të personave të lidhur me ta, mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar disa prej pasurive të tyre, apo rol pasiv në drejtimin e veprimtarisë hetimore në funksion të zbardhjes së ngjarjes që perceptohet nga një vëzhgues i zakonshëm i publikut, si ndikim në drejtim të dobësimit të forcës goditëse të institucioneve të drejtësisë ndaj veprimtarisë së krimit të organizuar me karakter ndërkombëtar.

Në të tilla raste, prokuroritë nuk kanë administruar dosjet përkatëse të institucioneve të vetting-ut dhe kanë konkluduar mbi veprat penale për të cilat është bërë kallëzimi duke u bazuar në konkluzionet e vendimeve të institucioneve të vetting-ut, si për shembull që nuk kemi fshehje dhe as pasaktësi. Ky qëndrim ka elementë kontradiktor pasi vetë prokuroria në pjesën arsyetuese të këtyre vendimeve, referon se procesi i vetting-ut është një proces administrativ dhe jo penal.

KShH vlerëson se në një nga rastet, vendimi i prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan për mosfillimin e procedimit penal është i drejtë. Kallëzimi nga familjari i një shtetasi nën hetim, ndaj prokurorit të çështjes i cili nuk i është nënshtruar ende procesit të vetting-ut me një vendimmarrje, qoftë edhe të shkallës së parë, duket në sytë e një vëzhguesi të paanshëm si formë presioni dhe hakmarrjeje. Kjo pasi prokurori i kallëzuar, po heton çështjen penale të vëllait të të kallëzuarit, ish gjyqtar i shkarkuar në kuadër të procesit të vetting-ut.

e. Transferimet

Një pjesë e këtyre rasteve rezultojnë të transferuara nga SPAK, e cila informon KShH-në me shkresën zyrtare të dt.12.02.2024, se për 6 nga subjektet e vetting-ut, pasi janë paraqitur kallëzime në SPAK, është çmuar moskompetenca nga Prokuroria e Posaçme, ndaj ato janë transferuar pranë prokurorive me juridiksion të përgjithshëm. KShH vlerëson bazuar në të dhënat e organeve të vettingut mbi këto subjekte se moskompetenca e SPAK do të ishte vlerësuar më mirë, nëse do të kishin filluar hetimet paraprake. Ky qëndrim bazohet në interpretimin sistematik dhe harmonik të neneve 83 e 84/1 të Kodit të Procedurës Penale.

KShH vëren se ndaj këtyre subjekteve, kur ka patur edhe vendim mosfillimi të procedimit penal prej prokurorive ku janë transferuar, subjekti nuk është hetuar penalisht nga SPAK qoftë me nismën e saj, për dyshime lidhur me veprën penale të parashikuar nga neni 319/ç “Korrupsioni pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë” dhe as nga Prokuroritë respektive për veprën penale të parashikuar nga neni 257/a/2 të Kodit Penal (fshehje apo deklaram i rremë i pasurisë). Në raste të tilla, këto vendime frenojnë përmbushjen e përgjegjësisë hetimore nga organi i akuzës, qoftë bazuar në kallëzimin penal të shtetasit, por edhe me iniciativën e tyre, sipas nenit 280 të Kodit të Procedurës Penale.

f. Fillimi i procedimit penal dhe vlerësime lidhur me aktivitetin hetimor

Në 9 raste, Prokuroritë e Juridiksionit të Përgjithshëm raportojnë se kanë filluar procedimin penal edhe kur çështja ishte në hetim, por afatet e hetimit, duke marrë në konsideratë edhe kohën kur kanë disponuar organet e vetting-ut lidhur me këto subjekte, janë shumë të gjata dhe dobësojnë cilësinë dhe efikasitetin e hetimeve ndaj këtyre subjekteve.

Në ndryshim nga praktika e Prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm, SPAK ka zhvilluar 8 procedime penale ndaj subjekteve të vetting-ut, prej të cilave pesë për vitin 2021 dhe 3 për vitin 2022. Lidhur me këto procedime penale, 1 prej tyre është në hetim (deri në dt.2 Dhjetor 2022, kur është dhënë përgjigjja prej SPAK) dhe 7 prej tyre janë dërguar në gjykatë, ku një pjesë e tyre kanë rezultuar me vendimarrje fajësie. SPAK referon se nuk ka patur vendime të pushimit të procedimit penal.

Veprimtaria e SPAK në drejtim të procedimit penal të prokurorëve dhe gjyqtarëve të shkarkuar nga vettingu rezulton më efektive. Mgjth, KShH vlerëson se ka nevojë për harmonizim të praktikave, pasi jo në të gjitha rastet e procedura, ka patur procedim pasuror konform ligjit anti-mafia, që do të ishte shumë i nevojshëm për parandalimin dhe goditjen ndaj krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit, përmes konfiskimit të pasurisë së subjekteve të vetting-ut, të cilët kanë një nivel të pajustificuar ekonomik, si rezultat i veprimtarisë së dyshuar kriminale. I njëjti konkluzion vlen edhe për masat e sekuestros preventive dhe të konfiskimit që mund të kërkohen dhe vendosen në kuadër të procesit penal, sipas parashikimeve të Kodit të Procedurës Penale.

Bazuar në të dhënat që ofrojnë vendimet objekt studimi, vërehet se teknikat speciale të hetimit të veprave penale në fushën e korrupsionit janë zbatuar pjesërisht nga SPAK. Pozitiv është fakti se përgjimet e telekomunikimeve dhe ato ambientale kanë dhënë rezultate pozitive në drejtim të provueshmërisë për ngritjen e akuzës penale nga prokuroria dhe dënimit nga gjykata të të pandehurve në 3 raste, specifikisht për nenin 319/ç të Kodit Penal (Korrupsioni pasiv). Megjithatë, edhe për këto raste, në funksion të barrës së provës për akuzën e ngritur që ka prokuroria, hetimet mund të ishin më produktive nëse do të ishte kërkuar përgjimi i ambienteve private (zyrat e gjyqtarëve dhe të prokurorëve), duke u nisur nga rrethanat specifike të çështjeve, dhe konform neneve 222 e në vijim të Kodit të Procedurës Penale. E themi këtë, pasi në këto çështje, provat për marrjen e rryshfetit nga gjyqtarët/prokurorët nuk janë të drejtpërdrejta por vërtetohen indirekt nga transkriptimet e bisedave të të pandehurve të tjerë.

Në përgjithësi, rrethanat e disa prej çështjeve dhe veprimet hetimore të realizuara nga SPAK reflektojnë një natyrë komplekse dhe të vështirë hetimi. Në mënyrë të veçantë, kjo vihet re për 3 nga procedimet penale, të cilat kanë filluar më herët nga ish prokuroria e krimeve të rënda, ku janë marrë të pandehur gjyqtarë dhe prokurorë bashkë me shtetas të tjerë, të akuzuar për vepra penale në fushën e krimit të organizuar, korrupsionit, ushtrimit të ndikimit të paligjshëm, ndaj personave që ushtrojnë funksione publike. Lidhur me këto çështje, të cilat në varësi të specifikave dhe rrethanave të tyre, është disponuar edhe me vendime për veçimin e tyre, vihet re se është bashkëpunuar edhe me autoritete të drejtësisë së vendeve fqinje apo vendeve të tjera. Megjithatë, KShH vëren se jo në të gjitha rastet rezulton të jenë marrë të dhëna apo dokumente nga organet e vetting-ut, ILDKPKI, DSIK (si organe ndihmëse të vetting-ut) apo të dhëna nga agjenci të specializuara ligj-zbatuese, të cilat do të ndihmonin ecurinë e hetimeve dhe atribuirimin sa më të drejtë të faktit penal dhe ngritjes së akuzës penale. Këto të dhëna janë marrë kryesisht vetëm në procedimet penale për veprën penale të parashikuar nga neni 257/a/2 i Kodit Penal, ndërkohë që ato mund të kontribuonin edhe në procedimet e tjera penale për korrupsionin apo shpërdorimin e detyrës.

Në shumicën e rasteve, kur SPAK ka hetuar dhe dërguar çështjet në gjykatë, vetëm për veprën penale të parashikuar nga neni 257/a i Kodit Penal, vërejmë se mund të ishte hetuar në mënyrë më të thelluar, në drejtim të mënyrës se si është vendosur apo krijuar pasuria e fshehur dhe që nuk justifikohet me burimet e ligjshme financiare të pandehurve dhe familjarëve të tij. Referuar përmbajtjes së kërkesës për dërgimin e çështjes në gjykatë, KShH vëren se nuk reflektohen të dhëna mbi hetimin e korrupsionit monetar për pasurinë në vlerë të konsiderueshme që rezultojnë e fshehur/padeklaruar, si ndërlidhen këto pasuri me veprimtaritë e dyshuara, por të pa hetuara, sikurse mund të jenë të paktën në 3 çështje, lidhjet potenciale të pandehurit me segmentë të krimit apo krimit të organizuar.

Është pozitiv fakti se organi i akuzës, në shumicën e rasteve të procedura ka caktuar një ekspert teknik vlerësues dhe/ose ekspertë kontabël, me qëllim për të verifikuar pasuritë, të ardhurat dhe shpenzimet, si dhe burimet e krijimit të pasurive, të pandehurit dhe personave të lidhur me ta.

g. Parashkrimi

Instituti i parashkrimit të ndjekjes penale ose siç njihet ndryshe, pamundësia për të ushtruar ndjekjen penale për shkak se kanë kaluar disa afate parashikohet në nenin 66 të Kodit Penal, ku këto afate kategorizohen në përputhje me masën e dënimit. Lidhur me këtë institut, sa i takon veprës penale të parashikuar nga neni 257/a/2 i Kodit Penal- që parashikon një dënim më të ulët (gjobë deri në 3 vjet burg), në raport me dënimet për veprat penale në fushën e korrupsionit apo krimit të organizuar- parashkrimi ndodh në afate më të ngushta, përkatësisht pas 5 vitesh nga kryerja e veprës.

Bazuar në kërkimet e pandehurve dhe mbrojtësve të tyre, me interes për këtë raport studimor është interpretimi në disa nga vendimet e GJKKO i afatit kur fillon të veprojë instituti i parashkrimit. Në varësi edhe të rrethanave të ngjarjes, si moment i fundit për llogaritjen e afateve të parashkrimit për veprën penale të parashikuar nga neni 257/a/2 vlerësohet pikërisht data e dorëzimit nga subjekti i deklaratës së vetting-ut në janar të vitit 2017. Duke u nisur nga ky interpretim i Gjykatës së Posaçme, konkludohet që të gjithë subjektet që nuk janë marrë si të pandehur deri në Janar të vitit 2022 (pavarësisht se janë gjetur me probleme në kuadër të procesit të vetting-ut), nuk mund të ndiqen penalisht për nenin 257/a/2 të Kodit Penal, pasi afati i tyre është parashkruar. Ky konstatim është shumë shqetësues në drejtim të pandëshkueshmërisë së mbi të paktën 90% të gjyqtarëve dhe prokurorëve të shkarkuar nga vetting-u, të cilët nuk rezultojnë të proceduar penalisht. Ndërkohë për veprat penale në fushën e korrupsionit, të cilat rezultojnë tërësisht të pa hetuara, sa i takon fakteve që procesi i vetting-ut ka zbuluar, afati i parashkrimit është 10 vjet, pasi dënimi maksimal i tyre është 10 vjet (interpretimi i nenit 66/c me nenin 319/ç të Kodit Penal).

e. Afatet e hetimit

Sa i takon afateve të hetimit, në mungesë sistematike të informacionit se kur është bërë kallëzimi apo referimi në prokurori, mund të konkludojmë në dy drejtime kryesore. Së pari, sa i takon afateve të procedimit penal nga prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm vërehen, të paktën në 5 raste, vonesa të konsiderueshme që shkojnë 2-3 vjet. Sa i takon të dhënave të marra

nga SPAK gjithashtu vihet re pak a shumë e njëjta kohë duke marrë si referencë datën nga kallëzimi apo referimi pranë prokurorive.

Në vlerësimin e KShH-së këto afate janë shumë të të gjata, e vlerësuar kjo në raport me shkallën jo të lartë të kompleksitetit në hetim, sa kohë që në shumicën e rasteve nuk është hetuar në drejtim të korrupsionit apo përfshirjes së të pandehurit në veprimtarinë e krimit të organizuar. Megjithatë, sikurse kemi evidentuar më herët, afatet e hetimeve paraprahe, sipas neneve 323 e në vijim të Kodit të Procedurës Penale llogariten nga data, në të cilën, emri i personit që i atribuohet vepra penale është shënuar në regjistrin e njoftimit të veprave penale. Në disa nga praktikatat e studiuara, KShH vëren shënimi është realizuar shumë kohë më pas (deri edhe pas një viti) nga data e kallëzimit apo referimit. Është pozitiv fakti që për disa nga procedimet penale është regjistruar menjëherë dhe po ashtu shënimi i emrit të personit në regjistrë, në ndryshim nga praktikatat e tjera të studiuara në këtë raport, ku vërehen vonesa të konsiderueshme që tejzgjasin në mënyrë “artificiale” afatet e hetimit.

Në tërësi, afatet e tejzgjatura të procedimit penal, si dhe transferimet e çështjeve nga SPAK drejt prokurorive të juridiksionit të zakonshëm, dhe më tej, në raste të caktuara, edhe midis këtyre të fundit-duke krijuar edhe efekte “ping-pong”-në vlerësimin e KShH-së ndikojnë në dobësimin e efikasitetit të procesit hetimor dhe barrës së provës që ka organi i prokurorisë për të provuar akuzat e ngritura në gjykatë.

f. Plotësimi i hetimeve në vijim të disponimit të gjyqtarit të seancës paraprahe

Rastet kur gjyqtari i seancës paraprahe ka urdhëruar plotësim të hetimeve nga Prokuroria e Posaçme janë të pakta. Në vendimet e studiuara, KShH vlerëson se kërkesat e gjyqtarit të seancës paraprahe për plotësimin e hetimeve nuk duhet të cenojnë parimin kushtetues të pavarësisë së prokurorit. Gjithashtu, gjyqtari i seancës paraprahe jo vetëm teorikisht, por edhe në rastin konkret, duhet t'i shmanget çmuarjes dhe vlerësimit të provave në këtë fazë sa i takon ekzistencës ose jo të faktit penal në ngarkim të të pandehurit, pasi ky është atribut i vendimmarrjes së gjykatës së themelit. Gjithashtu, KShH vlerëson se gjyqtari i seancës paraprahe duhet të marrë një rol më pro-aktiv, pasi rastet e studiuara evidentojnë se nuk ka patur asnjë vendimmarrje për kthimin e akteve pranë prokurorisë, pasi nuk janë hetuar plotësisht prej saj për fakte të tjera penale që rezultojnë në kuadër të hetimeve, të lidhura me veprat penale në fushën e korrupsionit, krimit të organizuar apo pastrimit të parave. Këtë konkluzion e mbështesim në një interpretim të harmonizuar dhe sistematik të nenit 332/ç dhe 332/dh të Kodit të Procedurës Penale.

g. Vendimet e GJKKO-së

Gjatë kësaj periudhe, rezulton se janë dhënë 4 vendime fajësie nga GJKKO e Shkallës së parë për 4 të pandehur (subjekte të procesit të vetting-ut), 2 prej të cilëve të dënuar për veprën penale të parashikuar nga neni 257/a/2 i Kodit Penal që sanksionon fshehjen dhe deklarimin e rremë të pasurisë, dhe 2 të pandehurit e tjerë janë dënuar për veprën penale të parashikuar nga neni 319/ç i Kodit Penal që sanksionon korrupsionin pasiv të gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të sistemit të drejtësisë. Për 3 nga këto subjekte, GJKKO e Apelit ka disponuar

me vendime të formës së prerë, me anë të të cilave është lënë në fuqi vendimi i dënimit ose është ndryshuar vendimi duke dhënë një lloj dhe masë pak më e ashpër dënimi.

Në ndryshim nga faza e hetimeve, gjykimi në themel është zhvilluar në afate kohore të shpejta dhe të arsyeshme. Në këtë drejtim, ka kontribuar edhe fakti se me kërkesë të të pandehurit, gjykata ka pranuar të procedojë me rregullat e gjykimit të shkurtuar, duke e arsyetuar vendimin e saj, konform neneve 332/c dhe 403/1 të Kodit të Procedurës Penale si dhe jurisprudencës (vendimit nr.4/2012 të Gjykatës Kushtetuese dhe vendimit unifikues nr.2/2003 të Gjykatës së Lartë, të cilat analizohen në vijimësi).

Nga pikëpamja e arsyetimit, vihet re se vendimet e të dyja gjykatave paraqesin në mënyrë kronologjike faktet e çështjes, kërkimet dhe pretendimet e palëve, përfshi këtu edhe përmbledhjen e konkluzioneve përfundimtare të tyre, si dhe vlerësimet e vetë gjykatës lidhur me to. Në tërësi, argumentet e përdorura janë të qarta dhe bindëse, si dhe i japin në mënyrë transparente përgjigje kërkesave dhe kundërshtimeve të mbrojtësit të të pandehurit. Gjithashtu, nuk vihen re elementë kontradiktorë midis pjesës përshkruese dhe arsyetuese dhe dispozitivit të vendimit.

Me interes është arsyetimi që gjykata e posaçme ka bërë, duke dalluar elementët e anës objektive të “fshehjes” dhe “deklarimit të rremë” të pasurisë, për gjykimet lidhur me akuzat penale për nenin 257/a/2. Por, në aspektin e konkretizimit të elementëve të anës objektive të veprës penale për të cilat i pandehuri u deklarua fajtor, Gjykatat jo gjithmonë ka qartësuar se në cilat raste kemi patur fshehje, dhe kur deklarim të rremë. Megjithatë, në sytë e një vëzhguesi publik, në raste të veçanta, standarti i përdorur në arsyetimin e vendimeve të studiuara, nuk reflekton sa duhet pavarësinë dhe paanshmërinë e trupës gjyqësore, nuk është i plotë si dhe nuk i jepet përgjigje në masën e nevojshme, në funksion dhe të transparencës karshi palëve dhe publikut, të gjitha pretendimeve të ngritura nga të pandehurit dhe mbrojtësit e tyre.

Në lidhje me llojin dhe masën e dënimit, Gjykatat kryesisht kanë bazuar vendimmarrjen në nenet 47, 48 dhe 49 të Kodit Penal. Pozitiv është fakti që në disa raste përmendet se synimi final i dënimit është riedukimi dhe ri-integrimi i autorit të veprës penale në shoqëri pas kryerjes së dënimit. Gjithashtu, në të gjitha vendimet e fajësisë dhe të dënimit, gjykata ka dhënë edhe dënimin plotësues të heqjes të së drejtës për të ushtruar funksione publike për 5 vjet, i cili është arsyetuar në raport me cilësitë e personit që i është besuar ushtrimi i funksioneve publike dhe veprat penale për të cilat deklarohet fajtor. Megjithatë, KShH vlerëson se ka nevojë të harmonizohet më mirë standarti vlerësues i gjykatës mbi rrezikshmërinë shoqërore dhe rrethanat lehtësuese, si dhe aplikimin e alternativave të dënimit me burgim në raste të veçanta, sikurse është ai ndaj të pandehurës E.H.

Argumentet e përdorura nga GJKKO e Apelit shpesh herë janë më të zgjeruara dhe paraqesin elementë dhe tipare të veçanta që individualizojnë linjën arsyetuese të saj, krahasuar me vendimet e GJKKO-së në Shkallë të Parë.

Pozitiv për të dyja gjykatat është referimi në vendimmarrjet e tyre i standarteve të vendosura nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, dhe në disa raste edhe në konventat e ratifikuara nga shteti Shqiptar në luftën kundër korrupsionit, në kuadër të aderimit pranë Këshillit të

Evropës dhe Kombeve të Bashkuara. Megjithatë, në tërësi, sa i takon përmbajtjes së vendimeve të studiuara, KSHH vlerëson se është e nevojshme që të ketë një përmbledhje më të sintetizuar dhe të qartë të fakteve të çështjes, duke shmangur perifrasticitet mekanike të të dhënave që rezultojnë gjatë fazës së hetimeve paraprake.

REKOMANDIME

- 1) Subjektet që janë përballur me rivlerësimin e tyre përballë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit kanë qenë pjesë e shortimeve të bëra në 16 dhjetor 2019 dhe 15 qershor 2020. Pas për më shumë se 28 muajsh është zhvilluar ndaj tyre seanca dëgjimore. Nisur nga fakti që prej Janarit 2025, mandati i KPK-së pushon, KShH rekomandon KPA-së shqyrtimin e ankimeve me ritme dinamike, veçanërisht për ato çështje (subjekte të shkarkuara në shkallë të parë) që kanë efekt të ndjeshëm financiar.
- 2) Në vlerësimin e KShH, përcjellja live e seancave publike të KPA-së për personat e interesuar nuk garanton të njëjtin nivel aksesit dhe rrjedhimisht edhe kuptueshmëri të mbarëvajtjes së procesit dhe vëzhgimit të sjelljes së secilës palë në seancë, si dhe në rastet kur publiku është prezent fizikisht. Duke qenë se të gjitha gjykatat në vend po funksionojnë normalisht dhe duke lejuar praninë e publikut rekomandohet që edhe KPA të lejojë pjesëmarrjen e publikut, në sallën ku zhvillohet seanca.
- 3) Rekomandojmë një vëmendje të shtuar tek parimi i transparencës mbi vendimet e KPA, pasi nga fagen zyrtare të Kolegjit nuk përcaktohet data e saktë e publikimit të vendimit të arsyetuar si dhe të respektohet afati i publikimit në përputhje me afatin për arsyetimin e vendimit. Gjithashtu është e nevojshme të unifikohet praktika, në lidhje me publikimin e mendimeve të ndryshme apo paralele të përgatitura nga vëzhguesit ndërkombëtarë të ONM-së.
- 4) KShH i rekomandon Kolegjit që denoncimet e qenësishme të publikut të reflektohen qartazi në vendimet e saj, duke adresuar edhe qëndrimin apo vlerësimin e vetë subjektit ndaj këtyre denoncimeve.
- 5) Nisur nga qëndrime të ndryshme brenda Kolegjit në lidhje me interpretimin e konceptit të `personit të lidhur` apo `persona të tjerë të lidhur` është e nevojshme që vet Kolegji të bëjë një interpretim në frymën e ligjit për të identifikuar saktësisht rrethin dhe kategorinë e subjekteve që mund të konsiderohen të tillë për ta shtrirë hetimin pasuror edhe tek këta persona. Në këtë kontekst, është e nevojshme të mbahet në konsideratë edhe parashikimi i nenit 3, paragrafi 14 i cili jep një përkufizim më të zgjeruar të personit të lidhur dhe për këtë arsye i shërben më mirë qëllimit të ligjit.
- 6) Për të mundësuar kryerjen e studimeve dhe raporteve më të plota, thelbësore dhe e detyrueshme është që organet publike të respektojnë të drejtën e informimit të parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës dhe ligji 119/2014 "Për të drejtën e informimit", i ndryshuar, brenda afateve ligjore të përcaktuara, në funksion të garantimit të transparencës dhe parimit të mirëqeverisjes. Referuar gjetjeve të këtij studimi, ky rekomandim i drejtohet veçanërisht prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm.
- 7) Me përfundimin e mandatit të KPK-së në fund të këtij viti (2024), i rekomandojmë Kolegjit të jetë pro-aktiv në zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga neni 281 i Kodit të

Procedurës Penale, duke bërë kallëzim/referim të menjëhershëm në prokurori, për të gjitha ato raste kur nga rezultatet e hetimit/procedimit të vettingut, zbulohen fakte që përbëjnë elemente të veprave penale.

- 8) KShH i sugjeron Prokurorisë së Posaçme dhe atyre të juridiksionit të zakonshtëm t'i kushtojnë vëmendjen e duhur fakteve të bëra publike në media gjatë procesit të rivlerësimit, për të filluar hetimin kryesisht (ex officio) në të gjitha rastet kur ka indicie publike për kryerjen e një veprë penale.
- 9) I rekomandohet Prokurorive të Juridiksionit të Përgjithshëm që vendimet për mos fillimin e procedimit penal të jenë të argumentuara dhe në mbështetje të plotë të neneve 290 dhe 291 të Kodit të Procedurës Penale.
- 10) I rekomandohet Prokurorisë së Posaçme të zhvillojë procedim pasuror sipas ligjit anti-mafia (pavarësisht nëse ka ose jo një procedim penal) kur vërehen pasuri për të cilat është konkluduar se ka deklaram të rremë ose janë, të fshehura apo për të cilat mungon burimi i ligjshëm apo ato nuk justifikohen ndjeshëm me të ardhura të ligjshme, në zotërim të subjekteve të vetting-ut, për të cilat të paktën KPK si organi që kryen vettingun në Shkallë të Parë ka disponuar me një vendim shkarkimi ose ndërprerje të procesit për shkak të dorëheqjes.
- 11) Prokuroritë në përputhje me fushën e tyre lëndore të kompetencës, duhet të bëjnë përpjekje serioze (prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm) dhe përpjekje të mëtijshme (SPAK) për të zhvilluar hetime të plota, efikase dhe të gjithanshme, për subjektet e vetting-ut, për të cilët nga ky proces, rezultojnë të dhëna apo fakte për pasuri të konsiderueshme apo për lidhje të subjekteve me krimin e organizuar. Në mënyrë të veçantë, KShH vlerëson se hetimi i tyre duhet të shtrihet për veprat penale në fushën e korrupsionit, shpërdorimit të detyrës, lehtësimit të veprimtarisë apo lidhjeve dhe angazhimit në veprimtari të krimit të organizuar dhe me organizatat kriminale.
- 12) I rekomandohet SPAK që në hetimin e korrupsionit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, të vlerësojë dhe kërkojë autorizimin e gjykatës, për përdorimin e teknikave speciale të hetimit konform neneve 221 e në vijim të Kodit të Procedurës Penale, sikurse mund të jetë edhe përgjimi i ambienteve private (zyrat e gjyqtarëve dhe të prokurorëve). Ky rekomandim përcillet duke u nisur nga të dhënat specifike të pasqyruara në vendimet objekt studimi, prej të cilave ka rezultuar se provat për marrjen e rryshfetit nga gjyqtarët/prokurorët nuk janë të drejtpërdrejta por vërtetohen indirekt nga transkriptimet e bisedave të të pandehurve të tjerë.
- 13) KShH i rekomandon prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm dhe SPAK të tregojnë kujdesin e duhur në respektimin e afateve të hetimit paraprak, motivimin e vendimeve për zgjatje të afateve të hetimit dhe njoftimin në kohë të vendimeve për zgjatjen e afatit tek të pandehurit dhe mbrojtësit e tyre, konform neneve 323 e në vijim të Kodit të Procedurës Penale. Gjithashtu, në vlerësojmë se duhet të unifikohet praktika, të paktën për rastet e kallëzimeve penale apo referimeve nga institucionet publike, se kur duhet të fillojë procedimi penal dhe të shënohet në regjistër emri i personit që i atribuohet vepra penale, me qëllim që të mos ketë vonesa që dobësojnë efikasitetin e hetimeve dhe tejzgjasin afatet reale (jo formale) të hetimeve.

